



**Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice**

PROGRAMI TRAJNUES 2024

Prishtinë, nëntor 2023

Programi Trajnues për vitin 2024 është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë
me datën 29.11.2023

© AD 2023, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar Akademisë si burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa konfirmimin e Akademisë.

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë



Tabela e përmbajtjes

Fjala e Kryesuesit të Këshillit Drejtues.....	7
Analiza e Nevojave Trajnuese për vitin 2024.....	8
Metodologjia për vlerësimin e nevojave trajnuese.....	8
Përmbledhje ekzekutive	9
TRAJNIMET NGA LËMIA PENALE	18
1. Pastrimi i parave dhe hetimi financiar	19
2. Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë.....	21
3. Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	24
4. Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm.....	25
5. Krimet e luftës.....	27
6. Zbatimi i Udhëzueseve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit	29
7. Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështirësi të kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore	31
8. Krimi kibernetik dhe kriptovalutat.....	33
9. Dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues	35
10. Gjykimi në mungesë	37
11. Përpilimi i aktakuzës, arsyetimi dhe vlerësimi i provave.....	39
12. Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore.....	40
13. Strategjia e hetimit, masat e veçanta hetimore	41
14. Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi..	43
15. Hetimet Financiare dhe Rikuperimin e Aseteve	44
TRAJNIMET NGA LËMIA CIVILE	45
1. Anulimi i Kontratave	46
2. Fitimi i pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit.....	47
3. Kompensimi i Dëmit – Fitimi i humbur (renta)	49
4. Procedura Jokontestimore	51
5. Procedura Përmbartimore	52
6. Procedura trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë	54
7. Shqyrtimi paraprak i padisë në kontestet e punës, në kontestet e pengim posedimit dhe në kontestet e fyerjes dhe shpifjes – Afatshmëria/ lejueshmëria si prezumim procedural	55
8. Ndihma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile.....	57
9. Marrëdhëniet detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile.....	58
TRAJNIMET NGA LËMIA E DREJTËSISË PËR FËMIJË	60

Drejtësia për fëmijë - Aspekti Penal.....	61
1. Veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve – viktima të dhunës seksuale	61
2. Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit, masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit	63
Drejtësia për fëmijë -Aspekti Civil	64
3. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve në procedurën kontestimore dhe jokontestimore	64
KOMERCIALE	66
1. Njohuritë financiare.....	67
2. Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare	69
3. Hulumtimi, shkrimi dhe arsyetimi ligjor në fushën komerciale.....	70
4. Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtarë, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-se mbi çështjet komerciale dhe doganore.....	71
5. E drejta kontraktuese, kontratat e ndërtimit.....	72
6. Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare.....	73
7. Procedura e falimentimit.....	74
8. Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat dhe specifikat e industrisë së TIK-ut, licencimit dhe të drejtave të pronësisë industriale	75
9. Ndërmjetësimi, mënyrat e referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit - raste praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit komercial, Elaborimi i rasteve praktike ndërkombëtare të rasteve komerciale në ndërmjetësim	77
10. Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Arbitrazhit vendor dhe të huaj	79
11. Arbitrazhi në kontestet investitor-Shtet (ISDS)	80
12. Marrëdhëniet komerciale me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet komerciale.....	82
ADMINISTRATIVE.....	84
1. Mbrojtja gjyqësore në konfliktin administrativ.....	85
2. Mbrojtja gjyqësore në kontestet - çështjet e prokurimit publik.....	86
3. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ.....	87
KUSHTETUESE.....	88
1. Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin civile	89
2. Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin penale.....	91
KEDNJ	93
1. Qasja në mjete juridike efektive	94
2. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 5 dhe nenit 6 të KEDNJ ...	96

3. Liria e Shprehjes dhe Mbrojtja gjyqësore në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes - Trajnim i specializuar për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs)	99
4. Mbrojtja e të dhënave personale.....	101
E DREJTA EVROPIANE	103
1. Efekti i të Drejtës së Unionit Evropian	104
2. Unifikimi i legjislacionit penal me atë të vendeve të UE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në UE	105
KUNDËRVAJTJE	106
1. Personat Juridik si kryerës të veprave kundërvajtëse.....	107
2. Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit	108
NDËRMJETËSIMI	109
1. Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit-raste praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit, Ndërmjetësimi i detyrueshëm	110
TRAJNIMET INTERDISIPLINARE.....	112
1. Menaxhimi i lëndëve penale dhe orarit të gjykimeve	113
KURIKULA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR DHUNËN NDAJ GRAVE, DHUNËN NË FAMILJE DHE DHUNËN ME BAZË GJINORE	114
1. Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore.....	115
2. Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale	116
3. Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare	118
4. Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën	119
KUNDËR DISKRIMINIMIT	120
1. Antigjipsizmin	121
TRAJNIMET PËR MENAXHMENTIN E GJYKATAVE/PROKURORIVE	123
1. Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë	124
TRAJNIMET PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL DHE ZYRTAR LIGJORE	125
Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional.....	125
(Penale-materiale dhe procedurale)	125
(Civile-materiale dhe procedurale)	125
Trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtar ligjore	126
Trajnimet në Fushën Penale.....	126
Materiale	126
Trajnimet në Fushën Penale.....	126
Procedurale	126
Trajnimet në Fushën Civile.....	126

Materiale	126
Trajnimet në Fushën Civile.....	126
Procedurale	126
STAFI ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL.....	127
1. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.....	128
2. Shkathësitë në komunikim.....	129
3. Integriteti dhe sjelljet etike në administratën gjyqësore dhe prokuroriale	130
4. Menaxhimi i kohës dhe stresit në vendin e punës	131
5. Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat	132
6. Trajnimi për protokollin dhe Etiketa.....	134
7. Mbrojtja e sinjalizuesve	135
8. Mirëmbajtja e faqeve të gjykatave në Facebook dhe informimi i publikut përmes tyre	136
9. Trajnimi hyrës për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës gjyqësore	137
Moduli 1:.....	137
Moduli 2:.....	137
Trajnimet për Trajnues.....	138
Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT).....	139
Platforma e Kurseve në HELP	140
Platforma për edukimin e profesionistëve ligjor për liritë dhe të drejtat e njeriut - HELP kurse online	141

Fjala e Kryesuesit të Këshillit Drejtues

Të nderuar,

Akademia e Drejtësisë bazuar në mandatin e saj ligjor është e përkushtuar në ofrimin e trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe rritjes së cilësisë së punës në gjykata dhe prokurori.

Stafi përgjegjës i Akademisë së Drejtësisë ka punuar intenzivisht në vlerësimin e nevojave trajnuese, proces ky i cili i paraprin hartimit të programit trajnues duke siguruar gjithë përfshirjen përmes takimeve të rregullta me KGJK dhe KPK, anketave vlerësuese, punëtorive dhe formave tjera. Këshilli Programor i AD-së bashkë edhe me akterët tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial nga gjetjet e këtij procesi ka hartuar këtë program i cili është gërshetim i aspekteve materiale dhe procedurale për çështje të ndryshme ligjore për të cilat është vlerësuar se ka nevojë për praktikë më të mirë dhe për të promovuar zgjidhjet më të mira ligjore.

Programi trajnues për vitin 2024 reflekton kërkesat dhe nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilat në kuadër të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese janë konfirmuar edhe me krerët e gjykatave dhe prokurorive, si dhe me KGJK-në dhe KPK-në. Për më tepër programi trajnues i AD-së reflekton edhe masat dhe aktivitetet nga Strategjia për sundimin e ligjit, Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje si dhe Programi Kombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat janë mandatore për institucionet e sistemit të drejtësisë si rezultat i proceseve integruese dhe rekomandimeve nga mekanizmat tjerë si PKZMSA dhe raporti i BE-së për Kosovën.

Në procesin e zbatimit të këtij programi do të angazhohen trajnues që kanë ekspertizë në fushat e caktuara, të cilët do të transferojnë njohuritë e tyre dhe do të ndajnë perspektivën e tyre me përfituesit e këtij programi. Programi është gjithëpërfshirës që nënkupton se secili gjyqtarë dhe prokurorë në sistem do të ketë mundësinë e aplikimit në trajnimet që trajtojnë çështje ligjore që janë kompetencë e tyre e gjithashtu edhe bashkëpunëtorët profesional si dhe profesionistë tjerë ligjor puna e të cilëve ndërlihet me çështjet që do të trajtohen gjatë këtij programi.

Në përmbyllje të kësaj që u tha më sipër, jam mirënjohës stafit të AD-së, Këshillit Programor, KGJK-së dhe KPK-së, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve të prokurorive, gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe grupeve tjera të interesit që përmes rekomandimeve, ofrimit të propozimeve dhe formave tjera kontribuan në hartimin e këtij programi.

Sinqerisht,

Vaton Durguti,
Kryesues i Këshillit Drejtues

Analiza e nevojave trajnuese është një proces me rëndësi tejet të veçantë për Akademinë e Drejtësisë meqë i paraprinë hartimit të këtij programi trajnues.

Bazuar në kornizën ligjore në fuqi përkatësisht neni 6, pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 e Ligjit për Akademinë është realizuar procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë, prokuror si dhe stafit administrativ gjyqësor e prokurorial.

Edhe këtë vit Akademia ka qenë e përkushtuar në zbatimin e mekanizmave për vlerësim të nevojave trajnuese me ç ‘rast kishte qëllim identifikimin e vështirësive praktike dhe sfidave me të cilat përballen gjyqtarët gjatë gjykimit dhe prokurorët gjatë hetimit të rasteve.

Në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese janë përdorë mekanizmat të cilët janë në pajtim me standardet që kanë në qendër vlerësimin gjatë fazës së planifikimit, hartimit dhe zbatimit të programit dhe ishin si në vijim:

- Formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues;
- Pyetësorët për gjyqtarë dhe për prokurorë njëherë brenda vitit;
- Shkresat drejtuar KGJK-së dhe KPK-së që nënkupton edhe observimeve nga Zyra për Vlerësim të Performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve
- Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive;
- Takimet dhe diskutimet me trajnuesit të AD-së-së dhe veçanërisht konkluzionet e tyre pas trajnimeve
- Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- Përfshirja e shoqërisë civile
- Monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe shoqërinë civile përmes OJQ-ve.

Metodologjia për vlerësimin e nevojave trajnuese

Për vlerësimin e nevojave trajnuese hapi i parë thelbësor ishte mbledhja dhe analiza e masave të përcaktuara në Strategjinë për sundimin e Ligjit 2021-2026, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave 2022-2026 si dhe nga Programi Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut 2021-2025. Vlerësimi i nevojave për trajnime te dala nga zbatimi i masave të parapara në këto strategji obligojnë Akademinë e Drejtësisë si institucion udhëheqës apo edhe mbështetës të koordinojë dhe zbatojë trajnimet për gjyqtaret, prokuroret dhe profesionistët tjerë ligjore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Hapi i dytë dhe tejet me rëndësi ishte mbledhja e të dhënave nga anketat vlerësuese siç janë formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues të mbajtur gjatë vitit dhe nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët janë proceduar tek të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës në muajin korrik të vitit 2023. Në këtë kuadër hyjnë edhe propozimet nga vizitat dhe takimet në KGJK dhe KPK, gjykata dhe prokurori të mbajtura gjatë gjithë vitit. Propozimet nga takimet e përditshme me trajnuesit me rastin e zbatimit të programeve trajnuese. Veçanërisht thelbësore ishte punësoria për vlerësimin e nevojave trajnuese e realizuar me 27 korrik 2023 në të cilën të pranishëm ishin të gjithë bashkë krerët kryesor të sistemit gjyqësor dhe prokurorial nga të gjitha instancat e gjykatave dhe prokurorive duke përfshirë edhe gjyqtarë dhe

prokurorë. Për të konfirmuar edhe më tej rezultatet nga takimet e veçanta dhe gjithashtu nga kjo punëtori ishte edhe dërgimi i shkresave formale në KGJK dhe KPK me datën 1 shtator 2023 me kërkesën që nga takimet e rregullta të këtyre institucioneve të ndajnë me Akademinë e Drejtësisë konkluzionet përfundimtare sa i përket nevojave trajnuese dhe propozimeve për programin trajnues për vitin 2024. Këshilli Gjyqësor përtej propozimeve me shkrim ka ftuar AD-në në punëtorinë e saj me 5 dhe 6 tetor me ç ‘rast ka bërë të ditur politikën e saj rreth trajnimeve për gjyqtarë dhe stafin mbështetës të gjykatave.

Rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese kishte edhe perspektiva e shoqërisë civile dhe mediave të shkruara dhe elektronike për sistemin e drejtësisë.

Hapi i tretë me radhë ishte ofrimi i rezultateve të dala nga të gjithë mekanizmat e lartpërmendur për Këshillin Drejtues dhe Këshillin Programor të AD-së bashkërisht në punëtorinë e datës 13 dhe 14 nëntor 2023 me përfaqësuesit nga KGJK dhe KPK, kryetaret e gjykatave dhe kryeprokuroret e prokurorive sipas kompetencës kanë shqyrtuar gjitha rezultatet dhe sipas prioritetëve kanë zhvilluar objektivat dhe përmbajtjen e Programit trajnues për vitin 2024.

Me pas hapi i katërt dhe i fundit është propozimi i këtij Programi Trajnues në Këshillin Drejtues i cili sipas mandatit shqyrton dhe miraton programin trajnues vjetor.

Përmbledhje ekzekutive

Nga gjetjet e procesit të nevojave trajnuese është hartuar Programi Trajnues për vitin 2024 i cili është në vijim të këtij dokumenti. Për hartimin e tij është siguruar gjithë përfshirja e akterëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të cilët bashkë me Këshillin Programor të AD-së kanë integruar në program çështjet ligjore sipas kërkesave të dokumenteve strategjike, prioritetëve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese të përfituesve të saj sipas ligjit.

Programi është i dizajnuar për të adresuar gjitha çështjet ligjore që janë sfiduese për praktikën gjyqësore përmes tryezave, trajnimeve të specializuara dhe formave tjera të trajnimit gjyqësor. Për përmirësimin e performancës profesionale të gjyqtarëve një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve sipas kërkesës do të zbatohet përmes tryezave profesionale si dhe kombinimit të tyre me anë të kolegjiemeve. Ngjashëm edhe për prokurorët veçanërisht për çështjet që janë kompetencë e tyre lëndore, ndërkaq do të kenë edhe trajnime të përbashkëta.

Prioritet i këtij programi mbasin bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor si dhe stafi tjetër administrativ. Janë konfirmuar trajnimet bazike nga moduli penal dhe civil ndërkaq për stafin tjetër përshtatshëmrisht me natyrën e punës. Në kuadrin e prioritetëve ishte edhe rritja e kapaciteteve trajnuese prandaj sipas programit do të fokusohet në fushën e Krimit Kibernetik, Diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, në fushën e Lirisë së shprehjes dhe mediave dhe trajnime në fushën e Antitrafikimit.

Bazuar në kërkesat e dokumenteve strategjike edhe trajnimet e përbashkëta me profesionistët e tjerë ligjor, profesionet e lira dhe mundësi i trajnimeve online përmes platformës së mësimi në distancë.

Lista e moduleve trajnuese sipas fushave

Nr.	Nr. Sipas fushave	Penale	Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
1.	15	Pastrimi i parave dhe hetimi financiar	Dy tryeza nga dy ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtor profesionalë (përfituesit e ndryshëm në dy tryezat e planifikuara)	Tryezë e diskutimit	IRZ OPDAT
2.		Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë	Dy ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Hetuesit	Tryezë e diskutimit	OPDAT
3.		Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Dy tryeza nga dy ditë	Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtarë nga DKR, bashkëpunëtor profesionalë (përfituesit e ndryshëm në dy tryezat e planifikuara)	Tryezë e diskutimit	WBROLI OPDAT
4.		Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm	Dy ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore (Departamentet Speciale), Prokurorët e Prokurorisë Speciale, Prokurorët e Prokurorisë së Apelit duke mos përfshirur edhe prokurorët e prokurorisë themelore sipas nevojës, bashkëpunëtorët profesional dhe ekspertët e PSRK-së, si dhe zyrtarët e agjencive ligj-zbatuese që merren me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.	Tryezë e diskutimit	AD
5.		Krimet e luftës	Dy ditë	Gjyqtarë nga Departamenti Special, PSRK, Bashkëpunëtorë profesional dhe Policia e Kosovës.	Tryezë e diskutimit	AD&FDH
6.		Zbatimi i Udhëzuesve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit	Dy tryeza nga 1 ditë	Gjyqtarët, prokurorë si dhe mundësisht edhe udhëheqësit e këtyre institucioneve.	Tryezë e diskutimit	AD OPDAT
7.		Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështirësi i kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore	Dy ditë	Gjyqtarët penalistë.	Tryezë e diskutimit	UNODC
8.		Krimi kibernetik dhe kriptovalutat	Dy ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Hetuesit, Zyrtar të NJIF-it, Ekspertët e PSRK, Bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	AD OPDAT
9.		Dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues	Një ditë	Gjyqtarë, Prokurorë dhe Bashkëpunëtorë Profesionalë	Trajnim	AD OPDAT
10.		Gjykimi në mungesë	Një ditë	Gjyqtarë, Prokurorë dhe Bashkëpunëtor profesional.	Trajnim	AD OPDAT
11.		Përpilimi i aktakuzës, arsyetimi dhe vlerësimi i provave	Një ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët ligjor.	Trajnim	AD OPDAT

12.		Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore	Një ditë	Gjyqtaret, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Mbrojtësit e viktimave.	Trajnim	AD
13.		Strategjia e hetimit, masat e veçanta hetimore	Një ditë	Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtor profesional dhe Hetues policor.	Trajnim	AD OPDAT
14.		Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi	Një ditë	Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtor profesional dhe Hetues policor.	Trajnim	AD& QKRMT
15.		Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve	Dy trajnime nga 5 dite (10 dite trajnimi)	Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit në departamentin special, departamentin e krimeve te renda dhe departamentin e përgjithshëm.	Trajnim	UNDP/SAEK
Civile			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
16.	9	Anulimi i Kontratave	Dy ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore	Tryezë e diskutimit	AD
17.		Fitimi i pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit	Dy ditë	Gjyqtarët e gjykatës së Apelit, Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional	Tryezë e diskutimit	AD
18.		Kompensimi i Dëmit – Fitimi i humbur (renta)	Dy tryeza nga dy ditë	Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional	Tryezë e diskutimit	AD
19.		Procedura Jokontestimore	Dy ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Themelores dhe bashkëpunëtorët profesional	Tryezë e diskutimit	AD
20.		Procedura Përmbartimore	Dy ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional/eventualisht përmbartuesit privat	Tryezë e diskutimit	AD
21.		Procedura trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë	Dy ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, të Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional	Tryezë e diskutimit	AD
22.		Shqyrtimi paraprak i padisë në kontestet e punës, në kontestet e pengim posedimit dhe në kontestet e fyerjes dhe shpifjes – Afatshmëria/ lejueshmëria si prezumim procedural	Një ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore	Tryezë e diskutimit	AD
23.		Ndihma dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile	Një ditë	Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	AD
24.		Marrëdhëniet detyrimore me element të huaj dhe	Dy ditë	Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil;	Trajnim	GIZ

		bashkëpunimi juridik ndërkombëtar ne çështjet civile		gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil.		
Drejtësia për fëmijë			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
Penal						
25.	2	Veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit te fëmijëve – viktima të dhunës seksuale	Një ditë	Gjyqtarë dhe Prokurorë nga Departamenti për të Mitur, Mbrojtësit e viktimave Bashkëpunëtor profesional, Zyrtare Policor, Qendra për Pune Sociale	Trajnim	AD& QKRMT
26.		Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit dhe Masat dhe dënimet qe shqiptohen ndaj të miturit	Një ditë	Gjyqtarë për të mitur, prokurorë për të mitur, zyrtarë nga Shërbimi Sprovues	Trajnim	AD
Civile						
27.	1	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve në procedurën kontestimore dhe jo kontestimore	Dy tryeza, nga 2 ditë	Gjyqtarët e G jyk atës së Apelit dhe Gjykatave Themelore	Tryezë e Diskutimit	AD
Komerciale			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
28.	12	Njohuritë financiare	Një ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD
29.		Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare	Dy ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD
30.		Hulumtimi, shkrimi dhe arsyetimi ligjor në fushën komerciale	Dy ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtoreset profesional të Gjykatës Komerciale	Tryezë e diskutimit	AD
31.		Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtarë, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore	Dy ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtoreset profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD
32.		E drejta kontraktuese, kontratat e ndërtimit	Dy ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtoreset profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD
33.		Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare	Një ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtoreset profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD
34.		Procedura e falimentimit	Një ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtoreset profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD
35.		Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat dhe	Dy ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtoreset profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD

		specifikat e industrisë së TIK-ut, licencimit dhe të drejtave të pronësisë industriale				
36.		Ndërmjetësimi, mënyrat e referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit - raste praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit komercial, Elaborimi i rasteve praktike ndërkombëtare të rasteve komerciale në ndërmjetësim	Një ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD & USAID/ Drejtësia Komerciale
37.		Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Arbitrazhit vendor dhe të huaj	Një ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale	Trajnim	AD & USAID/ Drejtësia Komerciale
38.		Arbitrazhi në kontestet investitor-Shtet (ISDS)	Një ditë	Avokatët shtetërorë, përfaqësues nga Ministria e Tregtisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministrisë së Drejtësisë, gjyqtarët e Gjykatës Komerciale, ATK AKP	Simulimi	AD&GIZ
39.		Marrëdhëniet komerciale me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet komerciale	Dy ditë	Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në Gjykatën Komerciale në Kosovë	Trajnim	AD&GIZ
Administrative			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
40.	3	Mbrojtja gjyqësore në konfliktin administrativ	Një ditë	Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që përfshihen në procedurat e konflikteve administrative.	Trajnim	AD
41.		Mbrojtja gjyqësore në kontestet - çështjet e prokurimit publik	Një ditë	Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe zyrtarët e OSHP-së.	Trajnim	AD
42.		Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ	Një ditë	Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional	Trajnim	AD
Kushtetuese			Kohëzgjatja	Përfituesit		Në Bashkëpunim
43.	2	Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën	Një ditë	Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.	Trajnim	AD

		e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin civile				
44.		Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëminë penale	Një ditë	Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.	Trajnim	AD
KEDNJ			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
45.	4	Qasja në mjete juridike efektive	Dy ditë	Gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe bashkëpunëtorë profesional.	Trajnim	KE
46.		Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 5 dhe nenit 6 të KEDNJ	Dy ditë	Gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe bashkëpunëtorë profesional.	Trajnim	KE
47.		Liria e Shprehjes dhe Mbrojtja gjyqësore në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes - Trajnim i specializuar për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs)	Një ditë	Gjyqtarët dhe Prokuroret nga regjione të ndryshme.	Trajnim	AD&KE PRO-FREX
48.		Mbrojtja e të dhënave personale	Një ditë	Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët për Qasje në Dokumente Publike, Zyrtarët për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Trajnim	AD& Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)
E Drejta Evropiane			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
49.	2	Efekti i të Drejtës së Unionit Evropian	Një ditë	Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës	Trajnim	AD
50.		Unifikimi i legjislacionit penal me atë të vendeve të UE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në UE	Një ditë	Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës se Apelit dhe bashkëpunëtoret profesional	Trajnim	AD
Kundërvajtje			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
51.	2	Personat Juridik si kryerës të veprave kundërvajtëse	Një ditë	Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në Gjykatat e shkallës së parë	Trajnim	AD
52.		Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit	Një ditë	Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore	Trajnim	AD
Ndërmjetësimi			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
53.	1	Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit-raste	4 trajnime (përfshirë të gjitha	Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore dhe degëve, si dhe	Trajnim	AD &

		praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit, Ndërmjetësimi i detyrueshëm	regjionet) nga një 1 ditë	ndërmjetësuesit e regjioneve të atyre gjykatave		USAID/ Drejtësia Komerciale
Trajnimet Interdisiplinare			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
54.	1	Menaxhimi i lëndëve penale dhe orarit të gjykimeve	Një ditë	Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.	Trajnim	OSBE OPDAT
Dhuna në Familje			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
55.	4	Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore	Një ditë	Gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të çdo niveli dhe funksioni dhe mund të sugjerohet si parakusht për ndjekjen e moduleve të tjera të specializuara, nëse pjesëmarrësi/ja nuk ka ndjekur trajnim të mëparshëm në këtë fushë	Trajnim	KE
56.		Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale	Dy ditë	Gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional, mbrojtësit e viktimave	Trajnim	KE OPDAT
57.		Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare	Dy ditë	Gjyqtarët e gjykatave civile, dhe përfshinë aplikimin e urdhërit mbrojtës dhe/ose çështje të së drejtës familiare (p.sh. çështjet e kujdestarisë).	Trajnim	KE
58.		Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën	Dy ditë	Prokurorët,gjyqtarët, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë (p.sh. ekzaminerët mjeko-ligjorë)	Trajnim	KE OPDAT
Kundër Diskriminimit			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
59.	1	Antigjipsizmin	Një ditë	Gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, Profesionistë të profesioneve të lira	Trajnim	Terr Des Home
Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave/prokurorive			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
60.	1	Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë	Një ditë	Kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.	Trajnim	OPDAT (me theks te prokuroritë)
Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtar ligjorë			Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
Penale materiale						
		Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përgjashtimit të Kundërligjshmërisë, Pjesa e Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përgjashtimit të	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD

3	Kundërligjshmërisë, Pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat				
	Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD OPDAT
	Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK- se	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
Penale procedurale					
3	Fazat e procedurës penale	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD OPDAT (me theks në shkrimin dhe hulumtimin ligjor)
Civile materiale					
4	E drejta e trashëgimisë dhe e Drejta familjare	Dy ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	E drejta e punës	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	E drejta pronësore	Dy ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	E drejta e detyrimeve	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
Civile Procedurale					
3	Proceduara kontestimore	Tri ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	Proceduar përmbartimore	Një ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
	Dhuna në familje dhe Ndërmjetësimi -	Dy ditë për një grup	Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjorë	Trajnim	AD
Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial		Kohëzgjatja	Përfituesit	Metodologjia	Në Bashkëpunim
	Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	Një ditë	Administratorët, ndihmës administrator, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridike, zyrtarët e informimit, njësiti për	Trajnim	AD

9			vlerësimin e performances së prokurorëve dhe gjyqtarëve.		
	Shkathtësitë në komunikim	Një ditë	Përfitues të këtij trajnimi do të jenë zyrtarët për informim dhe monitorim të mediave, në gjykata dhe prokurori. Përfitues të trajnimit të njëjtë mund të jenë edhe zyrtarët tjerë që ndërveprojnë me palët në gjykata/prokurori.	Trajnim	AD
	Integriteti dhe sjelljet etike në administratën gjyqësore dhe prokuroriale	Një ditë	Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Trajnim	AD
	Menaxhimi i kohës dhe stresit	Një ditë	Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Trajnim	AD
	Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat	Dy ditë	Stafi i gjykatave, veçanërisht stafi që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët dhe stafin administrativ	Trajnim	AD
	Trajnimi për protokollin dhe Etiketa	Një ditë	Përfituesit e trajnimit janë gjyqtarët dhe stafi administrativ	Trajnim	AD
	Mbrojtja e sinjalizuesve	Një ditë	Zyrtarët administrativ të gjykatave dhe prokurorive dhe zyrtarët për sinjalizimin në gjykata dhe prokurori.	Trajnim	AD
	Mirëmbajtja e faqeve të gjykatave në Facebook dhe informimi i publikut përmes tyre	Një ditë	Përfitues të këtij trajnimi do të jenë zyrtarët për informim dhe monitorim të mediave, në gjykata dhe prokurori	Trajnim	AD
	Trajnimi Hyrës për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës gjyqësore	2 module 6 dite trajnimi	Stafi i sapo emëruar administratës gjyqësore	Trajnim	AD

TRAJNIMET NGA LËMIA PENALE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Raport i Vlerësimit të nevojave trajnues për Departamentin Special në GJ TH Prishtinë
- Strategjia për sundimin e Ligjit
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023

1. Pastrimi i parave dhe hetimi financiar

Pastrimi i parave dhe hetimi financiar janë vepra penale komplekse. Për hetimin e këtyre rasteve kërkohet koordinim institucional i shume akterëve të sundimit të ligjit. Ndërlikueshmëria e hetimit dhe gjyqimit të veprës penale të pastrimit të parave po ashtu është e shfaqur edhe në praktikën gjyqësore. Pastrimi i parave si proces që përdoret për të fshehur burimin e parave ose pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale dhe përgjithësisht përfshin shndërrimin e të ardhurave të krimit në një formë "të ligjshme", e që në mënyrë të drejtpërsëdrejti po ndikojnë në dëmet e konsiderueshme financiare dhe në zhvillimin ekonomik të vendit paraqet sfidë të përgjithshme shoqërore por edhe sfidë për sistemin juridik në Kosovë.

Pastrimi parave edhe si fenomen por edhe si vepër penale është trajtuar nga prokurorët dhe gjyqtarët, por në praktikën gjyqësore akoma ka sfida dhe dilema në drejtim të identifikimit të elementeve të veprave penale që ndërlidhen me pastrimin e parave dhe kualifikimin e saktë juridik të kësaj vepre penale. Fillimisht është kërkuar që për hetimin e pastrimit të parave të ekzistojnë vepra penale baze, që realisht ka komplikuar procedurën e hetimit. Po ashtu sfida tjetër është në bashkëpunimin e brendshëm dhe ndërkombëtar duke përfshirë edhe institucionet tjera të cilat duhet të japin kontributin proaktiv në zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e kryesve, në mesin e të cilave përfshihen NJIF, Dogana dhe Administratën Tatimore dhe institucionet e tjera ligj zbatuese, si dhe institucionet financiare sikurse bankat, subjektet financiare jo banka dhe zyrat e këmbimit valutor, nëpërmjet kanaleve të transferimit të parave, pagesave apo kredisë. Vëmendje duhet drejtuar po ashtu praktikave të bashkëpunimit ndërkombëtar në mes organeve të ndjekjes së Republikës së Kosovës dhe organeve të ndjekjes së vendeve të Bashkimit Evropian dhe po ashtu vendeve që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Domosdoshmëria për zbatimin e dispozitave të Kodit Penal dhe ndryshmeve në Kodin e Procedurës Penale duke i ndërlidhur ato me dispozitat e ligjit të veçantë që trajton pastrimin e parave si vepër penale, si dhe ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, por edhe në standardet ndërkombëtare dhe në veçanti ato të Bashkimit Evropian, kërkon që t'i dallojnë krimet tatimore dhe doganore dhe ato që ndërlidhen me pastrimin e parasë, të identifikojnë informacionin që mund ta marrin përmes kanaleve të FIU, Egmont, procedurat e vërtetimit të hyrave financiare nga veprat penale dhe të hyrave të ligjshme.

Trajnimi ka fokus në veçanti elementet e veprës penale të pastrimit të parasë, si dhe dallimi i pastrimit të parasë i ndërlidhur dhe i pastrimit të parasë i vetëm duke përfshirë hetimin dhe gjykimin si dhe praktikën gjyqësore e posaçërisht në praktikën e vendeve evropiane. Është me rëndësi që të këto vepra penale të hetohet veprimi kriminal, respektivisht aktiviteti kriminal dhe në këtë drejtim të zhvillohen hetimet.

Objektivat

- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me kualifikimin juridik të pastrimit të parave;
- Dallojnë pastrimin e parasë të ndërlidhur me vepër penale tjetër dhe i pastrimin e parave si vepër penale e veçantë;
- Kryejnë hetime pro aktive penale dhe financiare sigurojnë prova të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura;
- Identifikojnë kanalet e komunikimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar për të drejtuar hetimin në drejtimin e duhur;
- Zhvillojnë bashkëpunimin ndërkombëtar jo formal dhe formal me agjencitë dhe institucionet relevante në hetimin e pastrimit të parasë;
- Identifikojnë të paktën tri sfidat që mund të hasen në sigurimin e informacionit në nivel ndërkombëtar dhe të jene në gjendje që të gjejnë zgjidhjen e mundshme;
- Sekuestrojnë dhe konfiskojnë pasurinë e fituar me këto vepra penale;
- Krahasojnë legjislacionin vendor me atë të BE-së;
- Shqiptojnë sanksione adekuate penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale.

Përmbajtja

- ✓ Baza ligjore, vendore dhe ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe hetimet financiare;
- ✓ Elementet e veprës penale pastrimi i parave;
- ✓ Fazat e pastrimit të parave;
- ✓ Hetimi dhe sigurimi i provave në rastet e pastrimit të parave;
- ✓ Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me veprën penale – pastrimi i parave;
- ✓ Rast studimi nga praktika gjyqësore e Kosovës;
- ✓ Rast studimi nga praktika gjyqësore e Kosovës (Rasti NIKUMA);
- ✓ Rast studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ (Rasti Zuchen vs Nederland).

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Interpretimi i dispozitave ligjore për veprën penale shpëlarja e parave, diskutimi interaktiv, trajnimi rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

Përfituesit

Gjyqtarët e Departamentit Special, Prokuroret nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtare nga DKR, bashkëpunëtor profesionale (përfituesit e ndryshëm në dy tryezat e planifikuara).

Kohëzgjatja

Dy tryeza nga dy ditë (e para në periudhën janar-korrik dhe e dyta shtator-dhjetor 2024).

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Strategjia për sundimin e Ligjit
- Raporti i vlerësimit të nevojave për trajnime nga KGJK
- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023

2. Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë

Padyshim që mjeti më efikas në luftimin e kriminalitetit është konfiskimi i pasurisë. Është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme që në fazat më të hershme të mblidhen të dhënat dhe informacionet për pasurinë, të cilat do të japin mundësinë për të përcaktuar qartë, bazuar në këtë informacion, se cila nga format e konfiskimit të pasurisë do të jetë e zbatueshme në një rast specifik. Praktikuesit e ligjit mund të marrin parasysh dokumentin “Rrugët e konfiskimit” i cili është përshtatur me ndryshimet e reja ligjore të vitit 2019, si tek LKZK ashtu edhe tek Kodi Penal që ka hyrë po ashtu në fuqi në vitin 2019 por edhe të KPP-së. Po ashtu, këtu është inkorporuar edhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar dhe institucionet kryesore që mund të ofrojnë ndihmë në këtë drejtim. Dokumenti “Rrugët e konfiskimit” rekomandohet të lexohet nga të gjithë zbatuesit e ligjit dhe gjithashtu përmban shembuj të dobishëm të skenarëve praktik.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës¹ (në vitin 2019) dhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës² (shkurt 2023), si ligje të reja, kanë hyrë në fuqi në periudha kohore të ndryshme dhe që kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e sekuestrimit/konfiskimit. Përderisa ish KPRK ka pasur disa nene që kanë rregulluar këtë fushë, në KPRK-në e re kemi vetëm nenin 92 që rregullon materien në fjalë. Pra, për zbatuesit e ligjit, është më e thjeshtë, më e lehtë dhe më konsistente përdorimi i autorizimeve ligjore në këtë fushë. Ndërsa, KPP, ka ndryshime thuajse rrënjësore, por që këto ndryshime janë bërë për të evituar sfidat dhe problemet që janë hasur në praktikë. Kështu, përderisa në ish KPP-në e vjetër kemi pasur afate të ndryshme tek ngrirja dhe sekuestrimi (3 respektivisht 5 ditë) dhe po ashtu ka pasur procedura të ndryshme për ngrirjen dhe sekuestrimin, tash me ndryshimet e reja, do të jetë shumë më e lehtë zbatimi neneve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin, sepse kemi një afat të vetëm (afati 7 ditësh për UNP) dhe kemi një procedurë të thjeshtë dhe të vetme për procedurën që duhet të ndiqet. KPRK dhe KPP përmbajnë nene me mundësi procedurale që më herët nuk kanë qenë. Mesazhi i përgjithshëm që dërgohet është se “*KRIMI NUK SHPAGUHET*” dhe se herët a vonë, shteti përmes mekanizmave ligjor do të bëjë konfiskimin e dobisë pasurore të kundërligjshme. Një ndryshim i madh vërehet tek neni 92 i KPRK-së që përcakton se fillimisht tentohet të konfiskohet dobia pasurore e përfituar me veprë penale dhe mjeti i përdorur në kryerjen e veprës penale. Kur një gjë e tillë ndodh, atëherë procedura rreth konfiskimit përfundon në atë hap, mirëpo nëse për çfarëdo arsye dobia pasurore apo instrumentaliteti më nuk është në dispozicion për tu konfiskuar, atëherë, gjykata ka mundësinë e përcaktimit të vlerës së barasvlershme. Kur as kjo nuk është e mundur, neni 92 ka përcaktuar një mundësi shtesë që nuk ka ekzistuar më parë dhe kjo është konfiskimi i *SECILËS* pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlershme dhe kjo pasuri mund të jetë edhe nëse bëhet fjalë për pasurinë e ligjshme të të pandehurit (shih nenin 273.3 të KPP-së). Futja në KPRK dhe KPP e konceptit të vlerës zëvendësuese ka për qëllim ti japë efekt të plotë juridik dispozitës që gjendet në nenin 92.2 të KPRK-së. Neni 92 par. 2 i KPRK-së ka për qëllim të sigurohet që në rast se i pandehuri përfiton dobi pasurore nga një veprë penale, dhe dobia e caktuar nuk gjendet akoma në dispozicion, atëherë gjykata mund të konfiskojë pasuri shtesë të të pandehurit (e ligjshme sipas prejardhjes) deri në vlerën e dobisë pasurore. Ky nen është hartuar që të sigurojë parimin se një i pandehur nuk duhet

¹ Në tekstin në vijim KPRK-së.

² Në tekstin në vijim KPPRK-së.

të përfitojë nga aktiviteti i tij/saj kriminal. Ish neni 97 par. 1 i KPRK-së së vitit 2013 nuk është përdorur gjerësisht nga prokurorët apo gjykatat, dhe që mundëson që të *obligojë* të pandehurin që të paguaj vlerën zëvendësuese në vend se të konfiskojë zëvendësimin e vlerës. Po ashtu, as ish KPP e vjetër nuk ka pasur dispozita për bllokimin e pronës së tillë shtesë. Kjo tashmë është korrigjuar me ndryshimet e bëra si në nenin 92 të KPRK-së, ashtu edhe në dispozitat e reja që janë përfshirë në KPP. Andaj, dispozitat e reja mundësojnë situatat kur konfiskimi nuk mund të realizohet nga pasuritë e të pandehurit apo të një pale të tretë që ka pranuar pronën e transferuar. Në rastin e tillë, këta persona do të duhet të paguajnë një shumë të hollash që përkojnë me vlerën e pronës që i nënshtrohet konfiskimit dhe gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e pronës së tillë. Për më tepër, neni 97.1 i ish KPRK-së së vitit 2013 i referohet vetëm të pandehurit e jo palës së tretë e cila ka pranuar pronën e transferuar e cila nuk është më në dispozicion për konfiskim. Kjo situatë është korrigjuar si në nenin 92 të KPRK-së, ashtu edhe në dispozitat e reja në KPP. Ndryshime të reja janë përfshirë edhe në nenin 19 të KPP-së, apo tek Përkufizimet. Neni 19.1.34 – 19.1.41 përmbajnë një gjuhë të harmonizuar dhe konsistente përgjatë gjithë KPP-së, madje edhe LKZK-së, dhe për zbatuesit e ligjit do të jetë shumë më e lehtë, më e qartë dhe më e kuptueshme rruga procedurale e zbatimit të tyre. Kështu, edhe nëse ka pasur ndonjë dilemë eventuale e zbatimit të ndonjë dispozite, tashmë tek neni 19 apo përkufizimet, është përdorur një gjuhë e tillë e cila do të ndihmojë jashtë mase zbatuesit e ligjit në të kuptuarit më të mirë, më të lehtë dhe më të qartë të këtyre dispozitave. Një rëndësi të posaçme e marrin edhe sqarimet që kanë të bëjnë me shitjen apo tjetërsimin e aseteve në fazën sa më të hershme të sekuestrimit të një aseti. Sërish, në të kaluarën ka pasur hezitime të shitjes së aseteve të tilla, duke bërë kështu që buxheti i vendit të dëmtohet eventualisht sepse pas kalimit të afatit prej disa vitesh, asetet në fjalë janë zhvlerësuar. Andaj zbatuesit e ligjit, inkurajohen që:

- Të rrisin bashkëpunimin me AAPSK-në për të bashkëpunuar me Planifikimin para sekuestrimit për të rritur gjasat e sekuestrimit të suksesshëm;
- Të zbatojnë sa më shpesh dispozitat e KPP-së që lejojnë dhe inkurajojnë shitjen në fazë sa më të hershme të aseteve që zhvlerësohen;
- Që të evitojnë situatat e paraqitura në të kaluarën dhe të bëjnë dallimin e lejueshmërisë së shitjes së aseteve si dobi pasurore dhe atyre të listuara në aktakuzë si provë, sepse asetet e listuara si provë nuk mund dhe nuk duhet të propozohen për shitje dhe
- Të përpilojnë arsyetime më të mira të këtyre propozimeve për të rritur gjasat për aprovim të kërkesave të tilla nga ana e gjykatave.

Qëllimi kryesor i tryezës është trajtimi i sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e këtij instituti, rëndësia e nenit 92 të KPRK-së, rruga drejt konfiskimit, kontrolli dhe sekuestrimi i përkohshëm i provave dhe pasurisë së specifikuar, urdhri i përkohshëm i ndalimit, kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar, masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar, urdhri ndalues përfundimtar, konfiskimi, konfiskimi i mjetit, konfiskimi i dobisë pasurore, konfiskimi i dhuratës së njollosur, zëvendësimi i vlerës së pasurisë, pasuria shtesë, hetimi për konfiskim, aplikimi i Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe shpëlarja e parave. Aktualisht sipas dispozitave të KPPK parashohin një mori dispozitash ligjore që rregullojnë këto institute, andaj kjo tryezë synon edhe trajtimin në kuptimin praktik dhe ligjor të dispozitave të sekuestrimit dhe konfiskimit.

Tryeza në thelb do të shërbente për dy qëllimet për gjyqtarët dhe prokurorët dhe atë:

- Të reflektohet praktika e ndërtuar gjyqësore;
- Të shfaqen rastet praktike të cilat do të mund të përdoren si modele të mira për rastet e ardhme.

Për tu arritur këto dy qëllime, duhet të merren parasysh disa faktorë themelor, që do ta reflektonin tryezën me rezultate pozitive, e që faktorët e tillë do të ishin: Hulumtimet dhe zgjedhja e rasteve praktike të bëhet me kujdes dhe specifikat e problemeve praktike në kuadër të sekuestrimit dhe konfiskimit. Për ta zbatuar me efektivitet dhe rezultat tryezën, duhet të jenë të gatshëm dhe të përgatitur mjaftueshëm moderatorët e tryezës e që do të konsistonte në mundësin e dhënies së komenteve mbështetur në praktikën gjyqësore bazuar në legjislacionin në fuqi për çdo çështje që mund të trajtohet, qoftë të sekuestrimit qoftë të konfiskimit. Korniza e agjendës që do të përfshinte temat si të tilla duhet të zgjidhen me shumë kujdes, e që do të bazohet mbi aspektet e problematikave aktuale procedurale dhe materiale në kontekstin e praktikës së ndërtuar. Praktika gjyqësore e përzgjedhur për tryezën do të ndihmonte që të reflektonte zbatimin e drejt të dispozitave nga gjyqtarët dhe prokurorët për të reflektuar standardet e ndërtuara praktike të pranueshme brenda instancave gjyqësore. Kjo tryezë ka synim interaktivitetin dhe përfshirjen e të gjithë pjesëmarrësve si dhe ushtrime të rasteve. Moderator-i/ët duhet të jenë të gatshëm dhe të diskutojnë rrethanat e paraqitura të rastit/rasteve në raport me temën duke nxitur analizën dhe shterimin e dilemave të rrethanave të rastit, gjithnjë duke synuar në dhënien e shpjegimeve bazuar në praktikën e konsoliduar dhe në dispozitat ligjore me interpretimin e drejt.

Në përfundim të punimeve të tryezës moderatorët hartojnë raportin e tryezës me rezultate të cilin do të mund të shërbente për të adresuar ndonjë çështje në kuadër të Akademisë apo që do të reflektonte në domosdoshmërinë e qëndrimeve parimore të gjykatës Supreme për të unifikuar zbatimin e ligjeve nga gjyqtarët, e që do të reflektonte edhe tek prokurorët.

Objektivat

- Identifikimi i risive ligjore të Kodit të Ri të Procedurës penale për sekuestrimin dhe konfiskimin;
- Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat në të gjitha nivelet;
- Identifikimi i rasteve të vazhdimin të procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit edhe pas ngritjes së aktit akuzues;
- Identifikimin e problemeve lidhur me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë;
- Adresimi i problemeve përmes praktikës së njësuar gjyqësore si përfundim;
- Sfidat e zbatimit të ligjit për Kompetenca të Zgjeruara, për konfiskim dhe sekuestrim;

Përmbajtja

- ✓ Bazat e konfiskimit me theks të veçantë në neni 92 të KPRK-së;
- ✓ Kontrolli, sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi;
- ✓ Urdhri ndalues i përkohshëm dhe përfundimtar;
- ✓ Zëvendësimi i vlerës së pasurisë;
- ✓ Konfiskimi i pasurive shtese;
- ✓ Hetimi për konfiskim;
- ✓ Kërkesat dhe urdhrat për kufizim dhe kërkesat për verifikim të pasurisë sipas LKZK-së.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Përfituesit

Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Hetuesit

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Raport i Vlerësimit të nevojave trajnues për Departamentin Special në GJ TH Prishtinë
- Strategjia për sundimin e Ligjit

3. Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Korrupsioni në çdo shoqëri është aktual dhe sfidues, ndryshimet qëndrojnë vetëm në nivelin e shtrirjes së tij. Paralelisht është sfidë e veçanta legislative por edhe për zbatuesit e ligjit nga ana tjetër nga fakti se ligjërish është i vështirë të argumentohet. Përpos objektit mbrojtës që ka korrupsioni në kapitullin e veçantë që përfshihet korrupsioni, karakteristik e tij është se elementet korruptive i gjejmë edhe të veprat tjera penale e të përfshira në kapituj të tjerë të drejtës penale. Kjo vepër kryhet nga personat zyrtarë që kanë një funksion publik ose ushtrojnë një shërbim publik. Në këtë drejtim korrupsioni zyrtar nënkupton realizimin e ndonjë të drejte apo interesi për të cilin personi zyrtar apo grupi i caktuar nuk ka bazë ligjore ose realizimi i të drejtave dhe interesave. Dashja direkte si element kryesor i kësaj veprë penale, qëllimi kriminal dhe aktiviteti kriminal janë çështje të cilat do të elaborohen gjatë këtyre sesioneve trajnuese.

Objektivat

- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të kapitullit XXXIII të veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare;
- Të identifikojnë elementet esenciale të secilës formë të veprave penale të këtij Kapitulli;
- Të zgjerojnë njohuritë rreth pasojave dhe rrezikshmërisë së këtyre veprave penale.

Përmbajtja

- ✓ Diskutime lidhur me elementet e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare;
- ✓ Dashja si element i veprës penale të korrupsionit, qëllimi kriminal;
- ✓ Çështja e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfitimit;
- ✓ Qëllimi si element për vërtetimin e veprës penale të korrupsionit;
- ✓ Vlerësimi i provave bindëse (të drejtpërdrejta) dhe rrethanore;
- ✓ Krijimi i figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethanore;
- ✓ Mashtrimi në prokurim si vepër penale e ndërlikuar; Mashtrimet fiskale, Shmangia nga tatimi/Dogana;
- ✓ Gjykimi në mungesë;
- ✓ Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar;
- ✓ Konflikti i interesit; Marrja e ryshfetit; Dhënia e ryshfetit;

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Interpretimi i dispozitave ligjore për veprën penale korrupsioni zyrtar, diskutimi interaktiv, trajtimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës, vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, rasteve studimi nga praktika gjyqësore ndërkombëtare.

Përfituesit

Gjyqtaret e Departamentit Special, Prokurorët nga PSRK, Prokurorë nga DKR, gjyqtare nga DKR, bashkëpunëtor profesionalë (përfituesit e ndryshëm në dy tryezat e planifikuara).

Kohëzgjatja

Dy tryeza nga dy ditë (e para në periudhën janar-korrik dhe e dyta shtator-dhjetor 2024)

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Raport i Vlerësimit të nevojave trajnues për Departamentin Special në GJ TH Prishtinë
- Rrjeti i Gazetarisë Hulumtuese në Ballkan - BIRN
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit - PKZMSA
- Plani Kombëtar për integrim Evropian 2023-2027
- Trajnuesi i Përhershëm në AD (Ramadan Gashi)

4. Terrorizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, si në nivel nacional njashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën e individit, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e funksionimit të shoqërisë. Shteti ka detyrimin dhe mbart përgjegjësinë kryesore për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, si edhe për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore strategjike të Republikës së Kosovës. Strategjia kundër terrorizmit si dhe masat tjera legjislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe, janë të ndërlidhura me prioritet strategjike për “Qeverisja të Mirë dhe Sundimit të Ligjit.” Për shkak të pranisë së elementëve të ekstremizmit dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm, janë hartuar një mori instrumentesh të rëndësishëm ligjor, ku fokus ka qenë lufta efikase ndaj këtyre dukurive të kundërligjshme, gjithnjë nga perspektiva e instrumenteve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht ndjekjes dhe gjykimit. Marrë në konsideratë nevojën e ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe të zyrtarëve tjerë të agjencive ligj-zbatuese shihet e domosdoshme që ky komunitet i ligj-zbatuesve të përfitojnë nga këto cikle trajnimesh me synim të ngritjes së njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në funksion të parandalimit, hetimit dhe gjykimit efektiv, të pavarur dhe profesional.

Objektivat

- Avancojnë njohuritë rreth kornizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare kundër terrorizmit;
- Kuptojë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin;
- Demonstrtojë teknikën e hetimit dhe të provuarit të terrorizmit, me theks të veçantë për liritë dhe të drejtat e njeriut, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbrojtjen e viktimave;
- Krahasojë lidhjet ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar;
- Zbatojnë drejtë ligjin lidhur me sanksionet penale ndaj kryerësit të veprave penale të terrorizmit.

Përmbajtja

- ✓ Korniza ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm;
- ✓ Të kuptuarit dhe përballja me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin;
- ✓ Strategjia kombëtare kundër terrorizmit në Kosovë;
- ✓ Parandalimi i terrorizmit, si fokus strategjik i përpjekjeve antiterroriste;

- ✓ Ndërlidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit dhe ekstremizmit te dhunshëm .
- ✓ Teknikat e hetimit dhe të provuarit e veprave penale të terrorizmit;
- ✓ Korniza strategjike dhe institucionale e bashkëpunimit përfshirë dhe atë ndërkombëtar në çështjet kundër terrorizmit;
- ✓ Viktimat, liritë dhe të drejtat e njeriut të rrezikuara nga veprimet dhe pasojat e veprave penale të terrorizmit;
- ✓ Sanksionet penale kundër kryerësve të veprave penale të terrorizmit.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Tema e këtij trajnimi do të ligjërohet me ligjërata interaktive, përkatësisht do të kombinohet me raste studimore, duke u përcaktuar në zgjidhjen e detyrave individuale dhe atyre grupore brenda vijuesve.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore (Departamentet Speciale), Prokurorët e Prokurorisë Speciale, Prokuroret e Prokurorisë së Apelit duke mos përjashtuar edhe prokuroret e prokurorisë themelore sipas nevojës, bashkëpunëtorët profesional dhe ekspertët e PSRK-së, si dhe zyrtarët e agjencive ligj-zbatuese që merren me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023
- Raport i Vlerësimit të nevojave trajnues për Departamentin Special në GJTH Prishtinë
- Rekomandimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit

5. Krimet e luftës

Gjatë vitet 90-ta, Kosova ashtu si edhe vende të tjera në ish Jugosllavi kanë kaluar nëpër luftërat të cilat kanë ndodhur në territorin e ish-Jugosllavisë. Vetëm gjatë periudhës së luftës në Kosovë (28 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999), sipas të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) janë vrarë apo zhdukur rreth 12, 535 persona, ku rreth 80% të këtyre janë viktimat civile. Këto krime janë hetuar dhe gjykuar kryesisht nga personeli ndërkombëtarë. Pra fillimisht këto krimet janë hetuar dhe gjykuar nga TPNJ dhe misionet ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK dhe EULEX). Që nga qershori i vitit 2014 ka filluar transferimi i kompetencave nga EULEX-i tek gjyqësori vendor, ku edhe përfundimisht në qershor të vitit 2018 këto kompetenca kanë kaluar tek gjyqësori vendor. Gjyqtarët dhe prokurorët vendor kanë nevojë në ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë pasi që nuk ka pasur ndonjë praktike të gjatë vendore gjyqësore në këtë drejtim.

Pjesëmarrësit fillimisht do të njoftohen lidhur me legjislacionin penal në tërësi në Kosovë i cili trajton veprat penale të krimeve të luftës, e po ashtu edhe legjislacionin penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale apo ligjin më të favorshëm për kryerësit e kësaj vepre penale. Do të njoftohen me veprat penale të cilat parashihen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, të cilat parashohin dhe sanksionojnë veprimet e kryerësve të veprave penale të krimeve të luftës e të cilat do të prezantohen të ndërlidhura me konventat ndërkombëtare si tërësi dhe Konventat e Gjenevës të cilat mbulojnë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin në veçanti.

Theksi i veçantë në këtë trajnim do të jetë kategorizimi i përgjegjësisë së krimeve të luftës gjithnjë duke pas për bazë natyrën e formave të bashkëpunimit, ndihmës, nxitjes, bashkëkryerjes, ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe përgjegjësisë komanduese, duke synuar që të analizohen rastet praktike vendore dhe ndërkombëtare të tribunaleve për të vlerësuar edhe ndëshkueshmërinë karshi natyrës së përgjegjësisë së krimeve të luftës. Rëndësi do të kenë edhe format e inkriminimit të krimeve të luftës e me theks të veçantë dhunimet seksuale si vepër e kategorizuar në shkelje të drejtës ndërkombëtare. Ky trajnim synon që tërësisht të ndërtohet mbi rastet praktike vendore dhe ndërkombëtare për krimet e luftës, për të evidentuar të metat në praktiken gjyqësore, qoftë te rasteve që kanë marrë epilog apo të rasteve që janë konsideruara se zgjidhjet sipas vendimeve gjyqësore nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore, kjo me qëllim që të ndërtohet një praktike e qëndrueshme dhe duke synuar që të mos përsëriten gabimet e evidentuara tashmë në praktiken gjyqësore.

Ndryshimet legjislative të fundit kanë futur risinë e gjykimit në mungesë, respektivisht gjykimin në mungesë të rasteve të krimeve të luftës, ku me kornizën ligjore është përcaktuar decidivisht se çfarë kritere duhet të plotësohen për ta procedur një rast krimeve të luftës në mungesë, cilat janë premiset procedurale të cilat duhet të plotësohen nga organeve të ndjekjes penale e cilat nga gjykata për ta procedur një rast të krimeve të luftës. Ky trajnim do të bëjë përpjekje që t'i trajtoj si objektiva trajnimi këto kritere ligjore, apo edhe vet legjislacionin e pjesët e tij të cilat e rregullojnë çështjen e gjykimit në mungesë. Çështja e gjykimit në mungesë është mase e rëndësishme të trajtohet tek rastet e krimeve të luftës, por po aq e rëndësishme është edhe trajtimi i provave rrethanore në rastet e krimeve të luftës dhe gjetja e përgjegjësisë penale mbi këto prova. Në këto trajnime gjyqtarë dhe prokurorë do të kenë mundësi që të shkëmbejnë përvojat me ekspertë ndërkombëtarë

në ndjekjen e krimeve të luftës sipas formave të përgjegjesisë komanduese dhe të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, këto forma të përgjegjesisë të cilat janë zhvilluar aq shumë nga TPNJ. Po ashtu në këtë trajnim do të trajtohet edhe çështja e gjyqimit në mungesë dhe ndryshimeve legislative në raport me gjykimin në mungesë, që paraqet një nga sfidat e mëdha të trajtimit të rasteve të krimeve të luftës.

Objektivat

- Përvetësojnë njohuritë për tu marrë me rastet e krimeve të luftës;
- Njohin format e zbatueshme të përgjegjesisë penale për krimet e luftës;
- Njohin përgjegjësinë komanduese;
- Përvetësojnë njohuri në zbatimin e ndryshimeve legislative në raport me gjykimin në mungesë të krimeve të luftës.

Përmbajtja

- ✓ Gjykimi në mungesë, gjykimi i rasteve të krimeve të luftës në mungesë, provat rrethore në vërtetimin e përgjegjesisë për rastet e krimeve të luftës, gjenocidi dhe dallimet me krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, gjykimi i personit të njëjte për disa veprime brenda krimeve të luftës, respektivisht periudha kohore e kryerjes së krimeve të luftës dhe dënimi i dyfishtë apo me shumë për veprimet brenda periudhës së njëjte kohore.
- ✓ Format e zbatueshme të përgjegjesisë penale për krimet e luftës (konflikti i armatosur, pjesëmarrja në formacionet ushtarake ose paraushtarake në konfliktet e armatosura, etj);
- ✓ Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit në zbatimin e të drejtës penale ndërkombëtare në juridiksionin e Kosovës;
- ✓ Ndërmarrja e përbashkët kriminale;
- ✓ Format tjera të bashkëpunimit;
- ✓ Përgjegjësia komanduese;
- ✓ Gjenocidi;
- ✓ Vlerësimi dhe analizimi i provave në rastet e krimeve të luftës, sidomos në sfondin e praktikës së tribunaleve ndërkombëtare;
- ✓ Shfrytëzimi i mekanizmave ndërkombëtar, tribunaleve ndërkombëtare në sigurimin e provave për rastet e krimeve të luftës.
- ✓ Gjykimi në mungesë;
- ✓ Vendimet e Strasburgut;
- ✓ Interpretimi i konventave ndërkombëtare

Metodologjia: Tryezë e Diskutimit

Përfituesit: Gjyqtare nga Departamenti Special, PSRK, Bashkëpunëtorë profesional dhe Policia e Kosovës.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese 27 korrik 2023
- Raporti i monitorimit nga EULEX

6. Zbatimi i Udhëzueseve për politikën ndëshkimore, unifikimi i praktikës për matjen së dënimit

Politika ndëshkimore paraqet sfidë të vazhdueshme për gjyqtarët me rastin e caktimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rezultat i kësaj janë identifikuar probleme të shumta në trajtimin e pabarabartë të kryerësve të veprave penale dhe mos konsistencë në shqiptimin e dënimeve dhe kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e transparencës dhe besimin e publikut. Me qëllim të evitimit të këtyre të metave dhe ndihmës për gjyqtarë dhe veçanërisht unifikimit të politikës ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr udhëzuesin për politikën ndëshkimore dhe tabelën për caktimin e dënimit për kryerësin e veprës penale dhe veprën penale të kryer. Duke marrë parasysh dobësitë dhe mangësitë e evidentuara në politikën ndëshkimore është formuar Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore i cili në vazhdimësi përcjellë dukuritë dhe sfidat që gjyqtarët përballen me rastin e zbatimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore dhe gjatë punës së tij në vazhdimësi nxjerr udhëzime specifike përkritazi me harmonizimin e politikës ndëshkimore dhe të cilat do të prezantohen dhe diskutohen gjatë këtyre tryezave që planifikohen të organizohen. Qëllimi i trajnimit është zbatimi i mirëfilltë i metodave të matjes së dënimit nga të gjithë gjyqtarët, por njëkohësisht që prokurorët dhe mbrojtësit e viktimave të mund të kontribuojnë në ndriçimin e rrethanave para gjykatës që do të ndikonin për matjen e drejt të dënimit, në përputhje me udhëzuesit e politikës ndëshkimore. Po ashtu të trajtohen aspektet specifike të udhëzuesve të dënimeve siç është udhëzuesi i politikës ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit, në mënyrë që të krijohen standarde të barabarta të matjes së dënimit për të gjithë të pandehurit në procedurë. Gjithashtu edhe udhëzuesi lidhur me korrupsionin do duhej të inkorporohej si pjesë përbërëse e sesionit të trajnimit meqë problematikat e sqaruara në udhëzues paraqesin baze shume të mira për aplikimin e të njëjtës në praktike.

Gjithashtu edhe udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit për rolin e prokurorit në politiken ndëshkimore, që ka për synim qartësimin dhe shpjegimin e rolit të prokurorit gjatë të gjitha fazave të procedurës penale në përgatitjen e tij profesionale lidhur me mbledhjen e informacioneve dhe prezantimin me sukses para gjykatës gjatë seancës për matjen e dënimit.

Objektivat

- Analizojnë rëndësinë e përcaktimit të drejtë dhe të saktë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese;
- Zbatojnë rrethanat relevante me rastin e caktimit të dënimit;
- Analizojnë zbatimin e udhëzuesit dhe aktivitetin e Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.
- Kuptojnë dhe analizojnë udhëzuesin për korrupsion.
- Kuptojnë udhëzuesin për rolin e prokurorit në politiken ndëshkimore

Përmbajtja

- ✓ Rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të dënimit;
- ✓ Zbatimi i udhëzuesve për politikën ndëshkimore;
- ✓ Aktiviteti i Komisionit Konsultativ për Politikë Ndëshkimore.

- ✓ Metodologjia e zbatimit të udhëzuesit për matjen e dënimit;
- ✓ Metodologjia e vlerësimit të rrethanave të kategorisë së përgjegjësisë dhe të dëmit;
- ✓ Ndarja e kategorive për matjen e dënimit për veprat penale të korrupsionit;
- ✓ Unifikimi i praktikës për matjen e ndikimit të trajnimit;
- ✓ Seanca për matje të dënimit, shpallja;
- ✓ Risitë e KPK-së dhe arsyetimi gjatë shpalljes.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Zhvillimi i aktiviteteve në forme tryezave në aspekt regjional. Pjesëmarrja në tryeze të zbatuesve të këtyre udhëzuesve dhe theksimi i problematikave gjatë zbatimit në praktike të udhëzuesve për matjen e dënimit do të ishte me interes për pjesëmarrësit e gjithashtu edhe konkluzionet që do të dilnin nga këto tryeza do të ndihmonin në qasjen si dhe aplikimin e drejtë në praktike.

Përfituesit

Gjyqtarët, prokurorët si dhe mundësisht edhe udhëheqësit e këtyre institucioneve.

Kohëzgjatja

Dy tryeza, nga 1 ditë, përfshirë regjionet si:

- Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjiilan dhe
- Pejë, Gjakovë, Prizren.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Zyra e OKB-së për Drogë dhe Krim -UNODC - Programi Global i Armëve të Zjarrit

7. Gjykimi i rasteve me armë të zjarrit, Vështrim i kërcënimeve të reja dhe kompleksitetet ligjore

Tryeza synon që të avancojë njohurinë e gjyqtarëve lidhur me armët e zjarrit, duke u fokusuar në kontekstin në të cilin armët e zjarrit prezantohen në rastet ligjore. Gjithashtu do të ofrohet një vështrim më të thellë në teknologjinë e armëve, aspektet ligjore, dhe rreziqet e reja, duke i përgatitur gjyqtarët që të bëjnë një analizë më të mirë dhe interpretim të provave dhe argumenteve gjatë gjykimit të rasteve me armë zjarri.

- Mënyra si të interpretohen dhe analizohen dëshmitë e ekspertëve lidhur me armët e zjarrit.
- Kuptimi i ndikimit të avancimeve në fushën e teknologjisë së armëve të zjarrit në rastet ligjore.
- Njohja e implikimeve ligjore të rreziqeve aktuale si, armët artizanale dhe ato të printuara në 3D (*ghost guns*).
- Balancimi i njohurive teknike me kornizën ligjore në rastet e ndërlidhura me armët e zjarrit.

Si të interpretohen dhe vlerësohen dëshmitë e ekspertëve të armëve të zjarrit?

- Kuptimi i ndikimit të avancimit të teknologjisë së armëve të zjarrit në rastet ligjore.
- Njohja e implikimeve ligjore të rreziqeve aktuale si armët artizanale dhe armët e printuara në 3D (*ghost guns*).
- Sfidat në dallimin mes modifikimeve të ligjshme dhe të paligjshme të armëve të zjarrit.
- Balancimi mes njohurisë teknike me kornizat ligjore në rastet e ndërlidhura me armët e zjarrit.

Ushtrim praktik për identifikimin dhe gjurmimin e armëve të zjarrit. Analizë e rasteve studimore kur teknologjia e armëve të zjarrit ka luajtur rol kryesor, Eksplorimi i sfidave dhe precedentëve në rastet që kanë të bëjnë me rreziqet e reja të armëve të zjarrit, Vlerësimi i rolit të gjyqtarëve në rastet me prova komplekse të armëve të zjarrit.

Objektivat

- Zhvillimi i njohurisë lidhur me armët e zjarrit në kontekst të procedurave ligjore;
- Avancimi i aftësisë për të vlerësuar në mënyrë kritike dëshmitë e ekspertëve dhe provat e ndërlidhura me armët e zjarrit;
- Fitimi i njohurive lidhur me sfidat ligjore të paraqitura nga teknologjitë e reja dhe rreziqet e reja nga armët e zjarrit;
- Kuptimi i zhvillimeve të kornizës ligjore në raport me armët e zjarrit.

Përmbajtja

- ✓ Armët e zjarrit, pjesët e tyre, municioni dhe gjurmimi i armëve;
- ✓ Përvojë praktike me lloje të ndryshme të armëve të zjarrit, duke përfshirë pistoletat, revolverët, pushkët dhe municionet e tyre. Kuptimi i informatave që derivon nga shënjimi i armëve të zjarrit në rastet penale dhe rëndësia e tyre për gjurmimin e armëve në rastet e armëve të paligjshme;

- ✓ Armët e zjarrit në sistemin ligjor;
 - Pasqyrë e mënyrës se si armët e zjarrit trajtohen sipas ligjit, duke përfshirë përkufizimet statutores, kategorizimet dhe dallimet ligjore të rëndësishme për shqyrtim gjyqësor;
- ✓ Interpretimi i provave forenzike
 - Eksplorim i hollësishëm për mënyrën se si provat forenzike lidhur me armët e zjarrit mbledhen, analizohen dhe prezantohen në gjykatë, dhe implikimet e tyre në gjykim.
- ✓ Avancimet e fundit teknologjike
 - Kuptimi i ndikimit të avancimeve të fundit teknologjike të armëve të zjarrit, të tilla si armët inteligjente, dhe implikimet e tyre ligjore dhe etike.
- ✓ Sfidat e reja ligjore, diskutim lidhur me sfidat e reja në legjislacionin për armët e zjarrit, përfshirë ngritjen e armëve të pagjurmueshme dhe artizanale (p.sh. ghost guns) dhe kompleksiteti ligjor që këto paraqesin
- ✓ Perspektiva globale lidhur me legjislacionin për armët e zjarrit
 - Analizë krahasimore e ligjeve për armët e zjarrit dhe rastet në gjykatë nga juridiksione të ndryshme, duke pasqyruar një kuptim më të gjerë për kornizën ndërkombëtare ligjore.

Metodologjia: Tryezë e diskutimeve

Diskutime në panel me ekspertë të forenzikës, ekspertë ligjor dhe zyrtarë të zbatimit të ligjit, rishikime interaktive të rasteve studimore dhe diskutime në grupe, ligjërata lidhur me sfidat e reja ligjore në legjislacionin për armët e zjarrit.

Përfituesit

Gjyqtarët penalistë.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023
- Raport i Vlerësimit të nevojave trajnues për Departamentin Special në GJ TH Prishtinë

8. Krimi kibernetikë dhe kriptovalutat

Me rritjen e përdorimit të internetit dhe teknikave të sofistikuar, lirisht mund të thuhet se gjendemi në një revolucion teknologjik, prandaj edhe krimi Kibernetikë është sfidë për shoqërinë e sotme. Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe veçanërisht i internetit ka marrë një rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Ky fenomen prek jo vetëm aktivitetet e një organizimi qoftë ai shtetëror apo privat, i implikuar në sferën e biznesit apo të një aktiviteti jo fitimprurës, por mund të prekë dhe njeriun e thjeshtë në aktivitetin e tij të përditshëm, në sferën e tij private apo profesionale. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime por në të njëjtën kohë edhe një sërë problemesh. Lufta kundër krimit kibernetike është tepër sfiduese, sidomos pas pandemisë Covid 19, kemi rritje të dukshme të këtyre krimeve. Për shkak të natyrës dinamike të teknologjisë, *modus operandi* i individëve të përfshirë në këto aktivitete ndryshon shpesh, duke i bërë më të vështirë për tu ndaluar.

Hapësira kibernetike sot është një nga sfidat me të mëdha ligjore e cila ka nxitur një formë tjetër të krimit, duke krijuar një mjedis për metodat e reja të krimit, tani pothuajse të gjitha krimet mund të kryhen me përdorimin e kompjuterëve. Krimi kibernetikë është një fenomen që prek një sërë kompetencash, si ato në fushën e informatikës, energjetikës, kriminologjisë, ekonomisë, mjekësisë, drejtësisë si dhe shumë fusha tjera. Duke qenë një teknologji “e liberalizuar” prej disa kohësh, s’ka diskutim se përfitimet që sjell përdorimi i kësaj teknologjie janë të mëdha.

Sipas strategjisë të sigurisë kibernetike të Bashkimit Evropian kriminaliteti kibernetikë i referohet përgjithësisht një spektri të gjerë veprimtarish kriminale të ndryshme, ku kompjuterët dhe sistemet informative angazhohen ose si vegël primare ose si shënjestër primare. Krimi kibernetikë përfshin veprat penale tradicionale (p.sh. mashtrimi, falsifikimi dhe thyerja e identitetit), veprat në lidhje me përmbajtjen (p.sh. shpërndarja në internet e pornografisë së fëmijëve apo nxitja e urrejtjes racore), si dhe veprat që janë unike për kompjuter dhe sisteme informative (p.sh. sulmet ndaj sistemeve informative, mohimi i shërbimit dhe mallrave). Bazuar në zhvillimin e madh që ka teknologjia informative, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jenë të përgatitur për të gjykuar krimin kibernetikë dhe shqyrtuar provat elektronike. Megjithatë në shumë vende, autoritetet e zbatimit të ligjit i kanë forcuar kapacitetet e tyre për hetimin e krimit kibernetikë dhe sigurimin e provave elektronike, kjo gjë nuk ndodh me gjyqtarët dhe prokurorët. Përvoja të sugjeron se në shumicën e rasteve, gjyqtarët dhe prokurorët hasin vështirësi në përballjen me realitetet e reja të botës kibernetike. Për këtë arsye, kërkohen përpjekje të posaçme për të aftësuar gjyqtarët dhe prokurorët që të mund të ndjekin ligjërisht dhe gjykojnë krimin kibernetikë dhe të shfrytëzojnë provat elektronike nëpërmjet trajnimit, lidhjes në rrjet dhe specializimit. Kriptovalutat janë bërë një temë shumë e spikatur dhe e diskutueshme edhe në mesin e profesionistëve të sektorit privat dhe publik që janë të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave. Kriptovaluta më e mirënjohur, Bitcoin ka ngjallur shumë interesim posaçërisht për faktin se mediat vazhdojnë të merren me një numër të hetimeve dhe të ndjekjeve me profil të lartë në tërë botën.

Ky trajnim ka për qëllim që t’i adresohet audiencës së agjencive për zbatimin e ligjit, prokurorëve dhe përfaqësuesve të Njesisë së Inteligjencës Financiare (NjIF) që janë të angazhuar në hetime financiare, ndjekje penale që përfshijnë krim ekonomik dhe rikuperimin e pasurive të paligjshme. Trajnimi do të eksplorojë dhe do të thellojë eksperiencën dhe ekspertizën e praktikuesve nga, zyrat

e prokurorisë dhe NJIF në përcjelljen e rrjedhave të paligjshme financiare të kanalizuara përmes kriptovalutave.

Objektivat

- Identifikojnë fushën e krimit kibernetikë – tendencat dhe instrumentet;
- Avancojnë njohuritë rreth teknologjisë e përfshirë në krimin kibernetik;
- Zgjerojnë njohuritë për Krimin Kibernetikë si vepër penale në legjislacionin e brendshëm;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin, procedurat dhe praktika në lidhje me provat elektronike;
- Ligji procedural/masat hetimore në legjislacionin e brendshëm;
- Njohin Legjislacionin ndërkombëtar dhe Bashkëpunimin ndërkombëtar.

Përmbajtja

- ✓ Njohurit lidhur me krimin kibernetikë
- ✓ Mbrojtja e informatave të klasifikuara për mbrojtjen e sigurisë shtetërore
- ✓ Veprat penale lidhur me krimin kibernetikë
- ✓ Provat elektronike në procedurë penale
- ✓ Sigurimi dhe ruajtja e provave elektronike
- ✓ Bashkëpunimi ndërkombëtar
- ✓ Njohja mbi kriptovalutat

Metodologjia

Ligjërata interaktive e kombinuar me raste studimore si dhe punë në grupe.

Përfituesit

Gjyqtarët, Prokurorët, Hetuesit, Zyrtar të NJIF-it, Ekspertët e PSRK, Bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023
- Propozimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Programin Trajnues 2024
- Punëtorja për VNT (korrik 2023)

9. Dëshmitarët e mbrojtur, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, njeh si kategori të posaçme dëshmitarët dhe të dëmtuarit, që për shkak të rrezikut serioz që u kanoset atyre apo anëtarëve të familjes së tyre, mund të kenë nevojë për mbrojtje. Në praktikë ka shumë raste që të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën dhe pasurinë e tyre dhe anëtarëve të familjes së tyre. Andaj, në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur dhe i veçantë, në mënyrë që të njëjtit mos të kenë frikë për të dëshmuar dhe bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit, në njërën anë dhe në anën tjetër aq sa është e mundur të sigurohet shëndeti, jeta dhe pasuria e tyre. Meqenëse në praktikën gjyqësore ende ka dilema se si duhet trajtuar rastet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve të mbrojtur, gjatë këtij trajnimi do të shtrohen pyetje si në vijim: Çka kuptojmë me rrezik serioz? Çka është anonimiteti? Cili është dallimi në mes të dëshmitarëve të mbrojtur nga publiku dhe dëshmitarëve anonim? Cili është dallimi në mes të dispozitave të KPPK, për masat e nevojshme për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, në raport me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve? Cilat procedura duhet ndjekur për të mbrojtur të dëmtuarin dhe dëshmitarin etj.

Dhënia e përgjigjeve të sakta dhe të qarta për pyetjet e tilla do të dërgojë deri të zbatimi më i mirë dhe më i drejtë i dispozitave ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve. Pjesëmarrësve do tu mundësohet qasja në raste praktike të përgatitura enkas për këtë trajnim, ku mund të shihen sukseset dhe dështimet në rastin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të dëmtuarve.

Shumicën e rasteve shqyrtimi kryesor është rezultati i pritshëm i çfarëdo hetimi apo aktakuze. Mirëpo, ekzistojnë alternativa që gjykata i mbështet siç është marrëveshja për pranimin e fajësisë. Arsyeja e parë përse prokurori i shtetit kërkon alternativa është avancimi i hetimeve, pasi që marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të rezultojnë në atë që i pandehuri të behet dëshmitar bashkëpunues. Në këtë mënyrë, i pandehuri mund të sigurojë prova shtese kundër personave tjerë të cilët kanë kryer vepra penale dhe në këtë mënyrë të avancojnë hetimet. Ky është mjet i rëndësishëm për hetimet e ndërlikuar, veçanërisht për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Si merret iniciativa për negociimin e marrëveshjes? Cilat janë kushtet ligjore për arritjen e marrëveshjes? Në cilat faza mund të arrihet marrëveshja për pranimin e fajësisë? Cilat janë benificionet e shtetit dhe cilat ato të pandehurit? Cilat dënime mund të rekomandohen në marrëveshje? Cili është roli i gjykatës në arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë? Ky program është hartuar për të shpjeguar rreth mundësisë së arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, hapat që duhet të ndërmerren nga palët në procedure lidhur me fillimin e negociatave për arritjen e marrëveshjes, përshkrimi i veprimeve të të gjitha palëve në kuadër të negociatave për arritjen e marrëveshjes, përmbushja e kushteve ligjore që marrëveshja të pranohet nga gjykata, si dhe rolin e secilit organ shtetëror në arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Objektivat

- Kuptojnë rolin dhe statusin e dëshmitarëve të mbrojtur;
- Dallojnë kushtet ligjore për caktimin e masave mbrojtëse dhe anonimitetit;

- Analizojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë;
- Vlerësojnë kushtet ligjore dhe fazat e procedurës kur mund të arrihet marrëveshja;
- Vendosin lidhur me dënimet që mund të rekomandohen në marrëveshje;
- Vlerësojnë programin për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Kuptojnë rolin dhe statusin e dëshmitarit bashkëpunues në procedurë penale.

Përmbajtja

- ✓ Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve në procedurë penale;
- ✓ Kërkesat për masat mbrojtëse apo anonimitetit;
- ✓ Urdhrat për masa mbrojtëse dhe anonimitet;
- ✓ Kushtet e negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë;
- ✓ Të drejtat e viktimës dhe të dëmtuarit në rastet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë;
- ✓ Shqyrtimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.
- ✓ Kushtet e marrëveshjes me dëshmitarët bashkëpunues;
- ✓ Statusi dhe roli i dëshmitarit bashkëpunues në procedurë penale;
- ✓ Deklarimi i dëshmitarit bashkëpunues në procedurë penale;
- ✓ Zvogëlimi i dënimit të dëshmitarëve bashkëpunues pas aktgjykimit

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet përmes diskutimit interaktiv, rasteve nga praktika dhe puna në grupe.

Përfituesit

Gjyqtarë, Prokurorë dhe Bashkëpunëtore Profesionale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023

10. Gjykimi në mungesë

Prej ndryshimeve më të rëndësishme të Kodit të Procedurës Penale është inkorporimi i dispozitës lidhur me gjykimin në mungesë. Diçka e tillë është bërë sepse i pandehuri i cili vullnetarisht dështon të paraqitet në seancë gjyqësore pasi të jetë informuar për datën nuk duhet të lejohet të vonojë procedurën. Në ato raste kur i pandehuri nuk mund të gjendet pas përpjekjeve të arsyeshme, gjykimi duhet të jetë në gjendje të mbahet sipas rrethanave të parapara në nenin e propozuar. Ky propozim është marrë duke u bazuar në burimet e mëposhtme: DIREKTIVA (BE) 2016/343 E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN e 9 marsit 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në procesin gjyqësor; Nenet 8, 9 dhe 10.

Instituti i gjykimit në mungesë është inkorporuar për shkak se ka shumë raste kur ka pasur vështirësi për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë, me ç ‘rast të pandehurit i janë shmangur drejtësisë e sidomos për krimet më të rënda siç janë krimet e luftës. Përveç kësaj, mungesa e të pandehurit në gjykim ka shkaktuar edhe shpenzime të mëdha si dhe ka rezultuar pa një vendim final nga ana e gjykatës. Ky institut parashihet në disa prej vendeve të regjionit. Gjykimi në mungesë është evituar në Kosovë si arsytim i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sepse është konsideruar që gjykimi në mungesë është shkelje e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, bazuar në standardet dhe Direktivat e BE-së instituti i Gjykimit në Mungesë nuk është shkelje e të drejtave të njeriut nëse plotësohen disa kushte dhe kriteret.

Gjykimi në mungesë do të aplikohet dhe zbatohet për të gjitha veprat penale. Kriteret të cilat duhet plotësuar në mënyrë që të mbahet gjykimi në mungesë janë prezenca e të pandehurit në shqyrtim të paktën njëherë (ose në shqyrtim fillestar ose në shqyrtim gjyqësor) dhe njoftimi për detyrimin për të qenë i pranishëm në gjykim si dhe informimi se në të kundërtën gjykimi mund të vazhdojë të mbahet nëse i akuzuari mungon vullnetarisht. Megjithatë, kriteri i prezencës së të pandehurit e ka një përjashtim, kur bëhet fjalë për veprat penale të cilat nuk parashkruhen. Dispozita e paragrafit 7 është e ndërtuar ashtu që për veprat më të rënda penale të cilat nuk parashkruhen, nuk është e domosdoshme prezenca e të pandehurit në shqyrtim fillestar apo në ndonjërin prej shqyrtimeve gjyqësore në mënyrë që të mbahet gjykimi në mungesë. Kriteri i cili duhet të plotësohet për tu mbajtur gjykimi në mungesë lidhur me këto vepra është që gjykata të ketë dëshmi të mjaftueshme se është bërë përpjekje e arsyeshme për ta siguruar prezencën e të akzuarit dhe njoftimi për pasojat e mosardhjes në shqyrtim. Gjithashtu, është shtuar edhe paragrafi 8 i cili ia jep mundësinë të pandehurit që të kërkojë rigjykim automatik nëse është gjykuar sipas paragrafit 7. Ky paragraf nuk është në kundërshtim me Direktivën e BE-së “DIREKTIVA (BE) 2016/343 E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN e 9 marsit 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në procesin gjyqësor”; Nenet 8, 9 dhe 10, sepse sipas kësaj Direktive nuk kërkohet që i pandehuri të jetë paraqitur së paku një herë në gjykatë, por duhet të jenë bërë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të pandehurin në kohë për datën e mbajtjes së gjykimit dhe njoftimin që në rast të mosparaqitjes së tij, do të mbahet gjykimi në mungesë si dhe disa kriteret të tjera.

Në rast se i akuzuari mungon në shqyrtim gjyqësor, gjykata duhet të përcaktojë nëse i akuzuari mungon vullnetarisht. Për ta bërë këtë vlerësim, ajo mban seancë dhe vlerëson çdo dëshmi apo sqarim nëse i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë në gjykim. Gjykata gjithashtu

konsideron nëse janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta gjetur të akuzuarin, vlerëson vështirësinë e shtyrjes së gjykimit, veçanërisht në gjykimet që përfshijnë shumë të akuzuar dhe çështje të tjera. Në të gjitha rastet e gjykimit në mungesë, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi për shkak se me ndryshimet e reja, mbrojtja është e detyruar në rastet e gjykimit në mungesë. Nëse mbahet gjykimi në mungesë, gjykata bën përpjekje të arsyeshme për ta informuar të pandehurin lidhur me aktgjykimin. Nëse ajo nuk arrin ta njoftojë të pandehurin, atëherë të drejtën në ankesë e ka mbrojtësi. Për dallim nga rastet sipas kriterit të parë, në rastet e gjykimit në mungesë për veprat penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal, sipas paragrafit 7, të nenit 303 të KPP-së, personi i gjykuar ka të drejtë në rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë sipas kërkesës.

Objektivat

- Identifikimi i rasteve kur lejohet zbatimi i dispozitave për gjykimin në mungesë;
- Vlerësimi i prezencës së të akuzuarit në shqyrtim fillestar dhe kryesor;
- Kuptojnë parakushtet ligjore të aplikimit të gjykimit në mungesë;
- Identifikimi i rasteve të mundshme të zbatimit të gjykimit në mungesë.

Përmbajtja

- ✓ Kushtet ligjore për mbajtjen e gjykimit në mungesë;
- ✓ Prezenca e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor;
- ✓ Seanca dëgjimore për të përcaktuar mungesën e të akuzuarit dhe mbajtjen e gjykimit në mungesë;
- ✓ Përpjekjet e arsyeshme për të gjetur të akuzuarin;
- ✓ Njoftimi i të pandehurit lidhur me aktgjykimin;
- ✓ Rigjykimi në rastet e gjykimit në mungesë.

Metodologjia

Metodat që do të përdoren për realizimin e këtij trajnimi janë metoda të kombinuara trajnuese, diskutimet interaktive, studimi i rasteve praktike, puna në grupe, vendime të GJEDNJ, etj.

Përfituesit

Gjyqtarë, Prokurorë dhe Bashkëpunëtor profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023

11. Përpilimi i aktakuzës, arsyetimi dhe vlerësimi i provave

Aktakuza është akti më i rëndësishëm i prokurorit të shtetit, e cila është kompetencë ekskluzive vetëm e tij. Si e tillë është akt akuzues formal me të cilën kërkohet nga gjykata që caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër personit të caktuar për vepër penale të caktuar. Me Kodin e ri të procedurës penale janë shtuar edhe disa obligime të prokurorit të shtetit me rastin e ngritjes së aktakuzës, gjegjësisht obligimin e propozimit për rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Aktakuza duhet të përpilohet në mënyrë të qartë pasi një dokument i shkruar qartë, lehtëson leximin e tij dhe përcjellë një mesazh të fuqishëm nga prokurori sepse është çelësi me të cilën prokurori e hap “derën në gjykatë”. Prokurori duhet ta përpilojë aktakuzën në atë mënyrë që gjyqtari ta kuptojë atë, e kjo arrihet që ta transformoj historinë e rastit, përgatitjen dhe provat që janë; në një aktakuzë bindëse dhe lehtësisht të kuptueshme, duke bërë organizimin dhe analizimin e fakteve dhe lidhjen e tyre me provat. Për përshkrimin e fakteve në një aktakuzë përdoret gjuha e ligjit. Faktet dhe ligji duhet të ndërthuren së bashku në mënyrë tejet bindëse. Çështja duhet të ndërtohet sipas elementeve të krimit dhe në fund hetimet e suksesshme përfshijnë si prokurorin ashtu edhe hetuesit. Në këtë trajnim do të trajtohen llojet e aktakuzave, forma e saj, elementet esenciale të aktakuzës me theks të veçantë elaborimi i provave dhe lidhja e tyre me veprën penale.

Objektivat

- Identifikojnë sfidat në praktikën gjyqësore;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me përshkrimin e veprave penale dhe përmbledhjen e fakteve në përpilimin e dispozitivit të aktakuzës;
- Unifikojnë praktikën gjyqësore lidhur me hartimin e aktakuzës;
- Dallojnë identitetin objektiv dhe subjektiv në aktakuzë dhe në aktgjykime.

Përmbajtja

- ✓ Përmbajtja e aktakuzës (elementet esenciale - të dhënat personale të pandehurit, dispozitivi, rekomandimet në aktakuzë, elaborimi i rrethanave për dënimin)
- ✓ Arsyetimi i aktakuzës;
- ✓ Vlerësimi dhe elaborimi i provave në aktakuzë;
- ✓ Njoftimi për publikim të aktakuzës;
- ✓ Materialet që i jepen të pandehurit me rastin e ngritjes së aktakuzës.

Metodologjia

Trajtimi i Rasteve praktike dhe punë grupore.

Përfituesit

Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët ligjor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Propozimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Programin Trajnues 2024
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje

12. Procedura penale e kryesve me çrregullime mendore

Çrregullimet mendore, përkatësisht sëmundjet psikike janë shkaqe të cilat u janë një status të posaçëm personave që kryejnë veprë penale nën ndikimin e sëmundjeve psikike. Personat me çrregullime mendore, janë kategori e veçantë e kryerësve të veprave penale, kështu që edhe me Kodin e procedurës penale është parashikuar procedurë specifike tek rastet kur përfshihen këta persona si kryerës të veprave penale. Trajtimi i këtyre rasteve kërkon një kujdes të veçantë, për shkak të gjendjes mendore në të cilën gjenden në momentin e zhvillimit të procedurës ndaj tyre. Gjendja e posaçme mendore në të cilën gjenden kjo kategori e kryesve të veprave penale e arsyeton përcaktimin e masave të posaçme ligjore përkatësisht me “Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik” si reagim ndaj tyre për veprat penale që ata kryejnë. Gjithashtu, kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre janë të kushtëzuara nga gjendja mendore e kryerësit të veprës penale.

Përcaktimi vendimtar i llojeve të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe kushteve ligjore për shqiptimin e masave të tilla, ka rëndësi të dyanshme si: mbrojtjen e shoqërisë nga sjelljet kriminale të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmërinë esenciale të zvogëluar dhe me mbrojtjen e dinjitetit të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar, kryerëse të veprave penale. Duke analizuar kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe qëllimin që duhet të arrihet me anë të ekzekutimit të tyre shohim që papërgjegjshmëria e kryerësit të veprës penale dhe rreziku për përsëritjen e sjelljeve kriminale janë faktorë kyç për shqiptimin e masave të tilla. Ky trajnim do të fokusohet në analizimin e procedurës e cila zhvillohet ndaj kryerësve me çrregullime mendore, ekspertizën, caktimin e masës së paraburgimit të këtyre personave, përcaktimi ligjor për llojet e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, për kushtet dhe procedurën gjyqësore të shqiptimit, për mënyrën e ekzekutimit të tyre në mënyrë të qartë ku ato i përcaktojnë subjektet e të cilëve u dedikohen dhe qëllimin që synohet të arrihet përmes tyre.

Objektivat

- Njohin veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore;
- Vlerësojnë kushtet dhe kriteret ligjore lidhur me caktimin e paraburgimit për kryesit me çrregullime mendore;
- Analizojnë llojet e trajtimit të detyrueshëm me ndalim në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Përmbajtja

- ✓ Veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore
- ✓ Paraburgimi për personat me çrregullime mendore
- ✓ Ekzaminimi psikiatrik
- ✓ Përcaktimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik
- ✓ Sfidat në zbatimin e procedurave me kryes me çrregullime mendore

Metodologjia

Aplikimi i rasteve praktike dhe diskutime grupe.

Përfituesit

Gjyqtaret, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Mbrojtësit e viktimave.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023

13. Strategjia e hetimit, masat e veçanta hetimore

Qëllimi i këtij moduli është që pjesëmarrësve në rend të parë, t’iu ofrohen njohuri teorike dhe praktike me rastin e aplikimit të dispozitave përkatëse për marrjen e informatave në fazën e hetimeve përkatësisht zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Pra, objektivi i trajtimit në këto ligjërata janë dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë çështjen e hetimit, pezullimit, pushimit dhe rifillimit të hetimit, si dhe institutin e masave të veçanta hetimore gjatë procedurës penale në fazën e hetimeve. Hetimi penal është një nga fazat kryesore të procedurës penale. Gjatë hetimit penal, prokurori është në gjendje të sigurojë që mbledhja e provave kryhet në përputhje me ligjin dhe se ato ruhen dhe analizohen ashtu si duhet, në mënyrë që të mund të përdoren në gjyq. Për ta përmbledhur, roli i prokurorit në hetim është mjaftë i rëndësishëm dhe përfshin elementët e mëposhtëm: të sigurojë që puna hetimore përqendrohet tek elementet e krimit; të sigurojë që puna gjatë hetimit është e strukturuar dhe e koordinuar; të sigurojë që provat mblidhen në përputhje me ligjin; të sigurojë që provat ruhen në mënyrën e duhur; të sigurojë që provat analizohen në mënyrën e duhur; dhe të sigurojë që provat janë të përdorshme në gjykim. Një nga fushat apo temat më të rëndësishme, gjithsesi janë masat e veçanta hetimore dhe zbatimi i tyre, të cilat ndodh që të janë marrë nga rastet e cenimit ose ndërhyrjes serioze dhe kufizimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut ndaj të akuzuarit dhe personave të tjerë. Për këtë arsye, duhet të pamundësohet arbitrariteti në zbatimin e këtyre masave nga ana e organeve të autorizuar për shkak të rrezikut të shkeljes ose kufizimit të të drejtave me të cilat ruhet integriteti dhe fshehtësia e komunikimeve personale të personit që është i përfshirë në këto masa.

Qëllimi i zbatimit të këtyre masave ka qenë dhe është parandalimi i kryerjes së veprave penale, zbulimi më efikas i veprave penale, si dhe ndjekja e kryesve të veprave penale për rastet kur nuk mund që të zbulohen me veprime tjera hetimore. Sipas Kodit të Procedurës Penale janë paraparë 12 masa të veçanta hetimore, ashtu që disa prej tyre të cilat janë më pak ndërhyrëse në të drejtat e qytetarit autorizohen nga prokurori i shtetit, ndërsa disa të tjera nga gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit.

Këto masa pa dyshim që prekin në privatësinë e jetës së njeriut dhe në liri të drejtat e tij, dhe për ata është edhe i kushtëzuar me ligj lejimi i lëshimit të këtyre masave, mirëpo për hir të parandalimit të kryesve të veprave penale këto masa do të aplikohen kur me masat tjera nuk mund të arrihet një informacion apo zbulimi i kryesit të veprës penale dhe do të tentohet që sa më pak të preket në të drejtat e njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 36, “E Drejta e Privatësisë”, parasheh “Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.” Siç e dimë, mbrojtja (pozitive) e jetës private dhe familjare në kuadrin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashihet në dy nene, nenit 8 dhe 12 të cilët përcaktojnë se “çdo individ ka të drejtë për respektimin e jetës private dhe familjare, të vendbanimit dhe të korrespondencës” (paragrafi i parë).

Objektivat

- Identifikojnë rastet se kur lejohet përdorimi i masave të fshehta dhe për cilat vepra penale lejohen masat,
- Kuptojnë natyrën dhe kufijtë e përdorimit të një mjeti të caktuar të fshehtë, proporcionalitetit dhe domosdoshmëria,

- Identifikojnë kushtet dhe kriteret e përdorimit, subjektet kundër të cilëve mund të përdoren, kohëzgjatjen e tyre, mënyrën, etj.,
- Vlerësojnë trajtimin dhe shkatërrimin e materialit dhe të dhënave personale të marra, si rezultat i përdorimit të këtyre masave të fshehta,
- Identifikojnë përgjegjësinë e zyrtarëve policor në përdorimin e tyre dhe llogaridhënien lidhur me autorizimin dhe përdorimin e masave,
- Vlerësojnë pranueshmërinë e provave dhe të informacionit të mbledhur si rezultat i përdorimit të tyre.

Përmbajtja

- ✓ Zhvillimi i planit hetimor;
- ✓ Sigurimi i provave gjatë fazës së hetimit;
- ✓ Fillimi, pezullimi, pushimi dhe rifillimi i hetimeve;
- ✓ Qëllimi dhe llojet e masave të veçanta hetimore;
- ✓ Kushtet ligjore dhe urdhrat për masat e veçanta hetimore;
- ✓ Zbatimi dhe kohëzgjatja e masave të veçanta hetimore
- ✓ Pranueshmëria e provave të siguruar nga masat e veçanta hetimore.

Metodologjia

Metodat që do të përdoren për realizimin e këtij trajnimi janë metoda të kombinuara trajnuese, prezantime në PowerPoint, diskutimet interaktive, studimi i rasteve praktike, puna në grupe, simulimet e ndryshme, vendime të GJEDNJ, etj.

Përfituesit

Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtor profesional dhe Hetues policor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT

14. Trajtimi i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë gjatë qasjes në drejtësi

Sipas studimit të publikuar "Drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës" (QKRMT, 2023), konfirmohet se Sistemi i Drejtësisë në Kosovës (policia, prokuroria, gjyqësori dhe avokatët) kanë nevojë për mbështetje në fuqizimin e njohurive mbi qasjen e ndjeshme ndaj viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës si palë e procedurës penale. Sipas gjetjeve ekziston nevoja për të institucionalizuar trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajtim të ndjeshëm të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Po ashtu, këtë vit janë ngritur 5 aktakuza për dhunën seksuale gjatë luftës, ku pritet të gjykohen nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Dhuna seksuale gjatë luftës, si krim lufte, është i natyrës së veçantë, andaj, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Mbijetuarve të Torturës e konsideron të nevojshme që gjyqtarët dhe prokurorët të trajnohen për qasje sensitive ndaj viktimave të dhunës seksuale të luftës, me fokus në mbrojtjen e identitetit të tyre dhe parandalimin e ri-viktimizimit dhe stigmatizimit gjatë procesit gjyqësor, si dhe mbështetjen psikologjike para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor. Qëllimi i kësaj punëtorie është diskutimi i përbashkët mbi sfidat, nevojat dhe qasjen e ndjeshme në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Objektivat

- Fuqizimi i njohurive mbi trajtimin sensitive të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës;
- Përmirësimi dhe përfshirja e qasjes sensitive dhe aspektit psikosocial për të mbijetuarit në sistem të drejtësisë;
- Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave dhe bashkëpunimi institucional;
- Adresimi i vështirësive dhe nevojave të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Përmbajtja

- ✓ Specifikat e trajtimit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës;
- ✓ Të dhënat dhe faktet për krimin e dhunës seksuale gjatë luftës (Data baza e QKRMT);
- ✓ Qasjen e informuar për traumën dhe trajtimin e të mbijetuarve në sistemin e drejtësisë dhe aspektet psiko sociale: çfarë është trauma dhe si ndikon te viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në afat të shkurtër dhe afatgjatë; si ti qasemi viktimës për të minimizuar rrezikun e ritraumatizimit dhe stigmatizimit; rëndësia e integritetit të aspektit gjinor gjatë punës me viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës; rëndësia e mundësimin të hapësirës së sigurt, ruajtjes së konfidencialitetit dhe privatësisë së viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës.
- ✓ Praktika e gjertanishme, qasja e aplikuar dhe nevojat e identifikuar.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit përmban një kombinim metodash që synojnë diskutime të hapura dhe interaktive, diskutim i rasteve studimore, Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe Prokurorët.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Instituti i Bazelit për Qeverisje – Qendra Ndërkombëtare për Rikuperim të Aseteve, partner implementues Zyra e UNDP në Kosovë

15. Hetimet Financiare dhe Rikuperimin e Aseteve

Qëllimi kryesor i këtij programi trajnimi është intensifikimi dhe ngritja e kapaciteteve hetimore në Kosovë për të hetuar dhe ndjekur me sukses rastet e korrupsionit dhe pastrimit të parave, si dhe rikuperimin e pasurisë. Duke u fokusuar në marrjen e njohurive të plota të elementeve të korrupsionit dhe veprave penale të pastrimit të parave në legjislacionin e Kosovës, dhe duke përmirësuar të kuptuarit e proceseve dhe procedurave ligjore dhe praktike për rikuperimin e asetëve jashtë vendit, hetuesit dhe prokurorët do të zhvillojnë aftësitë e nevojshme.

Objektivat

- Përmirësimi i kapaciteteve të hetuesve dhe prokurorëve kundër korrupsionit, gjyqësorit, në analizimin, hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve ndërkombëtare të pastrimit të parave dhe/ose ryshfetit;
- Rritja e aftësisë së stafit të tyre për të trajtuar kërkesat ndërkombëtare dhe për të pasur sukses në bashkëpunimin me juridiksionet e huaja në luftën kundër pastrimit të parave dhe riatdhesimit të pasurive të vjedhura.

Përmbajtja

- ✓ Fazat fillestare të hetimit dhe të hetimit gjyqësor, gjatë të cilave mblidhen dhe verifikohen informacionet dhe provat dhe identifikohen dhe lokalizohen asetet, duke përdorur një sërë teknikash hetimore;
- ✓ Rëndësinë e përputhjes së provave me elementët specifikë të veprës penale në fjalë, dhe përdorimin e teknikave përkatëse për burimin e provave të nevojshme për të dënuar dhe, në fund, për të konfiskuar të ardhurat e korrupsionit dhe pastrimit të parave.
- ✓ Njohja e plotë e elementeve të veprës penale, ndihma juridike ndërkombëtare (njn) efektive me juridiksionet e huaja, në rastet e korrupsionit, pastrimit të parave dhe rasteve të tjera të krimit të rëndë ekonomik, ku i pandehuri shpesh fsheh jashtë vendit pasurinë e fituar nga krimi.

Metodologjia

Diskutim interaktive e kombinuar me raste studimore si dhe punë në grupe.

Përfituesi

Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit në departamentin special, departamentin e krimeve të rënda dhe departamentin e përgjithshëm.

Kohëzgjatja

2 trajnime

Trajnimi i parë, shkurt 2024 (5 ditë).

Trajnimi i dytë, prill 2024 (5 ditë).

TRAJNIMET NGA LËMIA CIVILE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

1. Anulimi i Kontratave

Në praktiken gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet për anulimin e kontratave me fokus anulimi i kontratës mbi dhuratën, për mbajtjen e përhjetshme dhe për të drejtën e parablerjes, është konstatuar praktikë jo unike lidhur me vlerësimin e shkaqeve relative dhe absolute për anulimin e këtyre kontratave. Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilemat dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe për veç tjerash edhe për ligjin e aplikueshëm, shkaqet për anulimin e kontratave që referohen nulitetit relativ apo absolut standardit të provuarit – mjetet provuese, mënyra e vendosjes dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore. Në procedurën sipas mjeteve të rregulltave dhe të jashtëzakonshme juridike është konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë e në disa raste edhe aktgjykimi i shkallës së dytë janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale për të cilat shkaqe aktgjykimet e instancave më të ulëta është dashur të prishen. Nevoja për mbajtjen e një tryeze të tillë diktohet nga numri i konsideruar i rasteve që kthehen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikimi i gabuar i drejtës materiale, si dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështjet e theksuara më lartë. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohen sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit panelistët duhet të marrin në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrojnë disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema. Në fund të tryezës panelistët do të hartojnë një raport përmbledhës i cili do të shërbej për unifikimin e praktikës gjyqësore rritjen e efikasitetit, ngritjen e cilësisë në vendimmarrje dhe sigurinë juridike.

Objektivat

- Unifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave me të ulëta;
- Rritja e efikasitetit dhe cilësia në vendimmarrje;
- Siguria Juridike.

Përmbajtja

- ✓ Anulimi i kontratës të dhuratës, parablerjes dhe mbajtjes së përhjetshme;
- ✓ Baza ligjore;
- ✓ Shkaqet për anulimin e këtyre kontratave.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Gjatë kësaj tryezë do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese 27 korrik 2023

2. Fitimi i pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit

Tryeza për çështje pronësore lidhur me fitimin e pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale në fushën e të drejtës pronësore. Në këtë tryezë do të trajtohen çështjet më thelbësore në kuadër të fitimit të pronësisë nga këto dy baza. Gjykata Supreme e Kosovës në kuadër të juridiksionit të saj si gjykata e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimmarrjes në nivelet tjera gjyqësore, synon që përmes kësaj tryeze të organizuara nga Akademia e Drejtësisë të mbështes drejtpërdrejtë rritjen e performancës gjyqësore përmes rritej se efikasitetit, cilësisë, zbatimit unik të dispozitave ligjore në mënyrë që puna e gjykatave të jetë objektive, ligjore dhe e besueshme. Temat e përfshira në këtë për këtë tryezë janë një përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe të cilat përballët praktika gjyqësore. Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e këtij nën moduli është një burim i pazëvendësueshëm jo vetë për të qartësuar idetë mbi institutet qendrore por edhe për të kuptuar mënyrat e veprimit dhe në tërësi praktikën gjyqësore ekzistuese për paqartësitë, dilemat apo edhe mangësi ligjore. Punimet tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së fitimit të pronësisë nga baza e parashkrimit fitues dhe baza e ndërtimit. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që të kanë të bëjnë më fushën përkatëse.

Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit panelistët duhet të marrin në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrij disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema.

Objektivat

- Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat; tjera sendore nga këto forma të fitimit të pronësisë;
- Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja

- ✓ Kushtet për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues;
- ✓ Kushtet për fitimin e pronësisë nga baza e ndërtimit;
- ✓ Mbrojtja gjyqësore;
- ✓ Te provuarit;
- ✓ Unifikimi i praktikës gjyqësore.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit, Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

3. Kompensimi i Dëmit – Fitimi i humbur (renta)

Në praktiken gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e shpërblimit të dëmit material lidhur me fitimin e humbur, rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen është konstatuar praktike jo unike lidhur me vlerësimin se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën për të kërkuar fitimin e humbur, gjegjësisht rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen. Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilemat dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe për veç tjerash edhe për faktin edhe Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të kërkesave për fitimin e humbur gjatë procedurës nuk ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike, e sidomos në raport me bazën dhe lartësinë e kërkesë padisë. Në procedurën sipas mjeteve të rregulltave dhe të jashtëzakonshme juridike është konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë e në disa raste edhe aktgjykimi i shkallës së dytë janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale për të cilat shkaqe aktgjykimet e instancave më të ulëta është dashur të prishen.

Nevoja për mbajtjen e një tryeze të tille diktohet nga numri i konsiderueshëm i rasteve që kthehen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbej si baze e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës kontestimore.

Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit penalistët duhet të marrë në konsiderate aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtroj disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema.

Në fund të punimeve në tryezë penalistët do të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur, e i cili do të shërbej për unifikim e praktikës gjyqësore rritjen e efikasitetit, ngritjen e cilësisë në vendimmarrje dhe sigurinë juridike.

Objektivat

- Unifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Rritja e efikasitetit dhe cilësia në vendimmarrje;
- Siguria Juridike.

Përmbajtja

- ✓ Baza ligjore për të drejtën e kompensimit të dëmit material – rentës;
- ✓ Standardi i të provuarit – mjetet provuese;
- ✓ Lartësia e kompensimit;
- ✓ Ndryshimi i vendimeve gjyqësore.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Gjatë kësaj tryezë do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Dy tryeza, nga 2 ditë, përfshire regjionet si:

- Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan dhe
- Pejë, Gjakovë, Prizren.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

4. Procedura Jokontestimore

Tryeza për çështje nga procedura jokontestimore ka për objekt trajtimin dhe adresimin e sidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave të procedurës jo kontestimore. Tryeza do të mundëson shqyrtimin dhe sfidat me raste praktike nga një praktikë e mirëfilltë dhe unike gjyqësore me qëllim të ngritjes së profesionalizmit dhe unifikimit të praktikës gjyqësore në çështjet juridike nga procedura jo kontestimore. Trajtimi i rasteve do të bëhet sipas përzgjedhjes nga paneli të cilat raste duhet të përfshin të gjitha sfidat dhe praktikatat jo unike në fushën përkatëse respektivisht në zbatimin e dispozitave të procedurës jo kontestimore. Tryeza ka për qëllim trajtimin e rasteve sfiduese në këtë fushë dhe trajtimin e problematikave që hasin gjyqtarët në praktikë me qëllim të definimit dhe identifikimit të problematikës dhe sfidave në drejtim të zgjedhjes së drejtë dhe të ligjshme të çështjeve juridike sipas procedurës jo kontestimore.

Pas identifikimit të problematikave dhe sfidave të nxirren konkluzionet e qarta nga kjo tryezë me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore respektivisht se si të vepohet në të ardhmen në drejtim të kualitetit të vendimmarrjes.

Objektivat

- Identifikimi i sfidave dhe problematikave në rastet e veçanta për zbatimin e Ligjit të Procedurës Jokontestimore;
- Unifikimi i praktikave në gjykatat të instancave më të luta dhe adresimi i sfidave;
- Nxjerrja e konkluzioneve për një praktikë unike gjyqësore

Përmbajtja

- ✓ Rrjedha e procedurës jo kontestimore;
- ✓ Pjesëmarrësit në procedurë dhe shqyrtimi i propozimit;
- ✓ Rastet juridike të veçanta që shqyrtohen në procedurë jo kontestimore;
- ✓ Sfidat dhe problematika e secilit rast veç e veç;
- ✓ Anulimi i vendimit nga ana e gjykatës në shkallë të parë;
- ✓ Mjetet Juridike

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Kjo tryezë organizohet me qëllim të zhvillimit të diskutimit interaktiv mes pjesëmarrësve, diskutimi i sfidave dhe divergjencave në çështjet e rasteve të veçanta të procedurës jo kontestimore me qëllim të nxjerrjes së konkluzave për një praktikë unike gjyqësore.

Përfituesit

Përfituesit e kësaj tryeze do të jenë Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Themelores dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

5. Procedura Përmbartimore

Praktika gjyqësore në rastet e procedurës përmbartimore ka identifikuar divergjenca në raport me zbatimin e kësaj procedure e që ka imponuar organizimin e një tryeze të tillë me qëllim të vetëm unifikim e praktikës që do të arrinte sigurinë juridike në vendimmarrje. Përkundër organizimeve të trajnimeve nga kjo fushë rezulton me sfida praktike e të cilat përbëjnë shqetësim serioz për një vendimmarrje adekuate që në instancë të fundit garanton të drejtat e palëve në procedurë.

Përmes formatit të tryezës paneli do të ofrojë një qasje konstruktive nga aspekti praktik i problemeve të identifikuara kështu duke ofruar udhëzime të qarta të cilat do të jenë të harmonizuara në kuadër të instancave gjyqësore. Në praktikën gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në çështje përmbartimore është konstatuar praktike jo unike duke filluar nga shqyrtimi paraprak i propozimit për përmbartim, vlerësimi i dokumenteve përmbartimore ose titujve përmbartimore, procedimi i mëtutjeshëm sipas prapësimit lidhur me vendimmarrjen dhe sipas mjeteve të goditjes. Në praktikën gjyqësore janë identifikuar rastet sipas mjeteve të goditjes aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Nevoja për mbajtjen e një tryeze të tillë diktohet nga numri i madh i rasteve që kthehen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës përmbartimore. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit penalistët duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrij disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema.

Në fund të punimeve në tryezë panelistët do të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur, e i cili do të shërbejë për unifikim e praktikës gjyqësore rritjen e efikasitetit, ngritjen e cilësisë në vendimmarrje dhe sigurinë juridike.

Objektivat

- Unifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- Rritja e efikasitetit dhe cilësia në vendimmarrje;
- Siguria Juridike.

Përmbajtja

- ✓ Shqyrtimi i propozimit për përmbartim;
- ✓ Ekzaminimi i dokumenteve përmbartimore – titujve përmbartimore
- ✓ Vendosja sipas prapësimit;
- ✓ Vendosja sipas ankesë;

- ✓ Vendosja sipas kërkesës për mbrojtje te ligjshmërisë.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional/eventualisht përmbarduesit privat.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese 27 korrik 2023
- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

6. Procedura trashëgimore dhe kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë

Kjo tryezë ka për qëllim që pjesëmarrësve në tryezë t'iu ofrojë njohuritë profesionale dhe shkëmbimin e përvojave gjatë praktikës gjyqësore në rastet e udhëheqjes së procedurës trashëgimore, si dhe sanimi i divergjencave lidhur me procedurën trashëgimore gjatë trajtimit të çështjeve të kësaj natyre, me theks të veçantë të kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë. Po ashtu pjesëmarrësit në këtë tryezë do të shkëmbejnë sfidat dhe do të qartësojnë problematikat e ndryshme sa i përket kontesteve gjyqësore nga baza e trashëgimisë, duke unifikuar praktikën gjyqësore të rastet e kësaj natyre, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe profesionalizmit për zgjidhjen e lëndëve në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë. Gjatë tryezës do të diskutohet lidhur me sfidat dhe problematikat të kontestet që kanë të bëjnë lidhur me cenimin e pjesës së domosdoshme në rastet e anulimit të kontratës mbi dhuratën, si dhe veçoritë që përmban kontrata mbi mbajtjen e përjetshme në raport me cenimin e pjesës së domosdoshme. Kjo tryezë ka për qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore, sa i përket procedurës dhe mënyrës së vendosjes nga kjo fushë, me qëllim të cilësisë së vendimmarrjes.

Objektivat

- Identifikimi i sfidave nga praktika gjyqësore të kontestet gjyqësore nga baza e trashëgimisë;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- Ngritja e kapacitetit profesional.

Përmbajtja

- ✓ Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë;
- ✓ Kompetenca gjyqësore;
- ✓ Vendimmarrja;
- ✓ Bazat e trashëgimisë me ligj dhe testament;
- ✓ Trashëgimtarët dhe masa trashëgimore;
- ✓ Radhët trashëgimisë;
- ✓ Anulimi i punëve Juridike;
- ✓ Cenimi i pjesës së domosdoshme.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantimi i çështjes përmes rasteve, diskutimi i rasteve dhe do të dilet me një përmbledhje të konkluzave për çështjet e diskutuara.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, të Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja:

Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomandim nga trajnuesit
- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

7. Shqyrtimi paraprak i padisë në kontestet e punës, në kontestet e pengim posedimit dhe në kontestet e fyerjes dhe shpifjes – Afatshmëria/ lejueshmëria si prezumim procedural

Në praktiken gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatave të instancave me të ulëta në kontestet e punës, pengim posedimit kundër fyerjes dhe shpifjes, është konstatuar praktike jo unike lidhur me vlerësimin e afatshmërisë/ lejueshmërisë së padisë në kontestet e cituara më lartë, gjegjësisht nuk e ka vlerësuar lejueshmërinë/afatshmërinë e padisë edhe në rastet kur ka pasur kundërshtim nga pala e paditur, në përgjigje në padi, në seancën përgatitore, seancën kryesore dhe me mjetet e goditjes. Përveç kësaj në disa raste është vendosur në mënyrë meritore pa vlerësuar paraprakisht për afatshmërinë/lejueshmërinë e padisë. Nevoja për mbajtjen e një tryeze të tillë diktohet nga numri i konsideruar i rasteve që kthehen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore.

Tryeza do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje të tilla. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës kontestimore. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit penalistët duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtroj disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema.

Në fund të punimeve në tryezë panelistët do të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur, e i cili do të shërbej për unifikim e praktikës gjyqësore rritjen e efikasitetit, ngritjen e cilësisë në vendimmarrje dhe sigurinë juridike.

Objektivat

- Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- Rritja e efikasitetit dhe cilësia në vendimmarrje;
- Siguria Juridike.

Përmbajtja

- ✓ Shqyrtimi paraprak i padisë-shqyrtime të përgjithshme;
- ✓ Afatshmëria/lejueshmëria si prezumim procedural;
- ✓ Mënyra e vendosjes;
- ✓ Arsyetimi i vendimeve gjyqësore.

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Gjatë kësaj tryezë do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023
- Trajnuesi i Përhershëm në AD

8. Ndhimja dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile është një prej fushave më komplekse e karakterizuar me vështirësi në përcaktimin, eksplorimin dhe aplikimin e ligjit të huaj, përfshirë këtu edhe një numër të çështjeve procedurale, siç janë çështjet e shërbimeve të dokumenteve ndërkufitare, ndihma juridike ndërkombëtare, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore, etj. Secili gjyqtar është ballafaquar njëjtë si me çështje të brendshme ashtu edhe me ato ndërkufitare, dhe si rrjedhojë secili gjyqtar civilist ka nevojë për trajnim në trajtimin e rasteve me element ndërkombëtar. Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve interaktive dhe shqyrtimit të rasteve praktike. Gjithashtu përmes rasteve studimore do të trajtohet praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Objektivat

- Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet civile;
- Zbatojnë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë bashkëpunimin ndërkufitar në çështjet civile.

Përmbajtja

- ✓ Dërgimi i shkresave;
- ✓ Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të huaja;
- ✓ Kompetenca gjyqësore;
- ✓ Sigurimi i shpenzimeve të procedurës.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke përfshirë shpjegime teorike të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfituesit:

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Reforma Ligjore për Zhvillimin Ekonomik në Ballkanin Perëndimor - GIZ

9. Marrëdhëniet detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Ky trajnim është disejnuar për të dhënë njohuri të përgjithshme mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë në fokus në marrëdhëniet detyrimore. Si e tillë, ky trajnim do të adresojë e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe pjesën e specializuar të marrëdhënieve detyrimore dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile. Qëllimi i trajnimit është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse në pjesën e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe mbi risitë e ligjit në përgjithësi, institutet dhe shtyllat kryesore të së drejtës ndërkombëtare private dhe do të njoftohen mbi risitë kryesore në tri shtyllat kryesore të tij: në përcaktimin e së drejtës kompetente, në kompetencën e gjykatave dhe në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe me specifikat e marrëdhënieve detyrimore me element të huaj dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar nga kjo fushë.

Objektivat

- Përditësimi i njohurive: Trajnimi synon të ofrojë njohuri të përgjithshme dhe specializuar mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë, me theks të veçantë në marrëdhëniet detyrimore. Qëllimi kryesor është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve për risitë e ligjit dhe praktikën në këtë fushë.
- Praktikën ndërkombëtare: Trajnimi do të ofrojë shpjegime mbi praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të Unionit Evropian
- Rishikimi i vendimeve gjyqësore: Trajnimi synon të njohë gjyqtarët me procedurat dhe sfidat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve detyrimore.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar: Trajnimi synon të promovojë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, duke ofruar shembuj praktikë të bashkëpunimit në fushën e ndërkombëtare private.

Përmbajtja

Trajnimi do të adresojë çështjet si në vijim:

- ✓ Përcaktimi i së drejtës kompetente në marrëdhëniet kontraktore me element të huaj në përgjithësi dhe në marrëdhëniet kontraktore me konsumatorë;
- ✓ Përcaktimi i së drejtës kompetente në kontratat individuale të punësimit me element të huaj;
- ✓ Përcaktimi i së drejtës kompetente në marrëdhëniet jashtkontraktore e veçanërisht në shkaktimin e dëmit me element të huaj;
- ✓ Juridiksioni i gjykatave të Kosovës në marrëdhëniet e lartcekura;
- ✓ Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në këto marrëdhënie në Kosovë dhe anasjelltas.
- ✓ Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në këtë fushë: shpjegime praktike mbi bashkëpunimin e gjykatave në marrjen e provave dhe shërbimin e dokumenteve.
- ✓ Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në këtë fushë: shpjegime praktike mbi bashkëpunimin e gjykatave në marrjen e provave dhe shërbimin e dokumenteve.

Metodologjia

Në trajnim do të aplikohet metodologjia e kombinuar mes shpjegimeve teorike të ndryshimeve që sjellë ligji dhe pjesës praktike të përbërë nga ushtrimet. Shpjegimet mbi risitë e ligjit dhe institutet e kësaj fushe të së drejtës bëhen duke elaboruar rastet kryesore në praktikë të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Unionit Evropian. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përveç që është shumë e pasur, është tejet udhëzuese për gjyqtarët kosovarë meqë interpreton dispozitat e njëjta të cilat janë transpozuar në LDNP në Kosovë. Ndërkaq, në pjesën e ushtrimeve, gjyqtarëve u prezantohen probleme hipotetike të fushave të caktuara, të cilat ndërthurin dilema të përcaktimit të së drejtës kompetente, kompetencës së tyre si gjykata në Kosovë dhe/apo dilema mbi njohjen apo refuzimin e njohjes së një vendimi të huaj.

Përfituesit

Gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore, në divizionin civil; gjyqtarët e gjykatës së Apelit në divizionin civil.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

TRAJNIMET NGA LËMIA E DREJTËSISË PËR FËMIJË

Drejtësia për fëmijë - Aspekti Penal

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 27 korrik 2023
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

1. Veprat penale kundër integritetit seksual, ndjeshmëria e aspekteve psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve – viktimë të dhunës seksuale

Ndjeshmëria e veprave penale kundër integritetit seksual kërkon një trajtim më të detajuar për të hequr dilemat nga fakti se dispozitat ligjore lënë vend për interpretim dhe konfuzion. Po ashtu, në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër integritetit seksual ndër të tjera parasheh edhe disa vepra që prekin integritetin seksual të fëmijëve. Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përfshirë kujdesin gjatë marrjes së deklaratës së viktimës në veçanti viktimës fëmijë, aplikim i dispozitave ligjore të KDM-së lidhur me marrjen e deklaratës së viktimës jo më shumë se dy herë gjatë zhvillimit të procedurës penale, sqarimi-interpretimi i dispozitave ligjore të (mos) dhënias e pëlqimit të fëmijës lidhur me veprimet e të pandehurit në drejtim të fëmijës, prezenca e personave që duhet të jenë prezent gjatë marrjes së deklaratës, përmirësimi i bashkëveprimit dhe koordinimit institucional për një siguri maksimale për viktimën gjatë të gjithë procesit ligjor, zhvillimi i njohurive në zbatimin e protokollit shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale nga të gjithë profesionistët pjesëmarrës.

Objektivat

- Zgjerimi i njohurive lidhur me procedurën penale kur fëmija është viktimë;
- Analizimi dhe format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera lidhur me integritetin seksual;
- Aplikimi i drejtë i dispozitave ligjore lidhur me këto vepra penale.
- Zbatimi i kufizimit ligjor rreth marrjes së deklaratës së viktimës fëmijë dhe prezenca e përfaqësuesve të nevojshëm institucional;
- Aspektet psikologjike gjatë trajtimit të fëmijëve-viktima të dhunës seksuale.

Përmbajtja

- ✓ Veprat penale nga kapitulli XX i Kodit Penal të Republikës së Kosovës,
- ✓ Keqpërdorimi apo shfrytëzimi seksual i personave me çrregullime mendore ose paaftësi mendore ose emocionale;
- ✓ Sigurimi i provave materiale dhe personale;
- ✓ Ekzaminimet mjekësore, mjeko ligjore të viktimës dhe të kryesit.
- ✓ Marrja e deklaratës të dëmtuarës – viktimë fëmijë
- ✓ Kujdesi në qasje për shkak të ndjeshmërisë të viktimë fëmijë;
- ✓ Respektimi i konfidencialitetit të procedurës dhe privatësia e fëmijës;
- ✓ Njohuri mbi protokollin shtetëror dhe zbatimi i tij;
- ✓ Bashkëpunimi ndër institucional në kryerjen e veprimeve të nevojshme në trajtimin e rastit dhe sigurimin;

- ✓ Sqarimi-interpretimi i dispozitave ligjore te (mos) dhënia e pëlqimit të fëmijës lidhur me veprimet e të pandehurit në drejtim të fëmijës;
- ✓ Zbatimi i dispozitave ligjore të KDM-së kur viktimë është fëmija;
- ✓ Shmangia e ri viktimizimit të viktimës fëmijë.

Metodologjia

Interpretimi i dispozitave ligjore, interaktiviteti i pjesëmarrësve në trajnim, trajtimi i praktikës dhe aplikimi i konventave ndërkombëtare, puna në grupe.

Përfitues

Gjyqtarë dhe Prokurorë nga Departamenti për të Mitur, Mbrojtësit e viktimave Bashkëpunëtor profesional, Zyrtare Policor, Qendra për Pune Sociale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023
- Trajnuesi i Përhershëm në AD

2. Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit, masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit

Përfshirja e të miturit në aktivitetet kriminale, gjegjësisht sjelljet e tyre antisociale të cilat paraprakisht janë të parapara me norma juridiko-penale si vepra penale, obligon organet e drejtësisë në aplikimin e sanksioneve penale ndaj tyre. Si çdo vend në botë, edhe Kosova po përballlet me sfida të shumta. Një ndër sfidat më të rënda është prania e delikuencës së të miturve si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm kështu që zhvillimi i shkathtësive të prokurorëve dhe gjyqtarëve lidhur me shqiptimin e këtyre masave është nevojë e vazhdueshme. Mbështetur në zhvillimet sociale të përgjithshme, gjithsesi edhe shoqëria jonë ka treguar interesim dhe gatishmëri në perfeksionimin e sjelljes ndaj kryesve të veprave penale të cilët kanë rënë në kundërshtim me dispozitat juridiko-penale. Në këtë aspekt, edhe vendi ynë ka treguar tendenca të realizimit të një lufte adekuate kundër sjelljeve kriminale, me qëllim të parandalimit dhe luftimit më efikas të sjelljeve të tilla të miturve.

Objektivat

- Saktësojnë rastet kur ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin zbatohet procedura penale;
- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe akteve ndërkombëtare;
- Përcaktojnë se për cilat raste mund të shqiptohen masat apo dënimet ndaj një të mituri.

Përmbajtja

- ✓ Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin;
- ✓ Masat që shqiptohen ndaj të miturit;
- ✓ Dënimet që shqiptohen ndaj të miturit.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodologjia interaktive në formë të diskutimit e kombinuar me raste praktike.

Përfituesit

Gjyqtarë për të mitur, prokurorë për të mitur, zyrtarë nga Shërbimi Sprovues.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Drejtësia për fëmijë -Aspekti Civil

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Punëtorja për Hartimin e Programit Trajnues, 13-14 nëntor 2023

3. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve në procedurën kontestimore dhe jo kontestimore

Në praktiken gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet lidhur me çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë – mbajtjes financiare ka konstatuar praktike jo unike lidhur me vendimmarrjen, përveç tjerash edhe për zgjidhjen e çështjeve statusore siç u theksua më lartë.

Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilemat dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe për veç tjerash edhe për faktin edhe Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të kërkesave për çështjet statusore të cituara nuk kanë vërtetuar në tërësi gjendjen faktike.

Në procedurën sipas mjeteve të rregulltave dhe të jashtëzakonshme juridike është konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë e në disa raste edhe aktgjykimi i shkallës së dytë janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale për të cilat shkaqe aktgjykimet e instancave më të ulëta është dashur të prishen. Nevoja për mbajtjen e një tryeze të tillë diktohet nga numri i konsiderueshëm i rasteve që kthehen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbej si bazë e mire e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës kontestimore. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit penalistët duhet të marre në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtroj disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema.

Në fund të punimeve në tryezë panalistët do të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur, e i cili do të shërbej për unifikim e praktikës gjyqësore për rritjen e efikasitetit, ngritjen e cilësisë në vendimmarrje dhe sigurinë juridike.

Objektivat

- Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- Rritja e efikasitetit dhe cilësia në vendimmarrje;
- Siguria Juridike.

Përmbajtja

- ✓ Baza ligjore për kujdesin prindëror, caktimi i kontakteve personale dhe ushqimin – mbajtje financiare;
- ✓ Standardi i të provuarit – mjetet provuese;
- ✓ Marrje e mendimit të organit të kujdestarisë;

- ✓ Nxjerrja e provës me ekspertim nga lëmia përkatëse;
- ✓ Ndryshimi i vendimeve të gjykatës për çështje statusore;
- ✓ Përmbartimi i vendimeve;
- ✓ Masat e përkohshme;
- ✓ Adoptimi.

Metodologjia: Tryezë e Diskutimit

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Dy tryeza, nga 2 ditë, përfshirë regjionet si:

- Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan dhe
- Pejë, Gjakovë, Prizren.

KOMERCIALE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale

1. Njohuritë financiare

Trajnimi mbi njohuritë Financiare ofron njohuri praktike dhe teorike mbi financat dhe pasqyrat financiare të bizneseve, ku përmes tyre, pjesëmarrësit do të rrisin aftësinë dhe kompetencën financiare të tyre për aspektet financiare të çështjeve komerciale si dhe të përmirësojnë më tej aftësitë dhe ekspertizën duke u mundësuar atyre të hulumtojnë aspektet e ndërlikuara financiare me njohuri edhe më të mëdha.

Objektivat

- Pjesëmarrësit do të fitojnë një kuptim të thellë të analizës së deklaratave financiare, duke u mundësuar atyre të vlerësojnë dokumentet financiare në mënyrë efektive;
- Do të mund të analizojnë dokumentet që përbëjnë deklaratat financiare, duke siguruar që pjesëmarrësit të mund t'i interpretojnë këto dokumente në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- Identifikojnë shembuj praktikë të deklaratave financiare nga entet publike në Kosovë, duke i lejuar pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e tyre në skenarët e botës reale;
- Njohin llojet e ndryshme të opinioneve të auditit dhe atë që secili nënkupton në kontekstin e raporteve financiare;
- kenë një vështrim mbi treguesit kryesorë financiarë dhe implikimet e tyre, duke u ofruar pjesëmarrësve mjetet për të analizuar shëndetin financiar;
- Shqyrtojnë raste që përfshijnë mosmarrëveshje tatimore me Administratën Tatimore të Kosovës, duke shqyrtuar të ardhurat e humbura dhe duke dhënë një shembull konkret të të ardhurave të humbura në një procedim ligjor.

Përmbajtja

- ✓ Konceptet themelore të raporteve financiare
- ✓ Elementet e pasqyrave financiare
- ✓ Si të lexohen pasqyrat nga një jo-financier
- ✓ Indikatorët kyç të performancës së bizneseve dhe çfarë tregojnë ata
- ✓ Rast studimi
- ✓ Llojet e raporteve financiare dhe përdoruesit e tyre
- ✓ Korniza e raportimit
- ✓ Akterët dhe rolet specifike të akterëve në raportimin financiar global dhe në Kosovë
- ✓ Kontestet financiare mes operatorëve me impakt ekonomik/financiar
- ✓ Llojet e dëmeve të cilat shkaktohen gjatë transaksioneve mes palëve
- ✓ Koncepti i vlerës së parasë në kohë
- ✓ Përdorimi i konceptit të zhvlerësimit të parasë gjatë kontesteve ekonomike
- ✓ Ekspertiza financiare dhe ku do të mund të kontribuoj më së shumti
- ✓ Rast studimi
- ✓ Çështjet tatimore dhe fiskale të bizneseve
- ✓ Trendët e përgjithshme të kontesteve fiskale
- ✓ Vështrime nga sektori privat mbi kontestet tatimore dhe fiskale

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të ketë interaktivitet dhe do të përfshihen shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj konkret, ku të gjithë pjesëmarrësit do të aktiv dhe do të përfshihen në diskutime dhe ushtrime.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Strategjia për sundimin e Ligjit

2. Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Trajnimi do të fokusohet në shpjegimin e të gjitha shoqërive tregtare që mund të themelohen në Kosovë në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe aktivitetet ekonomike që mund të ushtrojnë në përputhje me kodet e aktiviteve. Po ashtu në përgjegjësitë dhe kompetencat e ARBK-së në aspektet si: kapitali themeltar, aksionet preferenciale, aksionet e zakonshme, dokumentet e themelimit, ruajtja e tyre, shpërndarja e dividendes etj. si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që lindin nga Ligji për Shoqëritë Tregtare. Për më tepër, në këtë trajnim do të trajtohen edhe qeverisja korporative, strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve si dhe bashkimet, ndarjet, dhe qarkullimi i korporatës.

Objektivat

- Listojnë shoqëritë e ndryshme tregtare;
- Përshkruajnë formën e organizimit të shoqërive tregtare dhe strukturat e tyre pronësore;
- Dallojnë të drejtat dhe detyrimet e aksionareve, përfaqësuesve të autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në lidhje me shoqëritë tregtare;
- Përshkruajnë dhe diskutojnë mosmarrëveshjet (problemet) që lindin deri tek rastet gjyqësore.
- Të kenë njohuri mbi qeverisjen korporative, strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve
- Të kuptojnë në përgjithësi se si bëhet bashkimi, ndarja dhe qarkullimi i korporatës.

Përmbajtja

- ✓ Llojet e Shoqërive Tregtare - Funksionet dhe Kompetencat e ARBK-së; Natyra e Organizimit të Shoqërive Tregtare dhe Struktura Pronësore;
- ✓ Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë;
- ✓ Qeverisja korporative;
- ✓ Strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve;
- ✓ Bashkimet, ndarjet, dhe qarkullimi i korporatës.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale

3. Hulumtimi, shkrimi dhe arsyetimi ligjor në fushën komerciale

Trajnimi për hulumtimin, shkrimin dhe arsyetimin ligjor në fushën komerciale ka për qëllim të ndihmojë gjyqtarët, bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale lidhur me hulumtimin ligjor, shqyrtimin gjyqësor dhe hartimin e vendimeve gjyqësore në fushën komerciale. Ky trajnim do të zhvillohet në një ambient interaktiv diskutimi në mënyrë që drejtpërdrejtë të ndihmohet në zhvillimin e aftësive analitike tek pjesëmarrësit duke trajtuar mënyrën se si duhet t'i qasemi një çështjeje juridike nga fusha komerciale, si duhet të realizohet hulumtimi i resurseve për çështjen objekt shqyrtimi jo vetëm me burimet e brendshme mirëpo edhe ato ndërkombëtare e të Bashkimit Evropian, si duhet të realizohet analiza ligjore dhe sipas cilave standarde duhet të bëhet shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Përveç udhëzimeve teorike lidhur me parimet dhe metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, pjesë e këtij trajnimi do të jenë edhe rastet dhe udhëzimet praktike në mënyrë që pjesëmarrësit njohurit e fituara të mund t'i aplikojnë në praktikë. Përmes udhëzimeve dhe rasteve konkrete nga fusha komerciale pjesëmarrësit do të kenë mundësi që duke zbatuar kërkesat e ligjeve nga fusha komerciale të japin konkluzionet e tyre për vendosjen e çështjeve që trajtojnë.

Objektivat

- Hulumtojnë burimet vendore, ndërkombëtare e veçanërisht ato të BE në fushën e të drejtës komerciale;
- Përdorin aftësitë interpretuese dhe zhvillojnë mendimin kritik si dhe demonstrojnë aftësitë hulumtuese për çështjet ligjore.
- Njohin rregullat bazë të shkrimit të akteve dhe dokumenteve ligjore;
- Krijojnë ide të qarta për mënyrën e arsyetimit të akteve dhe dokumenteve ligjore;
- Zhvillojnë shkathtësitë e arsyetimit dhe shkrimit ligjor;
- Përpilojnë aktet ligjore dhe ti arsyetojnë sipas metodave me bashkëkohore të arsyetimit dhe shkrimit ligjor.

Përmbajtja

- ✓ Mënyrat dhe çasja e hulumtimit ligjor;
- ✓ Llojet e arsyetimit ligjor;
- ✓ Parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- ✓ Kërkesat ligjore për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore;

Metodologjia: Tryezë e diskutimit

Diskutim teorik dhe praktik për metodat e analizës ligjore në rastet konkrete. Prezantim i rasteve komerciale dhe diskutime për mënyrën e vendosjes së supozuar meritore për rastet konkrete. Pjesëmarrësit përveç kontributit të tyre në diskutime sfidojnë edhe idetë e trajnuesit lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve alternative apo edhe problematike.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale..

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Strategjia për sundimin e Ligjit

4. Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtarë, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore

Trajnimi do të fokusohet në trajtimin e rregullave kryesore të së drejtës ndërkombëtare private të cilat mundësojnë gjykimin e kontesteve me element të huaj. Përmes këtij trajnimi gjyqtarët do të njoftohen me kompetencën e gjykatës në rastet kur njëra nga palët është e huaj, apo kur rasti ka çfarëdo elementi tjetër që e lidhë atë me një shtet tjetër. Gjithashtu, pjesëmarrësit do të njoftohen me rrugët e përcaktimit të së drejtës kompetente, dhe mënyra se si të zbatohet e drejta e huaj kur ajo del të jetë kompetente për kontestin në fjalë.

Objektivat

- Zgjidhin kontestet komerciale me element të huaj;
- Përshkruajnë kufijtë e fushëveprimit territorial edhe substancial të secilit instrument të trajtuar gjatë kursit;
- Diskutojnë mbi elementet kyçe të përmbajtjes së instrumenteve të diskutuara gjatë kursit;
- Identifikojnë instrumentet kryesore të UE-së dhe instrumentet tjera ndërkombëtare të cilat rregullojnë çështjet komerciale, fiskale dhe doganore;
- Zbatojnë Konventën për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (KShNM) në praktike;
- Përshkruajnë sfidat kryesore në zbatimin e instrumenteve të prezantuara gjatë kursit;
- Identifikojnë elementet e huaja në kontestet e tyre dhe të vlerësojnë relevancën e tyre në përcaktimin e kompetencës së Gjykatës Komerciale dhe në përcaktimin e së drejtës kompetente.

Përmbajtja

- ✓ Kontestet komerciale me element të huaj;
- ✓ Konventa e OKB- së për shitjen ndërkombëtare të mallrave;
- ✓ Zbatimi dhe specifikat e Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologjia interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Strategjia për sundimin e Ligjit

5. E drejta kontraktuese, kontratat e ndërtimit

Në këtë trajnim do të trajtohen çështjet lidhur me Kontratën për ndërtimin si një nga kontratat me komplekse në të drejtën kontraktuese - ekonomike. Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri të përgjithshme dhe të veçanta për kontratën e ndërtimit si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik. Kontrata për ndërtim do të trajtohet sipas kuadrit ligjor të Kosovës të cilat e rregullojnë këtë fushë, Parimeve të përgjithshme të FIDIC-ut, Direktivave të BE-ës dhe praktikave të mira gjyqësore.

Objektivat

- Interpretojnë në mënyrë të drejtë kontratën për ndërtim, përmbajtjen e saj, veçoritë e kontratës për ndërtim, të drejtat dhe detyrimet e palëve, përgjegjësitë civile-juridike të palëve në këtë raport kontraktues;
- Identifikojnë termat e përdorura, si dhe dokumentet përcjellëse të natyrës administrative apo të natyrës teknike profesionale;
- Njohin praktikën e mira gjyqësore;
- Vlerësojnë dhe zbërthejnë në mënyrë profesionale të gjitha faktet që kanë rëndësi vendimtare në kontestet me kontrata të ndërtimit, si parakusht për marrjen e vendime të drejta dhe të ligjshme si dhe;
- Aplikojnë në mënyrë profesionale legjislacionin, aktet nënligjore dhe aktet e tjera nga fusha e ndërtimitarisë, që janë të aplikueshme në gjykimin e kontesteve të kësaj natyre.

Përmbajtja

- ✓ Aspektet e përgjithshme të Kontratës për ndërtim në Kosovë dhe në vendet e tjera;
- ✓ Efektet juridike të Kontratës për Ndërtimin;
- ✓ Përgjegjësia civile - juridike në Kontratën e ndërtimit;
- ✓ Shuarja e Kontratës për ndërtimin dhe Përgjegjësia për të metat në punime;
- ✓ Kontrata Publike e Ndërtimit;
- ✓ Praktika gjyqësore në kontestet që rrjedhin nga kontrata për ndërtim.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi. Nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktiv gjatë gjithë trajnimit me qëllimin që të sqarohen të gjitha çështjet kyçe dhe të jenë në gjendje që të njëjtat t'i zbatojnë me sukses gjatë punës së tyre në praktikë.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Strategjia për sundimin e Ligjit

6. Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare

Trajnimi do të fokusohet në sqarimet e hollësishme rreth institucioneve financiare në Kosovë dhe legjislacionit që rregullon këtë industri. Gjithashtu qeverisjen korporative të institucioneve financiare me theks të veçantë të Bankave dhe Kompanive të Sigurimeve. Kjo për shkak se ka pak raste kur ka një strukturë të tillë qeverisëse si Bankat dhe Kompanitë e Sigurimeve.

Objektivat

- Identifikojnë specifikat e kontratës së kredisë dhe depozitave;
- Njohin përkufizimin e kontratës për kredinë, formën dhe elementet e kësaj kontrate, me klauzolat më të rëndësishme të kontratës për kredinë;
- Njohin përkufizimin e kamatës, me formën e llogaritjes së kamatës;
- Njohin klauzolat më të rëndësishme në lidhje me kamatëvonesën dhe shpërblimin e demit në rast të vonesës në kryerjen e obligimeve;
- Kuptojnë mënyrën e përllogaritjes së kamatës kontraktore dhe mënyrën e përllogaritjes së kamatëvonesës, sipas praktikave të bankave në Kosovë - Rregullave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Specifikat e Kompensimit i demit nga auto përgjegjësia dhe sigurimi vullnetare;
- Regresivin e demit.

Përmbajtja

- ✓ Industria financiare në Kosovë;
- ✓ Qeverisja korporative e institucioneve financiare dhe Struktura e Kapitalit;
- ✓ Sistemi bankar;
- ✓ Sektori i sigurimeve;
- ✓ Institucionet mikrofinanciare.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologjia interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale..

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Strategjia për sundimin e Ligjit

7. Procedura e falimentimit

Ligji për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencen, i cili i pasqyron praktikën më të mira ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik. Prandaj, trajnimi ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve komercial në fushën specifike të falimentimit me qëllim të krijimit të një praktike gjyqësore të avancuar dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Objektivat

- Shpjegojnë institutet kryesore të ligjit për Falimentimin dhe fushëveprimin e tij;
- Shpjegojnë pasojat e hapjes së rastit të falimentimit;
- Zhvillojnë procedurën e falimentimit dhe të aplikojnë specifikat e saj;
- Vlerësojnë kërkesat e kreditorëve, rregullsinë e paraqitjes, afatet dhe prioritetin e kërkesave;
- Vlerësojnë kushtet ligjore dhe të mbikëqyrin procedurën e ri-organizimit apo likuidimit të shoqërive tregtare;
- Të aplikojnë dispozitat ndërkufitare.

Përmbajtja

- ✓ Kuptimi i falimentimit;
- ✓ Dispozitat e përgjithshme të Ligjit për falimentimin; Procedurat e përshpejtuara (NMV dhe para-pakot);
- ✓ Fillimi dhe hapja e rasteve;
- ✓ Pasojat e hapjes së rasteve;
- ✓ Kërkesat e kreditorëve; Riorganizimi;
- ✓ Likuidimi;
- ✓ Lirimi individual dhe mbyllja e rastit;
- ✓ Dispozitat ndërkufitare.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Strategjia për sundimin e Ligjit

8. Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat dhe specifikat e industrisë së TIK-ut, licencimit dhe të drejtave të pronësisë industriale

E drejta e pronës intelektuale në përgjithësi dhe ajo e markave tregtare dhe patentave në veçanti (të gjitha së bashku referuar si pronësi intelektuale apo PI) është fushë e së drejtës relativisht e re në Kosovë. Institutet apo konceptet e kësaj lëmie me të cilat ballafaqohet sistemi gjyqësor janë shumë specifike dhe aspak të ngjashme me ato të cilat është ballafaquar sistemi gjyqësor tradicionalisht. Prandaj, vendimet gjyqësore mund të mos jenë të një niveli të duhur si për nga aspekti procedural ashtu edhe përmbajtësor gjë që zvogëlon besimin e komunitetit të biznesit tek gjyqësori. Trajnimi do të fokusohet në përditësimin e njohurive në këtë lëmi që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për një gjyqësor të efektshëm. Trajnimi gjithashtu do të fokusohet edhe në sqarimet e hollësishme rreth teknologjisë dhe impakti i saj në sistemin e drejtësisë veçanërisht në fushën e të drejtës elektronike komerciale si përgjegjësia ligjore, ndërmjetësuesit e shërbimeve, kontratat dixhitale etj. dhe në këtë vështirësi do të ofrohen praktikantët më të mira në zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Objektivat

- Njohin institutet kryesore e të drejtave të PI, markave tregtare e treguesve gjeografik, patentave e dizajneve industriale, si dhe të njohin dallimet midis këtyre instituteve;
- Aplikojnë parimet e së drejtës së PI dhe praktikantët e mira në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuesve;
- Aplikojnë parimet e së drejtës së PI dhe praktikantët e mira në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për marka tregtare dhe treguesit gjeografik si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për patenta dhe dizajnit industrial;
- Çmojnë më mirë vlerën që teknologjia krijon si dhe ndikimet e saj në fushën ligjore;
- Krahasojnë teoritë e ndryshme dhe praktikantët e mira që lidhen me ICT Law;
- Interpretojnë legjislacionet, politikat dhe praktikantët e mira rajonale dhe globale nga shtete apo organizata të ndryshme dhe të mund t'i përdorin këto njohuri sa më mirë për të zgjidhur rastet në Kosovë;
- Identifikojnë akteret përgjegjës dhe institucionet globale që mund të ndihmojnë në hetimin dhe identifikimin e akterëve përgjegjës;
- Njohin problematikat specifike në TIK si: përgjegjësia ligjore; pronësia; licencimi, privatësia etj.

Përmbajtja

- ✓ Të drejtat e PI - mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të autorit dhe të drejtat e përfaqësuesve;
- ✓ Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave nga markat tregtare dhe treguesit gjeografik;
- ✓ Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave nga patentat dhe dizajni industrial;
- ✓ Mjetet juridike për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- ✓ Baza e TI dhe e drejta elektronike komerciale; Teknologjia e informacionit dhe komunikacionit; Sfidat ligjore dhe etike që paraqet TIK;

- ✓ Rregullimi i TIK;
- ✓ Ushtrime;
- ✓ Komerçi elektronik;
- ✓ Transaksionet elektronike;
- ✓ Mbrojtja e të dhënave personale;
- ✓ Dallimi mes Privatësisë dhe të Dhënave; Rregullimi i Mbrojtjes së të Dhënave;
- ✓ Analiza e Ligjeve Relevante;
- ✓ Sfidat Ligjore;
- ✓ Të drejtat e autorit online, sfidat ligjore, rregullimi online, domenet dhe licencimi pronësisë intelektuale.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologjia interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale, divizioni për çështje Penale, Prokurorët, Zyrtarët Policorë nga Departamenti i Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës dhe Sektori i Krimeve Kibernetike.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale
- Propozimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Programin Trajnues 2024

9. Ndërmjetësimi, mënyrat e referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit - raste praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit komercial, Elaborimi i rasteve praktike ndërkombëtare të rasteve komerciale në ndërmjetësim

Trajnimi ka për qëllim të ofrojë sqarimet e detajuara për procedurën e ndërmjetësimit komercial që nga momenti kur lënda klasifikohet si e përshtatshme për ndërmjetësim, referimit të lëndës në ndërmjetësim, procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Trajnimi synon të sqaron dhe të ju ndihmojë gjyqtarëve të kuptojnë apo interpretojnë drejtë dispozitat ligjore të cilat lënë hapësirë për dykuptimësi në temat e propozuara dhe zbatimi jo unik i këtyre dispozitave nga ana e gjyqtarëve që trajtojnë lëndët e tilla. Nevoja për trajnim me fokus në këto tema specifike ka rrjedhur nga funksionalizimi i Gjykatës Komerciale e në të njëjtën kohë edhe i hapjes së zyrës për ndërmjetësim brenda kësaj gjykate si edhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për Ndërmjetësim dhe diskutimet nga gjyqtarët për sfidat praktike që hasin në punën e përditshme të tyre. Trajnimi pra synon të arritje ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve të cilët shqyrtojnë rastet komerciale dhe të ofrojë zgjidhje për sfidat që gjyqtarët hasin gjatë procedimit të rasteve komerciale në ndërmjetësim dhe ushtrimi i kompetencës së tyre në vlefshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Cilat janë sfidat më të mëdha për gjyqtarët gjatë referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, gjatë procedurës së aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit? Cilat janë dilemat e gjyqtarëve në ushtrimin e kompetencës së tyre gjatë vlerësimit të vlefshmërisë së marrëveshjeve të ndërmjetësimit? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e përpilimit të marrëveshjeve nga ana e ndërmjetësuesve? A ekziston ndonjë sfidë eventuale lidhur me implementimin apo përmbajtjen e Ligjit për Ndërmjetësim? Sfidat e zbatimit të Protokollit për Ndërmjetësim. Mënyra më e mirë e kuptimit të të gjitha koncepteve dhe zgjidhjes së dilemave është biseda interaktive me gjyqtarët dhe shtrimi i pyetjeve e përgjigja në të njëjtat përmes dhënies së sqarimit të dilemave me shembuj praktikë.

Objektivat

- Kuptojnë cilat lëndë komerciale janë të përshtatshme për referim në Ndërmjetësim.
- Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit
- Zbatojnë drejtë bazën ligjore të ndërmjetësimit;
- Unifikojnë praktikën e referimit, aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të arritura përmes ndërmjetësimit
- Unifikojnë zbatimin e Protokollit për Ndërmjetësim.
- Të fitojnë njohuri të drejtpërdrejta nga ekspert ndërkombëtar me praktikën e trajtimit të rasteve komerciale dhe ndërmjetësimit të tyre.
- Të kuptojnë rolin e ndërmjetësuesit në trajtimin e rasteve komerciale për ndërmjetësim.

Përmbajtja

- ✓ Referimi i lëndëve të përshtatshme në procedurën e ndërmjetësimit komercial - raste praktike;
- ✓ Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit;

- ✓ Sfidat në implementimin e Ligjit për Ndërmjetësim;
- ✓ Sfidat në implementimin e rregulloreve dhe protokollit për ndërmjetësim.

Metodologjia

Trajnimi do zhvillohet përmes ofrimit të informatave nga ana e trajnuesit/ve ndërkombëtarë, parashtrimi të pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna në bazë të shembujve më të mirë praktik që japin sqarim adekuat të procesit të referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të arritura në ndërmjetësim. Po ashtu do të paraqiten raste praktike në të cilët gjyqtarët duhen dhënë përgjigje apo opinione të tyre, ashtu që kuptimi i procedurës së ndërmjetësimit të jetë sa më lehtë i kapshëm.

Përfituesit

Përfitues të trajnimit për ndërmjetësim do të jenë gjyqtarët e gjykatës komerciale, bashkëpunëtorët profesional dhe stafin administrativ.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale

10. Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Arbitrazhit vendor dhe të huaj

Trajnimi me temën njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit vendor dhe të huaj ka për qëllim të sqaron saktësisht rëndësinë dhe procedurën e njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit si ato vendore ashtu edhe të huaja duke ndihmuar gjyqtarët të unifikojnë praktikën e njohjes dhe përmbartimit të këtyre vendimeve. Trajnimi synon të arrijë ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve në drejtim të interpretimit të drejtë dhe të saktë të dispozitave që mund të kenë dykuptimësi të njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit. Cilat janë sfidat që hasin gjyqtarët gjatë procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit vendor dhe të huaj? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit? A ekziston ndonjë sfidë eventuale lidhur me implementimin apo përmbajtjen e Ligjit për Arbitrazhin? Mënyra më e mirë e kuptimit të të gjitha koncepteve dhe zgjidhjes së dilemave është biseda interaktive me gjyqtarët dhe shtrimi i pyetjeve e përgjigjia në të njëjtat përmes dhënies së praktikave më të mira dhe qartësimit të problematikave mbi shembuj apo koncepte praktike.

Objektivat

- Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit
- Zbatojnë drejtë bazën ligjore të arbitrazhit;
- Unifikojnë praktikën e njohjes dhe përmbartimit

Përmbajtja

- ✓ Procesi i njohjes dhe të përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet në mënyrë interaktive nga pjesëmarrësit, prezantim në PowerPoint, shtjellime të rasteve praktike.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës Komerciale dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Reforma Ligjore për Zhvillimin Ekonomik në Ballkanin Perëndimor - GIZ

11. Arbitrazhi në kontestet investitor-Shtet (ISDS)

Projekti Reforma Ligjore për Zhvillimin Ekonomik në Ballkanin Perëndimor- GIZ, ndër të tjera, synon fuqizimin e kapaciteteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor në parandalimin dhe menaxhimin e kontesteve investitor-shtet. Si pjesë e kësaj përpjekje, në shtator 2023, projekti në bashkëpunim me Shkollën Rajonale për Administratë Publike (ReSPA) ka organizuar një program rajonal Trajnim i Trajnuesve lidhur me Zgjidhjen e Kontesteve Investitor-Shtet. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë nga Kosova dhe shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor me qëllim të avancimit të njohurive nga kjo fushë dhe më pas transferimit të tyre tek përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të ngjashme.

Momentalisht, e drejta e investimeve në Kosovë është subjekt i ndryshimeve thelbësore. Në tetor 2023, në Kuvend është miratuar Ligji për Investimet e Qëndrueshme, i cili parasheh një numër të madh të ndryshimeve procedurale dhe institucionale. Megjithatë ky ligj momentalisht është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, pas tejkalimit të kësaj faze, pritet që me hyrjen në fuqi të ligjit të hyjnë në fuqi ndryshime të reja në të drejtën e investimeve. Një nga ndryshimet kyçe që parasheh ky ligj është heqja e ofertës automatike nga ana e Republikës së Kosovës, për t'u paditur në arbitrazh ndërkombëtar për mosmarrëveshje që derivojnë nga ky ligj. Në praktikë kjo do të thotë që në të ardhmen gjasat që një mosmarrëveshje që ka bazën në këtë ligj të adresohet pranë Gjykatës Komerciale në Kosovë. Në anën tjetër, në sferën ndërkombëtare e në veçanti në kuadër të Bashkimit Evropian, e drejta ndërkombëtare e investimeve dhe ISDS ka pësuar ndryshime thelbësore. Duke marrë parasysh këto reforma dhe zhvillimet e tanishme në ISDS, GIZ është angazhuar fuqizimin e kapaciteteve përmes trajnimeve me qëllim të adresimit të temave të caktuara të ndërlidhura me prioritete dhe nevojat vendore. Si pjesë e kësaj përpjekje, në nëntor 2023, GIZ në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ka organizuar një trajnim për arbitrazhin ISDS, me qëllim të avancimit të njohurive teorike dhe praktike lidhur me pjesën materiale dhe procedurale të arbitrazhit ISDS, duke nisur nga iniciimi i procesit deri tek ekzekutimi i vendimeve, si dhe standardet e mbrojtjes së të drejtave të investitorëve të huaj. Në bazë të rekomandimeve që kemi pranuar gjatë këtij trajnimi nga aktorët kyç nga kjo fushë, GIZ do të organizojë Simulimin e Arbitrazhit ISDS, i cili ka për qëllim përforcimin e shkathtësive të pjesëmarrësve në procedurën e arbitrazhit në fushën e investimeve.

Objektivat e simulimit

Zhvillimi i Simulimit ka për qëllim objektivat si në vijim:

- Zhvillimi i aftësive të pjesëmarrësve në përgatitjen, prezantimin dhe argumentimin në kontestet ISDS, duke përfshirë hulumtimin ligjor, analizimin e rastit dhe aftësitë avokuese.
- Përfitimi i njohurive praktike dhe teorike të së drejtës së investimeve duke i përgatitur për probleme që mund t'i hasin në kontestet reale
- Thellimi i njohurive rreth kornizës ligjore të të drejtës së investimeve duke përfshirë legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare
- Zbatimi i njohurive të përfituara nga trajnimet e mëhershme
- Nxitja e bashkëpunimit dhe punës në ekip përmes caktimit të roleve të ndryshme

- Avancimi i aftësive për zgjidhjen e probleme dhe formulimit të strategjive efektive të trajtuar mosmarrëveshjet në kontekst të ISDS
- Ndërgjegjësimi rreth specifikave të fushës ISDS

Simulimi i Arbitrazhit ISDS

Simulimi synon të angazhojë pjesëmarrësit në mënyrë pro aktivë në procedurat e arbitrazhit. Pjesëmarrësit do të prezantohen me një rast, mbi të cilin do të përgatisin argumentet për paditësin apo shtetin e paditur (Republikën e Kosovës), varësisht në rolet që do ti përzgjedhin. Këto argumente do t'i prezantojnë ato gjatë simulimit. Rasti praktik do t'i dërgohet pjesëmarrësve në gjysmën e parë të muajit dhjetor 2023. Ndërsa palët do të kenë mundësi t'i dorëzojnë argumentet e tyre deri më 28 shkurt 2024. Së bashku me rastin do të ndahet edhe Manuali për Programin e Standardizuar të Trajnimit për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të investimeve (ISDS).

Përfituesit

Avokatët shtetërorë, përfaqësues nga Ministria e Tregtisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministrisë së Drejtësisë, gjyqtarët e Gjykatës Komerciale, përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës, përfaqësues nga Agjencia Kosovare e Privatizimit si dhe përfaqësues të agjencive tjera relevante në kontestet ISDS.

Kohëzgjatja

Simulimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Reforma Ligjore për Zhvillimin Ekonomik në Ballkanin Perëndimor - GIZ

12. Marrëdhëniet komerciale me element të huaj dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet komerciale

Ky trajnim është disajnuar për të dhënë njohuri të përgjithshme mbi risitë në fushën e së drejtës private në Kosovë në fokus në marrëdhëniet komerciale/tregtare. Si e tillë, ky trajnim do të adresojë e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe pjesën e specializuar të marrëdhënieve komerciale. Qëllimi i trajnimit është përditësimi i njohurive të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse në pjesën e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe mbi risitë e ligjit në përgjithësi, institutet dhe shtyllat kryesore të së drejtës ndërkombëtare private dhe do të njoftohen mbi risitë kryesore në tri shtyllat kryesore të tij: në përcaktimin e së drejtës kompetente, në kompetencën e gjykatave dhe në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe me specifikat e marrëdhënieve komerciale/tregtare me element të huaj.

Objektivat

- Përditësimi i njohurive: Trajnimi synon të përditësojë njohuritë e gjyqtarëve të gjykatave të Kosovës në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, me theks të veçantë në marrëdhëniet komerciale dhe tregtare. Ky qëllim përfshin njohurinë për risitë ligjore dhe institucionet që lidhen me marrëdhëniet me element të huaj.
- Kuptimi i autonomisë së vullnetit: Trajnimi synon të ndihmojë gjyqtarët në kuptimin e autonomisë së vullnetit të palëve në përcaktimin e së drejtës kompetente në marrëdhëniet komerciale me element të huaj.
- Praktikë ndërkombëtare: Trajnimi do të ofrojë shpjegime mbi praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të Unionit Evropian
- Rishikimi i vendimeve gjyqësore: Trajnimi synon të njohë gjyqtarët me procedurat dhe sfidat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe të punës
- Bashkëpunimi ndërkombëtar: Trajnimi synon të promovojë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, duke ofruar shembuj praktikë të bashkëpunimit në fushën e ndërkombëtare private.

Përmbajtja

- ✓ Përcaktimi i të drejtës kompetente në marrëdhëniet tregtare me element të huaj, autonomia e vullnetit të palëve në këtë përcaktim;
- ✓ Përcaktimi i të drejtës kompetente në marrëdhëniet e punës me element të huaj;
- ✓ Juridiksioni i gjykatave të Kosovës në marrëdhëniet tregtare me element të huaj dhe në kontestet nga e drejta e punës; juridiksioni i Gjykatës Komerciale në Kosovë në këto marrëdhënie; autonomia e vullnetit të palëve në përcaktimin e gjykatës kompetente (të Kosovës apo të huaj);
- ✓ Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe e drejta e punës; njohja e vendimeve gjyqësore të Kosovës në vendet tjera.
- ✓ Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në këtë fushë: shpjegime praktike mbi bashkëpunimin e gjykatave në marrjen e provave dhe shërbimin e dokumenteve

Metodologjia

Në trajnim do të aplikohet metodologjia e kombinuar mes shpjegimeve teorike të ndryshimeve që sjellë ligji dhe pjesës praktike të përbërë nga ushtrimet. Shpjegimet mbi risitë e ligjit dhe institutet e kësaj fushe të së drejtës bëhen duke elaboruar rastet kryesore në praktikë të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Unionit Evropian. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përveç që është shumë e pasur, është tejet udhëzuese për gjyqtarët kosovarë meqë interpreton dispozitat e njëjta të cilat janë transpozuar në LDNP në Kosovë. Ndërkaq, në pjesën e ushtrimeve, gjyqtarëve u prezantohen probleme hipotetike të fushave të caktuara, të cilat ndërthurin dilema të përcaktimit të së drejtës kompetente, kompetencës së tyre si gjykata në Kosovë dhe/apo dilema mbi njohjen apo refuzimin e njohjes së një vendimi të huaj.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në Gjykatën Komerciale në Kosovë.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë dy (2) ditë.

ADMINISTRATIVE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar nga Trajnuesi i Përhershëm në AD
- Punëtorja për hartimin e programit trajnues, 13-14 nëntor 2023

1. Mbrojtja gjyqësore në konfliktin administrativ

Në fokus të këtij trajnimi do të jetë mbrojtja gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ duke përfshirë të drejtën për qasje në gjykatë, standardet e të provuarit dhe mjetet provuese, vendimmarrjen dhe mjetet juridike. Tematika do të përqendrohet në trajtimin e ligjshmërisë së vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, në praktikën gjyqësore, dilemat e paraqitura profesionale dhe procedurale përkitazi me vendosjen e këtyre lëndëve. Synimi tjetër i këtij trajnimi është ofrimi i rekomandimeve dhe zgjidhjeve të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve dhe do të ndikojnë në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve. Gjithashtu në trajnim do të shqyrtohen llojet e lëndëve që paraqiten më shpesh pranë Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Objektivat

- Të interpretojnë drejt dispozitat ligjore për procedurën e konfliktit administrativ;
- Të zbërthejnë dhe njohin të drejtën për qasje në gjykatë;
- Të aplikojnë standardet e të provuarit;
- Të nxjerrin vendime të drejta dhe të ligjshme; dhe
- Të njohin rolin dhe rëndësinë e mjeteve juridike në procedurën e konfliktit administrativ.

Përmbajtja

- ✓ Dispozitat ligjore në procedurën e konfliktit administrativ;
- ✓ E drejta për qasje në gjykatë;
- ✓ Standardet e të provuarit;
- ✓ Nxjerrja e vendimeve të ligjshme dhe të arsyetuara; dhe
- ✓ Mjetet juridike në procedurën e konfliktit administrativ.

Metodologjia

Në këtë trajnim çështjet e ngritura do të trajtohen përmes shpjegimeve të pjesshme teorike, e më shumë duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu do të aplikohen diskutime dhe shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të procedurës në konfliktet administrative, pastaj puna në grupe, diskutimi i tyre me pjesëmarrës dhe në fund ofrimi i rekomandimeve për çështjet e diskutuara.

Përfituesit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që përfshihen në procedurat e konflikteve administrative.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar nga Trajnuesi i Përhershëm në AD
- Punëtorja për hartimin e programit trajnues, 13-14 nëntor 2023

2. Mbrojtja gjyqësore në kontestet - çështjet e prokurimit publik

Ky trajnim ka për qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve lidhur me mbrojtjen gjyqësore në kontestet-çështjet e prokurimit publik. Synim tjetër është trajtimi i gjithanshëm i procedurave të prokurimit në të gjitha etapat si: e procedurës së shqyrtimit, vlerësimin e shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimin për Organin Shqyrtues të Prokurimit - OSHP. Në këtë trajnim do të interpretohen edhe dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik duke zbërthyer kriteret lidhur me ciklin e procesit të prokurimit publik dhe kontestet me OSHP. Në praktikë shpeshherë ka probleme rreth kriterëve dhe në vlerësimin e tyre konform peshës së tyre andaj edhe nevoja e trajtimit të tyre. Gjithashtu do të trajtohet gjithanshëm procedura në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe mënyra e zhvillimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente. Synim tjetër është që shpjegimet dhe rekomandimet nga ky trajnim të ndihmojnë që procedurat e prokurimit të zhvillohen përmes kriterëve të definuara ligjore si dhe gjyqtarët të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore mbi prokurimin publik.

Objektivat

- Të njohin dhe zbërthejnë etapat e procedurës së prokurimit publik;
- Të identifikojnë karakteristikat e procedurës së konfliktit administrativ lidhur me çështjet e prokurimit publik;
- Të interpretojnë drejtë dispozitat ligjore në fuqi mbi prokurimin publik.
- Të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore mbi prokurimin publik në praktikën gjyqësore.

Përmbajtja

- ✓ Llojet dhe zbatimi i procedurave të prokurimit - rregullat e përgjithshme.
- ✓ Zhvillimi dhe udhëheqja e procedurave të prokurimit;
- ✓ Inicimi dhe zbatimi fillestar i procedurës së shqyrtimit;
- ✓ Procedura para Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- ✓ Mjetet juridike, dispozitat ndëshkimore dhe përfundimtare në procedurat e prokurimit.

Metodologjia

Çështjet dhe dilemat do të trajtohen përmes: ligjërimit të pjesshëm teorik, diskutimeve interaktive, shpjegimeve të ekspertëve të cilët do të argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Përmes bashkëbisedimit pjesëmarrësit do të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale para OSHP dhe praktikën gjyqësore të departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit.

Përfituesit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe zyrtarët e OSHP-së.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar nga Trajnuesi i Përhershëm në AD
- Punëtorja për hartimin e programit trajnues, 13-14 nëntor 2023

3. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën e konfliktit administrativ

Qëllimi i këtij trajnimi është trajtimi i çështjeve të mos arsyetimit adekuat ligjor të vendimeve që nxjerrën në procedurën e konfliktit administrativ. Gjithashtu synim tjetër është trajtimi i çështjeve që lidhen me mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit. Në procedimin e këtyre rasteve në gjykata po paraqiten dilema të ndryshme profesionale, procedurale dhe materiale përkitazi me vendosjen e lëndëve konkrete. Me këtë trajnim synohet ofrimi i zgjidhjeve praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësonin punën e gjyqtarëve dhe në instancë të fundit do të ndikonin në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve. Gjithashtu trajnimi do të fokusohet edhe në procedurën e inicimit të konfliktit administrativ dhe zhvillimit të saj në gjykatën kompetente ndaj vendimeve të organeve të administratës publike dhe organeve të qeverisjes në Kosovë.

Objektivat

- Të njohin rëndësinë e vendimeve gjyqësore të arsyetuara në procedurën e konfliktit administrativ;
- Të zbërthejnë llojet e arsyetimit ligjor dhe të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e parimeve të shkrimit të mirë ligjor;
- Të zbatojnë drejtë dispozitat e procedurës së konfliktit administrativ;
- Të njihen me kërkesat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave administrative – Departamenteve për Çështje Administrative në kontekst të standardeve që kërkon GJEDNJ në Strasburg.

Përmbajtja

- ✓ Roli dhe rëndësia e vendimeve gjyqësore të arsyetuara në procedurën e konfliktit administrativ;
- ✓ Llojet e arsyetimit ligjor dhe Parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- ✓ Arsyetimi i vendimeve gjyqësore të Departamenteve për Çështje Administrative (të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit) në kontekst të standardeve që kërkon GJEDNJ në Strasburg.

Metodologjia

Çështjet e ngritura do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, bazuar në raste konkrete. Përmes shpjegimeve, diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për konfliktet administrative, Punës në grupe dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës.

Përfituesit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

KUSHTETUESE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar nga Trajnuesi i Përhershëm në AD
- Punëtorja për hartimin e programit trajnues, 13-14 nëntor 2023

1. Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin civile

Synim kryesor i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me njohuritë e reja dhe vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave në lëmin civile. Qëllim tjetër është trajtimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rastet kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe ato të GJEDNJ, më konkretisht, është ofrimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe ato të GJEDNJ, pastaj analiza në sferën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në krahasimin e kësaj mbrojtjeje me standardet e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe GJEDNJ, si dhe do të trajtohen marrëdhëniet midis gjykatës kushtetuese dhe atyre të rregullta, veçanërisht marrëdhënies midis gjykatave kushtetuese dhe atyre të larta. Vëmendje do t'i kushtohet edhe kontrollit incidental të kushtetutshmërisë në kontekst të zhvillimeve të praktikës aktuale gjyqësore.

Objektivat

- Të njihen me çështjet kryesore juridike të ngritur në rastet sipas kërkesave në lëmin civile para Gjykatës Kushtetuese;
- Të kuptojnë qasjet dhe qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtësore të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ);
- Të njihen me praktikën e dy gjykatave, dhe veçoritë e tyre duke qenë se Gjykata Kushtetuese është gjykatë kombëtare, për dallim nga GJEDNJ në Strasburg që është gjykatë mbinacionale-ndërkombëtare njëkohësisht të kuptojnë botëkuptimet dhe qasjet profesionale të këtyre dy gjykatave, përkitazi me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të njeriut, e që janë të ndërlidhura;
- Të zbatojnë efektivisht detyrimin kushtetues specifik nga nenit 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës - “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore... (duhet të) interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- Të njihen me arsyet se pse Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në praktikën e saj mbështetet fuqimisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe si i qaset kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Përmbajtja

- Procedura e lejueshmërisë së kërkesave të natyrës civile dhe veçoritë e praktikës aktuale të Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmin civile;
- Çështjet kryesore juridike të ngritura në rastet-kërkesave në lëmin civile para Gjykatës Kushtetuese;
- Qasjet dhe qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtësore të të drejtave dhe lirive individuale.

- Veçoritë e praktikave të këtyre dy gjykatave si një sfidë në vete dhe qëndrimet-qasjet profesionale të këtyre dy gjykatave, përkitazi me mbrojtjen gjyqësorë të të drejtave të njeriut.
- Arsye se pse Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në praktikën e saj mbështetet fuqimisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe shpjegimi i gjithanshëm i Detyrimit kushtetues specifik për zbatimin e nenit 53 të Kushtetutës - “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore... (duhet të) interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- Të mësojnë dhe zbatojnë institutin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Metodologjia

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të kenë mundësin që përmes bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri të reja mbi vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave-ankesave në lëmin civile si dhe mbi rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë. Fokusi do të jetë edhe në ofrimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Rekomanduar nga Trajnuesi i Përhershëm në AD
- Punëtorja për hartimin e programit trajnues, 13-14 nëntor 2023

2. Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin penale

Synim kryesor i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me njohuritë e reja dhe vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave në lëmin penale. Qëllim tjetër është trajtimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rastet kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe ato të GJEDNJ, më konkretisht, është ofrimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe ato të GJEDNJ, pastaj analiza në sferën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në krahasimin e kësaj mbrojtjeje me standardet e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe GJEDNJ, si dhe do të trajtohen marrëdhëniet midis Gjykatës Kushtetuese dhe atyre të rregullta, veçanërisht marrëdhënies midis gjykatave kushtetuese dhe atyre të larta. Vëmendje do t'i kushtohet edhe kontrollit incidental të kushtetutshmërisë në kontekst të zhvillimeve të praktikës aktuale gjyqësore.

Objektivat

- Të njihen me çështjet kryesore juridike të ngritur në rastet sipas kërkesave në lëmin penale para Gjykatës Kushtetuese;
- Të kuptojnë qasjet dhe qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtësore të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).
- Të njihen me praktikën e dy gjykatave, dhe veçoritë e tyre duke qenë se Gjykata Kushtetuese është gjykatë kombëtare, për dallim nga GJEDNJ në Strasburg që është gjykatë mbinacionale-ndërkombëtare njëkohësisht të kuptojnë botëkuptimet dhe qasjet profesionale të këtyre dy gjykatave, përkitazi me mbrojtjen gjyqësorë të të drejtave të njeriut, e që janë të ndërlidhura.
- Të zbatojnë efektivisht detyrimin kushtetues specifik nga nenit 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës - “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore... (duhet të) interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- Të njihen me arsyet se pse Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në praktikën e saj mbështetet fuqimisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe si i qaset kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Përmbajtja

- ✓ Procedura e lejueshmërisë së kërkesave të natyrës civile dhe veçoritë e praktikës aktuale të Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmin penale;
- ✓ Çështjet kryesore juridike të ngritura në rastet-kërkesave në lëmin penale para Gjykatës Kushtetuese;
- ✓ Qasjet dhe qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtësore të të drejtave dhe lirive individuale.

- ✓ Veçoritë e praktikave të këtyre dy gjykatave si një sfidë në vete dhe qëndrimet-qasjet profesionale të këtyre dy gjykatave, përkitazi me mbrojtjen gjyqësorë të të drejtave të njeriut.
- ✓ Arsyet se pse Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në praktikën e saj mbështetet fuqimisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe shpjegimi i gjithanshëm i Detyrimit kushtetues specifik për zbatimin e nenit 53 të Kushtetutës - “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (duhet të) interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- ✓ Të mësojnë dhe zbatojnë institutin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Metodologjia

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të kenë mundësin që përmes bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri të reja mbi vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave-ankesave në lëmin penale si dhe mbi rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë. Fokusi do të jetë edhe në ofrimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë

KEDNJ

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1. Qasja në mjete juridike efektive

Qëllimi i trajnimit është ngritja e njohurive të pjesëmarrësve për të drejtën si mjet juridik efektiv, i cili është një komponent thelbësor i të drejtave të njeriut sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut. Neni 13 i KEDNJ-së përcakton se “kushdo të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Konventë, gëzon të drejtën për përdorimin e mjeteve juridike efektive përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në cilësinë zyrtare”. Qasja në mjete juridike efektive duhet të sigurohet në sistemet ligjore kombëtare në të gjitha nivelet e procedurave gjyqësore. Në praktikë, këto mjete juridike duhet të shteren në shkallën më të ulët përpara aplikimit në institucionet e nivelit më të lartë gjyqësor, si dhe në hierarkinë e sistemit ligjor kombëtar përpara aplikimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Krijimi i mekanizmave të brendshme duhet së pari të shterohet përpara se individët të mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e drejta për një mjet efektiv juridik i jep efekt parimit të subsidiaritetit, i përforcuar edhe nga kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 35 të KEDNJ. Kështu, ky parim pasqyron rolin themelor të sistemeve gjyqësore kombëtare në garantimin e respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut, si pjesë integrale e sistemit të Konventës. Pjesëmarrësit do të analizojnë shumë raste nga praktika e GJEDNJ-së që i referohen shkeljes së nenit 13 që zbulon dështimin e shteteve anëtare për të zbatuar mjete juridike të brendshme efektive. Për më tepër, pjesëmarrësit do të mësojnë se si shkelja e nenit 13 ndodh gjithmonë në lidhje me një të drejtë tjetër të përcaktuar nga KEDNJ dhe Protokollat e saj, pasi e drejta për mjete efektive juridike nënkupton shkeljen e të drejtave të njeriut në radhë të parë, ose të paktën ankesën në këtë respekt. Përveç kësaj, praktika gjyqësore në lidhje me nenin 35 të KEDNJ-së në lidhje me mos shterjen e mjeteve juridike të brendshme është plot me shembuj konkret të rasteve që përfshijnë mjete efektive juridike që nuk ishin shterur përpara aplikimit në GJEDNJ.

Objektivat

- Zbatojnë standardet dhe praktikat përkatëse të GJEDNJ-së për të drejtën për një mjet efektiv juridik në praktikën e tyre gjyqësore;
- Do të përforcojnë më tej kapacitetin e mjeteve juridike të brendshme për të qenë efektive në heqjen e shkeljeve të të drejtave të Konventës;
- Zbatojnë parimet themelore ligjore të referuara si mjete juridike efektive dhe të njihen me karakteristikat e kërkuara të mjeteve juridike në situata të caktuara specifike, si dhe me mjetet juridike në përgjithësi.

Përmbajtja

- ✓ Qasja në mjetet juridike efektive - Standardet dhe parimet e aplikuara nga GJEDNJ (referenca në GJEDNJ, artikuj përkatës, udhëzues);
- ✓ Parimi i subsidiaritetit – Zbatimi praktik;
- ✓ Shkelje e nenit 13 në lidhje me nenet e tjera të KEDNJ;
- ✓ Aspektet procedurale të papranueshmërisë ndaj GJEDNJ – praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 35 të KEDNJ;

- ✓ E drejta për mjete efektive juridike (neni 13 i KEDNJ) – Praktika Gjyqësore e Gjykatës; Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ);
- ✓ Rast studimi/skenar hipotetik/diskutim.

Metodologjia

Trajnimi do të përfshijë prezantime dhe diskutime ndërvepruese dhe shkëmbime me pjesëmarrësit në një mjedis kolegë-kolegë. Fokusi do të jetë në analizën e jurisprudencës përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe standardeve dhe praktikës së aplikuar në jurisprudencën e saj. Për vlerësimin e efektiv të trajnimit, pjesëmarrësve do t'u kërkohej të plotësojnë pyetësorët e vlerësimit para dhe pas trajnimit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe bashkëpunëtorë profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

2. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 5 dhe nenit 6 të KEDNJ

Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, instrumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) janë drejtpërdrejt të zbatueshme në sistemin juridik dhe kanë përparësi në interpretim ndaj legjislacionit kombëtar. Më tej, neni 53 i Kushtetutës thotë se të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë aspekt, Akademia e Drejtësisë e konsideron të rëndësishme ofrimin e trajnimeve për praktikuesit ligjorë në gjyqësorin e Kosovës mbi standardet përkatëse të përcaktuara në KEDNJ dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas neneve të ndryshme të këtij instrumenti të gjallë. Një gjë e tillë gjithashtu u theksua nga gjyqtarët dhe prokurorët gjatë procesit të vlerësimit të nevojave për trajnim të realizuar së fundmi nga Akademia e Drejtësisë. Bazuar në nevojat e praktikës, u paraqitën kërkesa specifike për jurisprudencën sipas nenit 5 të KEDNJ, E drejta për Liri dhe Siguri, dhe nenin 6 KEDNJ, E drejta për Gjykim të Drejtë, të cilat në shumë raste konsiderohen të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

E drejta për liri dhe siguri (neni 5 KEDNJ), që korrespondon me nenin 29 të Kushtetutës, është e një rëndësie më të madhe në një shoqëri demokratike dhe është një e drejtë themelore e njeriut që garanton që të gjithë individët duhet të jenë të lirë nga privimet arbitrare ose të pajustificuara. Kjo e drejtë ka statusin e të drejtave relative dhe, si e tillë, kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet vetëm në raste të veçanta, në bazë të vendimeve gjyqësore dhe në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara me ligj. Parimi udhëzues është se heqja e lirisë urdhërohet në raste të jashtëzakonshme, si masë e fundit, në situata të tilla si ekzekutimi i dënimit me burgim për kryerjen e një veprë penale, dhe vetëm mbi dyshimin e arsyeshëm se mund të kryhet një vepër penale, në rastet kur liria privohet në mënyrë të arsyeshme dhe konsiderohet e nevojshme për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale, dhe vetëm për një kohë të kufizuar përpara gjykimit siç parashihet me ligj, dhe për qëllime të mbikëqyrjes arsimore të të miturit ose për qëllimin e sjelljes së të miturit para një institucioni kompetent në në përputhje me urdhrin gjyqësor. Për më tepër, Në kornizën ligjore të Kosovës, pjesët kryesore të legjislacionit në këtë fushë përfshijnë Kushtetutën, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur, andaj, kursi do të shqyrtojë zbatimin e tyre duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ dhe GJEDNJ, si dhe duke ofruar mjete konkrete për praktikuesit se si të avancojnë procesin e vendim marrjes, cilësinë e vendimeve dhe arsyetimin e tyre. Në këtë rast, tre aspekte kyçe të identifikuar nga vlerësimet e bëra nga organizatat ndërkombëtare që duhen trajtuar përmes analizave të standardeve dhe praktikës evropiane përfshijnë në mënyrë të gjerë zbatimin e paraburgimit duke përfshirë, kohëzgjatjen e tepërt dhe arsyetimin joadekuat të caktimit të paraburgimit. E drejta për gjykim të drejtë mbrohet me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila specifikon në paragrafin 6.1 të saj përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij/saj si qytetarë për çdo akuzë penale kundër tij/saj, çdokush ka të drejtë për një proces të drejtë gjyqësor dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga kohor nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Paragrafi 6.2 më tej thekson se kushdo që akuzohet për një vepër penale do të prezumohet i pafajshëm derisa të provohet e kundërta sipas ligjit. Paragrafi 6.3 përcakton të drejtat minimale të çdo personi të akuzuar, duke përfshirë informimin e menjëhershëm, në gjuhën që ai/ajo e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij/saj. Përveç kësaj, ai/ajo duhet të ketë

kohën dhe lehtësitë e duhura për përgatitjen e mbrojtjes së tij/saj dhe të mbrohet personalisht ose përmes ndihmës juridike me të drejtën për të marrë pjesë dhe për të marrë në pyetje të gjithë dëshmitarët në emër të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarë kundër tij/saj dhe të ketë ndihmën e një përkthyesi nëse nuk e kupton gjuhën e folur në gjykatë. Punësoria do të ofrojë një platformë për të eksploruar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në përputhje me Udhëzuesit e GJEDNJ-së mbi nenin 6 të KEDNJ-së, i cili ofron referenca për rastet historike si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale. Praktika e zhvilluar nga GJEDNJ dhe qasja kur vendoset për raste specifike do të shërbejë si një burim i vlefshëm për praktikuesit në gjyqësorin e Kosovës në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtat procedurale dhe procesin e rregullt, deri në arsyetimin cilësor të aktgjykimeve.

Objektivat

- Të zbatojë standardet dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të Drejtën për Liri dhe Siguri
- Të përdorin gjithnjë e më shumë alternativat ndaj paraburgimit në fazën paraprake të procedurës
- Zvogëlojnë kohëzgjatjen e paraburgimit, si mjet i fundit dhe për një kohë të kufizuar
- Të ofrojnë arsyetim cilësor me rastin e shqiptimit të paraburgimit
- Të zbatojnë standardet dhe praktikën e GJEDNJ-së sipas nenit 6 të KEDNJ-së, për të Drejtën për Gjykim të Drejtë
- Të procedojnë në mënyrë më efikase rastet në respekt të kohës së arsyeshme të procedimit
- Të ofrojnë arsyetim cilësor në të gjitha fazat e procedurës

Përmbajtja

- ✓ E drejta për liri dhe siguri, neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ);
- ✓ Natyra jo-absolute e së drejtës për liri dhe siguri;
- ✓ Fushpveprimi i zbatimit;
- ✓ Deprivimi ligjor i së drejtës së lirisë;
- ✓ Paraburgimi;
- ✓ Garancitë për personat e privuar nga liria.

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 6 i KEDNJ

- ✓ Fushëveprimi i zbatimit;
- ✓ E drejta për qasje në gjykatë;
- ✓ Koncepti i "tribunalit" ("gjykatës");
- ✓ Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës;
- ✓ Konsiderata të përgjithshme mbi neni 6, aspekti penal;
- ✓ Fushëveprimi: nocioni "kallëzim penal";
- ✓ Garancitë e përgjithshme: kërkesat institucionale;
- ✓ Garancitë e përgjithshme: kërkesat procedurale;
- ✓ Garancitë specifike;
- ✓ Efekti ekstra-territorial i nenit 6.

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet duke kombinuar prezantime dhe diskutime ndërvepruese me pjesëmarrësit, me studime të rasteve që përfshijnë analizat e praktikës gjyqësore dhe duke punuar në skenarë sipas hipotetikut. Punëtoritë personale bazuar në metodologjinë e Këshillit të Evropës mbi arsimimin për të drejtat e njeriut për profesionistët ligjorë (HELP), do të plotësohen me module të mësimit elektronik në platformën online HELP, duke përfshirë të Drejtën për Liri dhe Siguri, dhe Alternativat e Paraburgimit sipas Nenit 5. KEDNJ, dhe Masat Mbrojtëse Procedurale në Procedurat Penale dhe Arsytimi Gjyqësor dhe të Drejtat e Njeriut, sipas nenit 6 të KEDNJ. Pyetësorët e vlerësimit para dhe pas trajnimit mund të shpërndahen tek përfituesit për të matur efektet e trajnimit.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë, ndërsa afatet kohore për kurset HELP (nëse janë të lidhura) do të bien dakord me përfituesit, pasi ato janë të disponueshme si module të vetë-mësimit dhe me tutor (koha e nevojshme për t'i përfunduar është 7- 10 orë, dhe u takon përfituesve të zgjedhin se kur duan të ndjekin modul pas moduli). Pjesëmarrësit do të përfshijnë gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe bashkëpunëtorë profesional.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe bashkëpunëtorë profesional.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti PRO - FREX

3. Liria e Shprehjes dhe Mbrojtja gjyqësore në rastet e cenimit të lirisë së shprehjes - Trajnim i specializuar për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPPs)

SLAPP (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) paraqesin një sfidë të re për profesionistët ligjorë, duke kërkuar një fokus të ri në kuptimin dhe strategjinë ligjore. Paditë SLAPP janë padi që prima facie vërehen se nuk janë të bazuara në fakte dhe se do të jenë të pasuksesshme në gjykatë. Përmes tyre, paditësi nuk synon të fitojë rastin, por ka për qëllim që të frikësojë dhe dekurajojë gazetarët nga raportimi i mëtejshëm i çështjeve me interes publik duke i detyruar ata të kalojnë nëpër procese të gjata dhe të kushtueshme gjyqësore. Për gjyqtarët dhe prokurorët, rritja e SLAPP-ve kërkon një ndërgjegjësim të shtuar dhe një qasje të nuancuar në trajtimin e tyre. Është thelbësore që këto padi të identifikohen herët, të kuptohet natyra e tyre shpeshherë kërcënuese dhe të zbatohen parimet ligjore që balancojnë të drejtën e procesit gjyqësor me mbrojtjen e pjesëmarrjes publike dhe shprehjes së lirë.

Trajtimi efektiv i SLAPP-ve do të kërkojë trajnim të synuar gjyqësor, njohje me kuadrin ligjor anti-SLAPP dhe një angazhim për të penguar praktika të tilla përmes vendimmarrjes së arsyeshme. Ndërsa SLAPP evoluon, roli i gjyqësorit në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe sigurimin e drejtësisë kundër këtyre taktikave ligjore bëhet gjithnjë e më imperativ.

Objektivat

- Identifikojnë qartazi dhe diferencojnë paditë SLAPP;
- Kuptojnë më mirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me SLAPP-të, duke kuptuar se si këta precedentë ndikojnë në interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në kontekstin e lirisë së shprehjes dhe frikësimit ligjor;
- Njohin karakteristikat e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike, dallimin e tyre nga pretendimet ligjore legjitime, duke mundësuar një përgjigje gjyqësore më të informuar dhe efektive;
- Kuptojnë dhe përdorin parimet specifike ligjore dhe veprimet anti-SLAPP, duke ofruar një mbrojtje të fortë për ata që janë në shënjestër të padrejtë nga padi të tilla;
- Kujtojnë tendencat në nivel të BE-së, njohin zhvillimet dhe përgjigjet ligjore ndaj padive SLAPP në nivel të Bashkimit Evropian;
- Kuptojnë më thellë iniciativat në nivel të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në luidhje me kundërvënien e përdorimit të padive SLAPP.

Përmbajtja

- ✓ Përkufizimi dhe Karakteristikat e SLAPP-ve
- ✓ Konteksti historik dhe aktualizimi i tyre
- ✓ Ndikimi i SLAPP-ve në Lirinë e Shprehjes dhe Proceset Demokratike
- ✓ Raste studimore që nxjerrin në pah ndikimin mbi individët dhe shoqërinë
- ✓ Roli i SLAPP-ve në mbyajtjen e pjesëmarrjes dhe diskursit publik

- ✓ Parimet ligjore dhe shqetësimet për të drejtat e njeriut
- ✓ Pasqyrë e të drejtave përkatëse të njeriut të mbrojtura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- ✓ Ndërveprimi ndërmjet lirisë së shprehjes, të drejtës për gjykim të drejtë dhe privatësisë
- ✓ Pasqyrë e Rekomandimeve dhe Rezolutave të Këshillit të Evropës për SLAPP-të
- ✓ Roli i Komitetit të Ministrave në adresimin e SLAPP-ve
- ✓ Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për SLAPP-

Metodologjia

Metoda specifike të trajnimeve për profesionistë ligjorë do të aplikohen për këtë trajnim. Do të përdoren ushtrime për shkrimin e akullit, prezantime në PPT, raste studimore, ushtrime në grup, sondazhe të opinionit publik, debate të nxitura nga trajnuesit e specializuar në fushën e lirisë së shprehjes, provime vlerësimi. Trajnimi do të bazohet në tërësi në manualin e trajnimit të zhvilluar nga projekti i Këshillit të Evropës, PRO-FREX.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe Prokuroret nga regjione të ndryshme.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)

4. Mbrojta e të dhënave personale

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizike, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike. Në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia është përgjegjëse për trajtimin e ankesave për qasje në dokumente publike për monitorimin, raportimin për zbatimin e LQDP, bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse dhe shqiptimin e masave ndëshkuese për institucionet që nuk i përmbushin obligimet ligjore në raport me qasjen e në dokumente publike. Në relacion të zbatimit të ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia trajton ankesat e subjekteve dhe individëve për mbrojtjen e të dhënave personale, ofron këshilla organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave, kryen inspektime lidhur me zbatimin e këtij ligjit, jep opinione për institucionet publike dhe organet tjera, si dhe publikon për çdo çështje lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian, lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, Agjencia konsideron të nevojshme dhe po ashtu të rëndësishme bashkëpunimin me Akademisë së Drejtësisë për bashkëpunim në kuadër të realizimit të aktiviteteve për promovimin e së drejtës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Rëndësia e zbatimit të së drejtës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, paraqet nevojë të domosdoshme të zbatimit të këtyre dy të drejtave në praktike nga ana e sistemit gjyqësor dhe prokurorial kërkon bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm ndër-institucional në mënyrë që të ofroj zgjedhje për dilemat e mundshme që mund të shfaqen në realizimin e këtyre dy të drejtave.

Programi i bashkëpunimit ndër-institucional do t'i shërbente pyetjeve dhe dilemave të evidentuara gjatë trajtimit të ankesave për qasje në dokumente publike të përcaktuara me:

- Balancimi i së drejtës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale
- Caktimi i testit të dëmit dhe
- Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike me përmbajtje sensitive

Qasja në adresimin e dilemave të ngritura aspo pyetjeve gjatë trajnimit do të realizohet nëpërmjet trajtimit të ankesave specifike të për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale me shembuj konkret të reagimit dhe trajtimit të rasteve.

Objektivat

- Promovimi i së drejtës për qasje në dokumente publike
- Promovimi i së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale

Përmbajtja

- ✓ Mbrojta e të dhënave personale
- ✓ Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit
- ✓ Roli i Zyrtarëve Kryesor Administrativ dhe zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale
- ✓ Parimet e përpunimit të dhënave personale
- ✓ Roli i Agjencisë për Informim dhe Privatësi në zbatimin e LMDhP
- ✓ Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale
- ✓ Informacioni dhe qasja në të dhënat personale
- ✓ Anonimizimi i të dhënave personale

Qasja në Dokumente publike:

- Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit
- Roli i Zyrtarëve Kryesor Administrativ dhe zyrtarëve përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike
- Parimet themelore të së drejtës në qasje në dokumente publike
- Roli i Agjencisë për Informim dhe Privatësi në zbatimin e LQDP
- Qasja në dokumente publike në baze të kërkesës
- Publikimi me iniciativë të institucioneve publike

Metodologjia

- Analizimi i kërkesave për qasje në dokumente publike nga Gjykatat dhe Prokuroritë;
- Cikli i menaxhimit të kërkesave të adresuara në institucione nga pranimi deri të raportimi;
- Pasojat mundshme të mos respektimit të obligimeve ligjore;
- Ndikimi i drejtpërdrejtë i zbatimit të ligjit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve.

Përfituesit

Gjyqtarët, Prokurorët, Bashkëpunëtorët profesional, Zyrtarët për Qasje në Dokumente Publike, Zyrtarët për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

E DREJTA EVROPIANE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Trajnuesi i Përhershëm në AD

1. Efekti i të Drejtës së Unionit Evropian

Synimi kryesor i këtij trajnimi është avancimi i njohurive mbi efektin e së drejtës së Unionit Evropian dhe analiza e aspekteve të zbatimit të kësaj të drejte para dhe pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Qëllim tjetër është zbatimi i së drejtës evropiane dhe efektet e saj në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejt dhe i tërthortë); Efekti i së Drejtës së UE-së në të drejtën e Republikës së Kosovës - pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin. (Harmonizimi i të drejtës nacionale me atë evropiane, baza juridike e interpretimit të harmonizuar, vëllimi dhe kufijtë e interpretimit të harmonizuar gjyqësor në periudhën para anëtarësimit dhe vështirësitë); Zbatimi së drejtës së UE-së nga ana e gjykatave nacionale – përvoja nga shtetet në regjion; Raste praktike të zbatimit të së drejtës së UE-së nga ana e gjykatave të disa shteteve anëtare të UE-së.

Objektivat

- Të zbërthejnë efektin e së Drejtës së UE-së në sistemin kushtetues dhe të drejtën e Republikës së Kosovës - pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.
- Të interpretojnë efektin e së drejtës evropiane në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejt dhe i tërthortë) veçmas në Republikën e Kosovës.
- Të zbatojnë drejtë legjislacionin e UE-së në Republikën e Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.
- Të zbërthejnë raste praktike të zbatimit të së drejtës së UE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtarë të UE-së.

Përmbajtja

- Zbatimi i së drejtës evropiane dhe efektet e saj në nivel nacional (efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta)
- Efekti i së Drejtës së BE-së në sistemin kushtetues dhe të drejtën e Republikës së Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin. (Harmonizimi i të drejtës nacionale me atë evropiane, baza juridike e interpretimit të harmonizuar, vëllimi dhe kufijtë e interpretimit të harmonizuar gjyqësor në periudhën para anëtarësimit dhe vështirësitë).
- Zbatimi së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave nacionale – përvoja nga shtetet në regjion.
- Raste praktike të zbatimit të së drejtës së UE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtarë të BE-së.

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive dhe analizë të rasteve gjyqësore. Gjithashtu në këtë trajnim synohet realizimi i një pjesëmarrjeje aktive të pjesëmarrësve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjas një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Trajnuesi i Përhershëm në AD

2. Unifikimi i legjislacionit penal me atë të vendeve të UE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në UE

Synimi kryesor i organizimit të këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve në çështjet e unifikimit të legjislacionit penal me atë të vendeve të BE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në Unionin Evropian - UE-së. Synim tjetër është trajtimi i gjithanshëm i zbatimit të së drejtës evropiane penale dhe efektet e saj në nivel nacional si dhe përmes demonstrimit të rasteve praktike të zbatimit të së drejtës së UE-së nga ana e gjykatave të disa shteteve anëtare të UE-së dhe shteteve në region.

Objektiva

- njohin zbatimin e drejtë të së drejtës evropiane penale dhe efektet e saj në nivel nacional,
- avancojnë njohurit e tyre në çështjet e unifikimit të legjislacionit penal me atë të vendeve të UE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në UE.
- aftësohen në aspekt të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit të UE-së në lëmin e mbrojtjes dhe përkrahjes viktimave të veprave penale;
- të procedojnë me lëndët me element ndërkombëtar;
- aftësohen në aspekt të zbatimit të dispozitave dhe praktikës së shteteve anëtare të UE-së në këtë lëmi.

Përmbajtja

- ✓ Zbatimi i drejtë i së drejtës evropiane penale dhe efektet e saj në nivel nacional,
- ✓ Unifikimi i legjislacionit penal me atë të vendeve të UE-së - Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale (aspekti procedural) në UE.
- ✓ Njohja dhe zbatimi i legjislacionit të UE-së në lëmin e mbrojtjes dhe përkrahjes viktimave të veprave penale;
- ✓ Procedimi i lëndëve me element ndërkombëtar;
- ✓ Zbatimi i dispozitave dhe praktikës së shteteve anëtare të UE-së në këtë lëmi.

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore. Gjithashtu në këtë trajnim synohet realizimi i një pjesëmarrjeje aktive të pjesëmarrësve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të trajnimit.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjas një (1) ditë.

KUNDĚRVAJTJE

1. Personat Juridik si kryerës të veprave kundërvajtëse

Personi përgjegjës i personit juridik mund të shpallet përgjegjës dhe mund ti shqiptohet sanksioni edhe në rastet kur ai nuk mbanë përgjegjësi për kundërvajtjen konkrete. Në praktikën gjyqësore shpesh identifikohet me subjektin afarist si biznes individual dhe Gjykatat e shkallës së parë, në disa raste nuk e zhvillojnë në mënyrë të drejtë procedurën kundërvajtëse kur si palë në procedurë paraqiten bizneset afariste si persona juridik. Ku qëndron dallimi në mes të subjektit afarist si person juridik dhe subjektit afarist si biznes individual? Në cilat raste nuk mbanë përgjegjësi për kundërvajtje personi përgjegjës i personit juridik? Si zhvillohet procedura e kundërvajtjes ndaj subjektit afarist si biznes individual, dhe si zhvillohet procedura ndaj subjektit afarist si person juridik? Programi synon përmes elaborimit të legjislacionit të zbatueshëm që ka të bëjë me statusin juridik të subjekteve afariste në procedurën gjyqësore dhe shembujve praktik përkitazi me ndjekjen dhe gjykimin e kundërvajtjeve të personit juridik dhe bizneseve individuale dhe diskutimeve interaktive të unifikojnë praktikën gjyqësore në këtë fushë.

Objektivat

- Përkufizojnë qartë dhe drejtë subjektet afariste si persona juridik dhe personin përgjegjës të personit juridik;
- Zhvillojnë drejtë dhe në mënyrë ligjore procedurën për kundërvajtje ndaj personave juridik dhe personave përgjegjës në personin juridik;
- Zbatojnë dispozitat ligjore në përcaktimin e përgjegjësisë së personit juridik, personit përgjegjës në personin juridik, dhe personit fizik.

Përmbajtja

- ✓ Mënyra e zhvillimit të procedurës për kundërvajtje ndaj subjektit afarist që e ka cilësinë e personit juridik dhe ndaj personit përgjegjës të personit juridik;
- ✓ Përgjegjësia e personit juridik dhe përgjegjësia e personit përgjegjës të personit juridik;
- ✓ Subjektet afariste si biznese individuale dhe zhvillimi i procedurës ligjore ndaj tyre;
- ✓ Përgjegjësia e personit fizik.

Metodologjia

Elaborimi i legjislacionit të zbatueshëm në procedurën kundërvajtëse lidhur me statusin e personave juridik si subjekte afariste, përmes diskutimeve interaktive, shembujve praktik, puna në grupe për zgjidhjen e detyrës konkrete-skenar i rasteve, dhe ofrimi i alternativave për paqartësitë e paraqitura nga gjyqtarët.

Përfituesit

Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në Gjykatat e shkallës së parë.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme

2. Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit

Duke pas parasysh që jemi dëshmitarë të degradimit të ambientit, dëmtimit të pamëshirshëm të pyjeve, të parqeve kombëtare dhe natyrës në përgjithësi, e që krejt kjo reflektohet detyrimisht në shëndetin e njeriut dhe në kualitetin e jetës në përgjithësi, është e nevojshme që të trajtohet kjo temë, me theks të veçantë në rëndësinë dhe prioritetin që duhet kushtuar kësaj lëmie nga divizionet për kundërvajtje. Përmes këtij trajnimi do të adresohen pyetjet dhe dilemat si: Cilat janë parimet bazë të këtij ligji? Cili është organi që inicon procedurën kundërvajtëse? Si zhvillohet procedura kundërvajtëse? Cilat janë sanksionet kundërvajtëse?

Këto dhe heshtjet tjera do të adresohen përmes zbërthimit të dispozitave ligjore të Ligjit për Pyjet e Kosovës, përmes shembujve praktik, me q rast do të ofrohen alternativa dhe zgjidhje meritore të rasteve të kësaj natyre.

Objektivat

- Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës;
- Përkufizojnë qartë dhe drejtë kompetencat për kundërvajtjet dhe sanksionet kundërvajtëse të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, dhe të Ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në raport me Gjykatat – Organit Kundërvajtës;
- Nxjerrin aktgjykime të drejta dhe të bazuara në ligj.

Përmbajtja

- ✓ Përkufizimi i vendit publik;
- ✓ Zbatimi i Ligjit për Pyjet e Kosovës, Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në procedurën kundërvajtëse;
- ✓ Ndërlidhja e Ligjit për Pyjet e Kosovës me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Ambientit në procedurën kundërvajtëse/ dilemat dhe paqartësitë.

Metodologjia

Paraqitja e materialit përmes PowerPoint, biseda interaktive, shembuj nga praktika gjyqësore, rast hipotetik, pyetje përgjigje përmes të cilave do të ndikohet në unifikimin e praktikës gjyqësore dhe eliminimin e shkeljeve në këtë fushë.

Përfituesit

Gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje në gjykatat themelore.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjasë një (1) ditë.

NDËRMJETËSIMI

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- Propozimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Programin Trajnues 2024
- Rekomanduar dhe mbështetur nga raporti i vlerësimit të nevojave nga Projekti i USAID-it Drejtësia Komerciale

1. Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit-raste praktike, Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit, Ndërmjetësimi i detyrueshëm

Trajnimi ka për qëllim të ofrojë sqarimet e detajuara për procedurën e ndërmjetësimit që nga momenti i referimit të lëndës në ndërmjetësim, procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit si dhe sqarimi lidhur me ndërmjetësimin e detyrueshëm. Trajnimi synon të sqaron dhe të ju ndihmojë gjyqtarëve të kuptojnë apo interpretojnë drejtë dispozitat ligjore të cilat lënë hapësirë për dykuptimësi në temat e propozuara dhe zbatimi jounik i këtyre dispozitave nga ana e gjyqtarëve që trajtojnë lëndët e tilla. Nevoja për trajnim me fokus në këto tema specifike ka rrjedhur nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për Ndërmjetësim dhe diskutimet nga gjyqtarët për sfidat praktike që hasin në punën e përditshme të tyre.

Trajnimi synon ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve të cilët shqyrtojnë rastet e civile dhe të ofrojë zgjidhje për sfidat që gjyqtarët hasin gjatë procedimit të rasteve në ndërmjetësim dhe ushtrimi i kompetencës së tyre në vlefshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Cilat janë sfidat më të mëdha për gjyqtarët gjatë referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, gjatë procedurës së aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit? Cilat janë sfidat e procedurës së referimit të lëndëve për të cilat parashihet Ndërmjetësimi i detyrueshëm? Cilat janë dilemat e gjyqtarëve në ushtrimin e kompetencës së tyre gjatë vlerësimit të vlefshmërisë së marrëveshjeve të ndërmjetësimit? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e përpilimit të marrëveshjeve nga ana e ndërmjetësuesve? A ekziston ndonjë sfidë eventuale lidhur me implementimin apo përmbajtjen e Ligjit për Ndërmjetësim? Sfidat e zbatimit të Protokollit për Ndërmjetësim.

Objektivat

- Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit
- Zbatojnë drejtë bazën ligjore të ndërmjetësimit;
- Unifikojnë praktikën e referimit, aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të arritura përmes ndërmjetësimit
- Qartësimi i procedurave në referimin e rasteve familjare në procedurë të ndërmjetësimit
- Unifikojnë referimin e kontesteve për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm
- Unifikojnë zbatimin e Protokollit për Ndërmjetësim

Përmbajtja

- ✓ Referimi i lëndëve të përshtatshme në procedurën e ndërmjetësimit-raste praktike;
- ✓ Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit;
- ✓ Ndërmjetësimi i detyrueshëm, me fokus te veçantë tek rastet familjare;
- ✓ Sfidat në implementimin e ligjit për Ndërmjetësim;
- ✓ Sfidat në implementimin e protokollit për Ndërmjetësim.

Metodologjia

Trajnimi do zhvillohet përmes ofrimit të informatave nga ana e trajnuesit/ve, parashtrimi të pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna në bazë të shembujve më të mirë praktik që japin sqarim adekuat të procesit të referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të arritura në ndërmjetësim, ndërmjetësimin e detyrueshëm. Po ashtu, gjatë trajnimit do të paraqiten raste praktike në të cilët gjyqtarët duhen dhënë përgjigje apo opinione të tyre, ashtu që kuptimi i procedurës së ndërmjetësimit të jetë sa më lehtë i kapshëm.

Përfituesit

Përfitues të trajnimit për ndërmjetësim do të jenë gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore dhe degëve, si dhe ndërmjetësuesit e regjioneve të atyre gjykatave. Trajnimi do të organizohet në baza regjionale dhe mund të organizohet duke kombinuar gjyqtarët e regjioneve që janë më afër gjeografikisht.

Kohëzgjatja

4 trajnime (përfshirë të gjitha regjionet) nga një 1 ditë.

TRAJNIMET INTERDISIPLINARE

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- OSBE (raporti për monitorim të gjykatave)

1. Menaxhimi i lëndëve penale dhe orarit të gjykimeve

Në punën e përditshme të gjyqtarit dhe prokurorit, përpos vendimmarrjes një rol të rëndësishëm për të arritur deri tek vendimmarrja, luan dhe menaxhimi i rasteve, e sidomos kur gjyqtarët dhe prokurorët përballen me numër të madh të lëndëve të cilat duhet ti vendosin. Pra menaxhimi i rasteve dhe zbatimi i teknikave të menaxhimit të rasteve nga gjyqtarët dhe prokurorët e sidomos me një fluks të madh të rasteve të cilat i kanë para tyre, paraqet një sfidë shumë të madhe dhe çështje kyçe janë: menaxhimi i rasteve në bazë të natyrës, kompleksitetit dhe prioritetit në punën praktike; identifikimi i vështirësive në raport me menaxhimin e rasteve dhe cilat janë ato metoda të cilat do të mundë të shfrytëzoheshin në menaxhimin efikas të rasteve dhe sfidave të cilat dalin gjatë menaxhimit të rasteve. Ky trajnim është hartuar t'i përgjigjet pyetjeve dhe çështjeve të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe administrimin e lëndëve në gjykata dhe prokurori. Fokusi qëndron në adresimin e problemeve dhe strategjive të reja me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të efektivitetit të punës dhe evitimit të problemeve praktike.

Objektivat

- Zbatojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- Zbatojnë njohuritë në menaxhimin e rasteve;
- Aplikojnë teknikat e menaxhimit të rasteve.

Përmbajtja

- ✓ Menaxhimi i rasteve;
- ✓ Procedurat e administrimit efikas;
- ✓ Parimet themelore të menaxhimit të rasteve;
- ✓ Teknikat kryesore të menaxhimit të rasteve.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdorën metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, gjithashtu duke shfrytëzuar edhe PowerPoint prezantime.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

**KURIKULA E PROGRAMIT TË
TRAJNIMIT PËR DHUNËN NDAJ
GRAVE, DHUNËN NË FAMILJE DHE
DHUNËN ME BAZË GJINORE**

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit

1. Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore

Qëllimi i trajnimit është ngritja e kapacitetet e kuadrit ligjor mbi konceptet kryesore, kornizat normative vendore dhe ligjet që lidhen me Dhunën ndaj Grave (DhNG), Dhunën në Familje (DhF) dhe Dhunën me Bazë Gjinore (DhBGj).

Objektivat

Objektiva e këtij trajnimi është ngritja e kapacitetet dhe njohuritë e zyrtarëve ligjor mbi konceptet bazë të Dhunës ndaj Grave, Dhunën në Familje dhe Dhunën me Bazë Gjinore. Me përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutë në 2020 dhe CEDAW në 2008, të gjithë zyrtarët e drejtësisë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të kenë njohuri për standardet ndërkombëtare dhe mënyrën se si t'i zbatojnë ato në mënyrë efektive në punën e tyre, andaj ky trajnim synon ta arrij edhe këtë objektivë.

Përmbajtja

Përmbajtja e trajnimit përfshinë: familiarizimin me natyrën gjinore, manifestimet dhe dinamikën e DhNG dhe DhF si dhe pjesëmarrësit do të pajisen me një pasqyrë të parimeve udhëzuese në trajtimin e këtyre rasteve. Kjo përfshin përdorimin e një qasjeje të përqendruar te viktimat, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe të mbajturit përgjegjës kryerësin e dhunës, shpjegim të traumës dhe ndikimit të traumës tek viktimat, dhe marrjen e vendimeve për raste të tilla pa stereotipe gjinore.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit është e përzier, rekomandohet që të kombinohet ndjekja e kursit online në platformën kryesore të Këshillit të Evropës për Profesionistët ligjor “HELP”, kursi “Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, i cili mbulon Konventën e Stambollit dhe ligjet dhe politikat përkatëse vendore për DhNG, DhF dhe DhBGj. Gjithashtu, propozhet që pjesa tjetër e trajnimit të jetë me prezencë fizike për të ofruar tek pjesëmarrësit mundësi për të reflektuar se si t'i zbatojnë këto parime në praktikë në punën e tyre.

Përfituesit

Ky trajnim u dedikohet gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të çdo niveli dhe funksioni dhe mund të sugjerohet si parakusht për ndjekjen e moduleve të tjera të specializuara, nëse pjesëmarrësi/ja nuk ka ndjekur trajnim të mëparshëm në këtë fushë.

Kohëzgjatja

On-line + 1 ditë trajnim

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit

2. Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale

Qëllimi i Programit të Trajnimit është të përgatisë gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistë të tjerë për të trajtuar në mënyrë efektive rastet që përfshijnë DhNG, DhF dhe DhBGJ në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare, me fokus në sigurimin e një qasjeje të përqendruar tek viktimat, të mirë-informuar mbi traumën, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe qasje ku kryerësi i dhunës mbahet përgjegjës, ashtu që të kontribuohet në ndalimin e ciklit të mosndëshkueshmërisë.

Objektivat

Objektivat e trajnimit përfshijnë ngritjen e kapaciteteve të kuadrit ligjor për t'i dhënë një përgjigje efektive rasteve të dhunës në familje, duke marrë për bazë koncepte dhe rrethana të ndërlidhura me rastin siç janë: dinamikën e dhunës në familje, ciklin e fuqisë dhe kontrollit, luftimin e stereotipeve e zakonshme për viktimat dhe kryerësit e dhunës, teknikat e intervistimit. Gjithashtu objektivë ë këtij trajnimi është përfshirja e programeve për kryerësit e dhunës, si pjesë e dënimit.

Përmbajtja

Moduli do të përfshijë një përmbledhje të dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe Udhëzimeve dhe Politikave përkatëse të Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë, si dhe përkufizimet e reja në Ligjin për DhF, DhNG dhe DhBGJ. Pjesëmarrësit do të fitojnë gjithashtu njohuri për dinamikën e dhunës në familje, duke përfshirë konceptin e kontrollit shtrëngues, cikli i fuqisë dhe kontrollit si dhe cikli i dhunës, dhe stereotipet e zakonshme për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje që mund të ndikojnë negativisht në vendimmarrje në sistemin e drejtësisë. Do të rishikohen hulumtimet më të fundit mbi traumën, dhunën në familje dhe faktorët e rrezikut, duke përfshirë dhunën pas ndarjes. Pjesëmarrësit do të angazhohen në zhvillimin e aftësive praktike të tilla si identifikimi i veprave penale të dhunës në familje, teknikave të intervistimit- çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet bërë, mbledhja dhe vlerësimi i provave, ushtrimi i gjykimit të prokurorisë dhe përzgjedhja e akuzave, mënyra efektive për të reduktuar viktimizimin dytësor të viktimave, ndjekjet penale në mungesë të dëshmisë së viktimës (d.m.th. ndjekja penale kur një viktimë e DhF nuk dëshmon në çështjen e prokurorisë), luftimi i përdorimit diskriminues të rregullave të provave, sigurimi i marrjes së vendimit të duhur për dënimin e kryerësve të dhunës, përfshirja e programeve të trajtimit të kryerësit të dhunës si pjesë e dënimit, dhe trajtimin e shkeljeve të urdhrit të mbrojtjes. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të punojnë përmes rasteve sfiduese, siç janë rastet që përfshijnë: dhunën psikologjike dhe ekonomike; duke iu përgjigjur argumentit të mbrojtjes se i akuzuari nuk është penalisht përgjegjës për shkak të çrregullimeve mendore; dhe menaxhimin dhe fuqizimin e dëshmitarëve dhe viktimave që ngurrojnë të dëshmojnë.

Metodologjia

Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

Përfituesit

Ky modul është për gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë relevantë të cilët vijnë në kontakt të rregullt me rastet e dhunës në familje në sistemin e drejtësisë penale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjate dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit

3. Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare

Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është ngritja e njohurive të kuadrit ligjor mbi kuptimin e dhunës në familje në të Drejtën Civile, me fokus në urdhrat mbrojtës dhe konsiderimet e të drejtës familjare.

Objektivat

Objektivat e trajnimit përfshijnë ngritjen e kapaciteteve të kuadrit ligjor në kuptimin e drejtë të dhunës në familje në të drejtën civile, respektivisht, ngritja e njohurive në zbatimin efektiv të urdhrave mbrojtës. Trajnimi fokusohet në çështjet kritike të mbrojtjes, si dhe në çështjet e së drejtës familjare që ka një lidhje të menjëhershme dhe të dukshme me DhNG

Përmbajtja

Trajnimi do të shqyrtojë dispozitat përkatëse në Ligjin për DhF, DhNG dhe DhBGJ lidhur me procedurën gjyqësore për vendosjen e kërkesave për urdhër mbrojtje. Ai gjithashtu do të shqyrtojë dispozitat përkatëse në Ligjin për Familjen lidhur me kujdestarinë dhe qasjen, mbrojtjen e fëmijëve, mbështetjen e fëmijëve dhe bashkëshortëve dhe ndarjen e pasurisë. Pjesëmarrësit do të njihen me dinamikën dhe llojet e dhunës në familje, duke përfshirë mënyrën, kur dhe ku mund të ndodhë, dhe aftësinë për të njohur disa nga treguesit e saj. Duke aplikuar një qasje të informuar për gjininë dhe traumën, pjesëmarrësit do të eksplorojnë ndikimin e DhG në procedurat gjyqësore familjare, duke përfshirë të kuptuarit e interesit më të mirë të fëmijës, sfidat me kujdestarinë e përbashkët, qasjen me një kryerës të dhunës dhe marrëdhënien midis mbrojtjes së fëmijëve dhe DhNG. Ata do të angazhohen në zhvillimin e aftësive të tilla si të analizojnë DhNG/DhF, të jenë të vetëdijshëm për faktorët e rrezikut të DhNG-së, të dijnë se kur të referohen për një vlerësim të plotë, të jenë në gjendje të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme ndaj një zbulimi të abuzimit ose dhunës, të kryejnë një intervistë efektive me individët që kanë përjetuar abuzime, mos-ndikimin mbi gratë në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, veçanërisht ndërmjetësimin, dhe nevojën për siguri dhe mbështetje.

Metodologjia

Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

Përfituesit

Ky trajnim është krijuar për gjyqtarët e gjykatave civile, dhe përfshinë aplikimin e urdhërit mbrojtës dhe/ose çështje të së drejtës familjare (p.sh. çështjet e kujdestarisë).

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga vlerësimi i nevojave për trajnim:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit

4. Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën

Qëllimi i përgjithshëm i këtij trajnimi është ngritja e kapaciteteve të kuadrit ligjor mbi ndjekjen penale efektive dhe nxjerrjen e vendimeve të informuara mbi traumën e viktimës, në përputhje me ligjet vendore, standardet ndërkombëtare dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026.

Objektivat

Objektivat e trajnimit përfshijnë ngritjen e njohurive të faktorëve të rëndësishëm që luajnë rol në ndjekjen penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën, duke u thelluar tek mitet e zakonshme rreth dhunimit, çështjen e pëlqimit, dhe praktikatat e marrjes në pyetje të rasteve të tilla.

Përmbajtja

Pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri për mitet e zakonshme të dhunimit rreth çështjeve të besueshmërisë dhe pëlqimit; neurobiologjia e traumës dhe se si trauma ndikon në sjelljen dhe kujtesën e viktimës, dhe implikimet për hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet. Pjesëmarrësit do të angazhohen në praktikimin e teknikave për marrjen në pyetje të duhur të dëshmitarëve dhe viktimave të traumatizuara dhe pjesëmarrësit do të kenë mundësinë t'i praktikojnë ato nëpërmjet ushtrimeve të simuluar në një mjedis të kontrolluar. Temat e trajnimit do të përfshijnë: qasjet e përgjithshme të intervistimit, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, teknikat e ekzaminimit (të drejtpërdrejta, të kryqëzuara, të ridrejtuar), strategjitë e pyetjeve për dëshmitarë të ndryshëm, trajtimin e dëshmitarëve të traumatizuar, qasjen e mbështetjes së dëshmitarëve dhe trajtimin e traumatizimit dytësor, të gjitha këto gjatë aplikimit të qasjes së informuar mbi traumë për të eksploruar ndjekjen penale të kryerësit e dhunës dhe trajtimin e rasteve të dhunës seksuale të facilituara nga droga/alkooli.

Metodologjia

Trajnimi parashihet të jetë multidisiplinar, duke përfshirë disa akterë që janë pjesë e zingjirit të trajtimit të rasteve. Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

Përfituesit

Ky trajnim është krijuar për pjesëmarrësit nga sistemi i drejtësisë penale si prokurorët, gjyqtarët, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë (p.sh. ekzaminerët mjeko-ligjorë), që merren me veprat që mbulojnë forma të ndryshme të dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunimin dhe sulmin seksual, ndjekjen, martesën e detyruar, dhe ngacmimin seksual.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

KUNDËR DISKRIMINIMIT

Kërkesë:

- Drejtësia Sociale për Rom, Ashkali dhe Egjiptian - Terr Des Home

1. Antigjipsizmin

Antigjipsizmi, i njohur edhe si racizëm specifik ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përfshin një rrjet kompleks paragjyimesh historike, kulturore dhe sistematike që rezultojnë në marginalizimin, përjashtimin dhe keqtrajtimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. I rrënjësuar në stereotipe dhe perceptime negative, antigjipsizmi manifestohet përmes formave të shumëanshme, duke përfshirë paragjykimet sociale, diskriminimin institucional, gjuhën e urrejtjes dhe madje edhe aktet e dhunës. Ky fenomen i rrënjësuar thellë përjetëson aksesin e pabarabartë në arsim, kujdes shëndetësor, punësim dhe drejtësi, duke përkeqësuar më tej pabarazitë socio-ekonomike me të cilat përballen romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Kuptimi i antigjipsizmit kërkon njohjen e origjinës së tij historike dhe manifestimeve bashkëkohore, dhe zhveshja e tij kërkon përpjekje bashkëpunuese në të gjithë shoqërinë, institucionet dhe politikën për të nxitur një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më të drejtë për të gjithë.

Objektivat

- Ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit: T'u ofrojë pjesëmarrësve një kuptim gjithëpërfshirës të konceptit të antigjipsizmit, duke përfshirë kontekstin historik, manifestimet dhe ndikimin e tij në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- Të ndihmojë pjesëmarrësit të njohin rastet e antigjipsizmin brenda proceseve ligjore dhe administrative dhe të kuptojnë efektet e tij në administrimin e drejtësisë.
- Mitigimi dhe parandalimi: Pajisja e pjesëmarrësve me mjete dhe strategji për të trajtuar dhe luftuar në mënyrë efektive antigjipsizmin brenda roleve të tyre profesionale, duke promovuar trajtim të drejtë dhe të barabartë për individët rom, ashkali dhe egjiptian.
- Kompetenca kulturore dhe ndjeshmëria: Për të rritur kompetencën kulturore dhe ndjeshmërinë e pjesëmarrësve kur merren me raste që përfshijnë individë rom, ashkali dhe egjiptian, duke nxitur një sistem drejtësie më gjithëpërfshirës dhe të barabartë.

Përmbajtja

- ✓ Përkufizimi dhe konceptet kryesore të antigjipsizmit, Konteksti historik dhe rrënjët shoqërore
- ✓ Marrëdhënia midis diskriminimit, paragjyimit dhe antigjipsizmit
- ✓ Sfondi historik dhe diversiteti kulturor i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- ✓ Sfidat socio-ekonomike dhe pabarazitë sistematike me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
- ✓ Manifestimet e antigjipsizmit, stereotipet, paragjykimet dhe qëndrimet diskriminuese ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
- ✓ Diskriminimi institucional dhe strukturor
- ✓ Gjuha e urrejtjes, krimet e urrejtjes dhuna dhe përjashtimi
- ✓ Ligjet ndërkombëtare dhe kombëtare që trajtojnë diskriminimin dhe antigjipsizmin
- ✓ Praktika gjyqësore dhe jurisprudenca lidhur me antigjipsizmin
- ✓ Detyrimet e shteteve për të luftuar antigjipsizmin

- ✓ Roli i gjyqësorit dhe prokurorisë, Sigurimi i trajtimit të barabartë në procedurat ligjore
- ✓ Njohja dhe adresimi i njëanshmërisë dhe paragjyqimeve në procedurat ligjore
- ✓ Promovimi i gjykimeve të drejta dhe mbrojtja e të drejtave të individëve rom, ashkali dhe egjiptian;
- ✓ Mitigimi dhe parandalimi, Promovimi i procedurave ligjore gjithëpërfshirëse
- ✓ Strategjitë për identifikimin dhe trajtimin e antigjipsizmit brenda rasteve
- ✓ Ndërgjegjësimi dhe trajnimi brenda sistemit të drejtësisë;
- ✓ Kompetenca kulturore dhe ndjeshmëria, rëndësia e ndërgjegjëimit kulturor në proceset ligjore dhe administrative,
- ✓ Ndërtimi i komunikimit të respektueshëm me individët rom, ashkali dhe egjiptian
- ✓ Tejkalimi i anësive dhe paragjyqimeve

Metodologjia

Trajnimi do të përdorë një kombinim të metodologjive për të siguruar të mësuarit efektiv dhe aplikimin praktik.

Këto metoda përfshijnë:

- Prezantime dhe leksione
- Raste studimore dhe shembuj të jetës reale
- Diskutime në grup dhe ushtrime me role
- Shfaqje të materialeve multimediale

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, Profesionistë të profesioneve të lira

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

TRAJNIMET PËR MENAXHMENTIN E GJYKATAVE/PROKURORIVE

1. Menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e gjykatave dhe prokurorisë, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financave, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.

Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë apo prokurori? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës dhe prokurorisë?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e gjykatave dhe prokurorisë përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të gjykatave dhe prokurorisë. Gjatë tërë procesit do të behet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.

Objektivat

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë parimet standarde të menaxhimit të mirë;
- Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
- Zbatojnë parimet dhe metodologjinë e planifikimit.

Përmbajtja

- ✓ Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë;
- ✓ Përgjegjësitë menaxheriale;
- ✓ Burimet njerëzore dhe financat.

Përfituesit

Kryetarët, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

TRAJNIMET PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL DHE ZYRTAR LIGJORE

Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët
profesional

(Penale-materiale dhe procedurale)

(Civile-materiale dhe procedurale)

Trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtar ligjore

Roli i bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor është i veçantë dhe ndikon në zhvillimin, avancimin dhe ngritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor, andaj, ngritja e kapaciteteve profesionale është një ndër prioritetet e Akademisë së Drejtësisë. Gjatë vitit 2024 në këtë kuadër janë planifikuar të realizohen numër i konsiderueshme i trajnimeve nga Moduli i Trajnimit Bazik-Aspekti Civil dhe Penal.

Trajnimet në Fushën Penale

Materiale

1. Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përgjashtimit të Kundërligjshmërisë, Pjesa e Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përgjashtimit të Kundërligjshmërisë, Pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat - 16 tetor 2023
2. Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit, 17 tetor 2023
3. Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se, 18 tetor 2023

Trajnimet në Fushën Penale

Procedurale

4. Fazat e procedurës penale
5. Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta
6. Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi

Trajnimet në Fushën Civile

Materiale

1. E drejta e trashëgimisë dhe e Drejta familjare
2. E drejta e punës
3. E drejta pronësore
4. E drejta e detyrimeve

Trajnimet në Fushën Civile

Procedurale

1. Proceduara kontestimore
2. Proceduar përmbarimore
3. Dhuna në familje dhe Ndërmjetësimi

STAFI ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL

1. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është që nëpërmjet prezantimit të koncepteve dhe parimeve të menaxhimit të rrjedhës së rasteve, pjesëmarrësit të njoftohen dhe të përgatiten me shkathtësi për identifikimin, fillimisht të problemeve të menaxhimit të rasteve dhe më pas për të zhvilluar dhe zbatuar një planë për menaxhimin e rrjedhjes së lendes.

Objektivat

- Avancojnë njohuritë për menaxhimin e rasteve;
- Respektojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- Demonstrojnë teknikat e menaxhimit të rasteve;
- Avancojnë njohuritë lidhur me parimet dhe metodologjinë e CEPEJ.

Përmbajtja

- ✓ Regjistrat e gjykatave dhe prokurorive;
- ✓ Organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës;
- ✓ Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi;
- ✓ Menaxhimi efikas i lendeve bazuar në metodologjinë CEPEJ;
- ✓ Digjitalizimi i procesit të punës në gjykata dhe prokurori.

Metodologjia

Realizimit të trajnimit do ti kontribuojnë metodat e prezantimit përmes PowerPoint, punës në grupe dhe përdorimi i rasteve praktike.

Përfituesit

Administratorët, ndihmës administrator, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridike, zyrtarët e informimit, njësi për vlerësimin e performances së prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

2. Shkathtësitë në komunikim

Disa profesione kërkojnë zhvillim të shkathtësive dhe përditësim të vazhdueshëm për të qenë në hap me kohën. I tillë është funksioni i zyrtarit për informim, i cili, në mungesë të shkathtësive adekuate, jo vetëm që lë shumë për të dëshiruar, por e dëmton institucionin që prezanton. Ndaj, trajnimi “Shkathtësitë në komunikim”, ka për qëllim zhvillimin e disa shkathtësive për zyrtarët për informim në gjykata/prokurori, përmes të cilave, ata do ta zotërojnë më lehtë punën dhe do ta paraqesin më mirë institucionin. Fokusi i këtij trajnimi është tek shkathtësitë në të shkruar dhe në të folur, gjuha jo-verbale, mesazhet kyçe, konfidenca, empatia, shkathtësitë në raste krizash, në rastet kur iu mungon informacioni apo kur publikohet dezinformata etj.

Në përmbledhjen e temave të trajtuara, zyrtarët për informim, gjithashtu, kanë mundësinë të japin vlerësimet e tyre për trajnimin dhe të ndajnë përvojat e tyre lidhur me shkathtësitë.

Objektivat

- Njohin shkathtësitë e nevojshme për komunikim efikas;
- Shkruajnë dhe të flasin duke zbatuar taktikat e mësuara;
- Përgatisin mesazhet kyçe dhe zhvillojnë empatinë;
- Vlerësojnë rëndësinë e komunikimit jo-verbal;
- Menaxhojnë dhe përballin krizën brenda institucionit;
- Zhvillojnë komunikimin adekuat.

Përmbajtja

- ✓ Përparësitë dhe mangësitë e formave të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- ✓ Njohja e shkathtësive në komunikim;
- ✓ Elaborimi i veçantë për konfidencën, empatinë dhe gjuhën jo-verbale;
- ✓ Diskutimi për shkathtësitë dhe mundësitë e jetësimit të tyre.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të përdoren disa metoda të kombinuara trajnuese duke u nisur nga prezantimi në PowerPoint i cili përfshin shpjegime teorike, diskutime interaktive, dhe ushtrime.

Përfituesit

Përfitues të këtij trajnimi do të jenë zyrtarët për informim dhe monitorim të mediave, në gjykata dhe prokurori. Përfitues të trajnimit të njëjtë mund të jenë edhe zyrtarët tjerë që ndër-veprojnë me palët në gjykata/prokurori.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

3. Integriteti dhe sjelljet etike në administratën gjyqësore dhe prokuroriale

Qëllimi më i lartë i administratës gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë, për të gjithë stafin që i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paanësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia.

Moduli është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar bazën ligjore dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat

- Dallojnë sjelljet e etike brenda dhe jashtë zyrës;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë Kodin e Etikës dhe parimet e tij;
- Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje etike.

Përmbajtja

- ✓ Parimet dhe normat e sjelljes etike;
- ✓ Sjellja brenda dhe jashtë zyrës dhe
- ✓ Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime teorike, përmes PowerPoint dhe diskutime interaktive.

Përfituesit

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë (1) ditë.

4. Menaxhimi i kohës dhe stresit në vendin e punës

Ky trajnim është i konceptuar si projekt i nevojshëm i zhvillimit të shkathtësive të menaxhimit të kohës dhe stresit për zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive si një predispozitë e përmirësimit të performancës së tyre në funksion të mbështetjes së punës dhe rritjes së efikasitetit të punës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre të përcaktuara me ligj.

Stresi sot është një dukuri negative përcjellëse në të gjitha aktivitetet, zhvillimet, veprimet e sjelljet e individit dhe dukuri e pashmangshme në përgjithësi në socium. Zyrtarët e administratës së Gjykatave dhe Prokurorive gjatë punës së tyre të përditshme përballen me situata të shumta stresuese dhe u ekspozohen gjatë punës stresorëve të shumtë të cilët interferojnë negativisht në shërbimet e këtyre zyrtarëve në raport me Gjykatësit e Prokurorët por edhe në raport me palët e subjektet tjerë.

Menaxhimi i kohës dhe stresit është nevojë imediate si parandalim i atakimit të personaliteteve të zyrtarëve në administratë në rastin konkret, nga ana e stresorëve të ndryshëm, në mënyrë që puna e tyre të jetë cilësorë dhe efikase.

Objektivat

- Dinë të menaxhojnë mirë kohën;
- Bëjnë prioritetizimin e aktiviteteve të tyre ditore, javore dhe mujore;
- Njohin dhe aplikojnë teknikat dhe mënyrat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës.

Përmbajtja

- ✓ Stresi dhe përkufizimi teorik;
- ✓ Menaxhimi i kohës;
- ✓ Prioritizimi i aktiviteteve;
- ✓ Teknikat e ruajtjes së shëndetit dhe kondicionit të punës;
- ✓ Ruajtja nga “djegia” e profesionit.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohen metoda dhe teknika bashkëkohore, prezantim në PowerPoint, pune në grupe dhe studim i rasteve nga praktika.

Përfituesit

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

5. Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat

Kjo kurrikulë e trajnimit synon bartjen e njohurisë kryesore lidhur me përdorimin e metodologjisë së CEPEJ në gjykata për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit, sipas rekomandimeve të Raportit të BE-së për Zgjerim të vitit 2021. Ky raport rekomandon sigurimin e të dhënave të besueshme statistikore në linjë me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Gjyqësorit, Përmirësimin e planifikimit strategjik, që po ashtu kërkon angazhim për paraqitjen e sistemeve të besueshme statistikore për gjyqësorin bazuar në indikatorët e CEPEJ-it dhe përdorimin e gjetjeve për qëllime të menaxhimit dhe politik-bërjes si dhe forcimin e angazhimeve për reduktimin e grumbullimit të lëndëve, bazuar në strategjinë për digjitalizim.

Ky trajnim do të prezantojë instrumentet kryesore të zhvilluara nga Grupet Punuese në CEPEJ (Grupi Punues për Vlerësimin e Sistemeve Gjyqësore, Grupi Punues SATURN, Grupi Punues për Cilësi, si dhe Grupi Punues i themeluar rishtazi lidhur me Drejtësinë kibernetike) dhe do të shpjegojë se si këto instrumente mund të përdoren në sistemin gjyqësor të Kosovës, duke i marrë parasysh nevojat specifike të identifikuar. Trajnimi gjithashtu do të shpjegojë si të lexohen raportet statistikore dhe tabelat e zhvilluara për SMIL, i cili inkorporon disa prej indikatorëve kyç të CEPEJ-it.

Objektivat

- Kalkulojnë, përdorin, lexojnë dhe kuptojnë indikatorët e CEPEJ-it për performancë; (norma e CEPEJ për verifikim, koha e zgjidhjes së rasteve gjyqësore, koha e çështjeve në pritje, kohëzgjatja e procedurave) të inkorporuara në raportet statistikore të SMIL dhe tabela;
- Përdorimi i instrumenteve të CEPEJ për menaxhimin e kohës, cilësi dhe drejtësinë kibernetike si dhe
- Ndryshimi i praktikave të tyre të punës, sjelljeve, qëndrimeve me qëllim të përmirësimit të efikasitetit.

Përmbajtja

- ✓ Prezantimi i Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë dhe fushat përkatëse të interesit;
- ✓ Indikatorët e CEPEJ-it për Performancë;
- ✓ Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe raportet e Ndërlidhura Statistikore dhe Tabelat;
- ✓ Të dhënat në dispozicion nga SMIL-i;
- ✓ Kornizat kohore të CEPEJ, një prej instrumenteve kryesore të CEPEJ;
- ✓ Politikat e Gjykatave që janë dëshmuar të suksesshme për të reduktuar tej zgjatjen e procedurave gjyqësore në sistemet Evropiane të gjyqësisë, si dhe si këto politika mund të përshtaten në përvojat e Kosovës;
- ✓ Sistemet Evropiane të Peshimit të Lëndëve për procedurat gjyqësore dhe mundësinë e adaptimit të këtyre sistemeve në Gjykatat e Kosovës;

- ✓ Anketat e përdoruesve të gjykatave si një instrument për t'ju bërë me dije gjykatave dhe gjyqtarëve për perceptimin e përdoruesve lidhur me “drejtësinë e sjellë”, si dhe për të qenit të hapur për shoqërinë civile;
- ✓ Përmbledhje e koncepteve dhe informatave.

Metodologjia

Sesionet e trajnimit janë dizajnuar për të qenë sa më koncize dhe interaktive që është e mundshme. Sesionet do të përfshijnë pyetje dhe përgjigje dhe diskutime për të stimuluar pjesëmarrjen proaktive. Seancat e shkurtra do të duhej të jenë më të përshtatshme për orarin e ngarkuar të gjyqtarëve. Është e nevojshme që konceptet kryesore të përsëriten për t'i bërë ato plotësisht të kuptueshme nga pjesëmarrësit, gjë që është thelbësore për tu siguruar që ato do të vendosen punën e tyre të përditshme.

Përfituesit

Stafi i gjykatave, veçanërisht stafi që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët dhe stafin administrativ.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë dy (2) ditë.

6. Trajnimi për protokollin dhe Etiketa

Mikpritja është një element i veçantë që kërkon rregulla të mirësjelljes që duhet respektuar në shoqëri por edhe me rastin e ceremonive gjatë funksioneve zyrtare. Në funksion të kësaj është zhvilluar edhe protokollin i cili përcakton një sërë rregullash që duhet respektuar nga institucionet e shtetit me rastin e vizitave të delegacioneve të huaja në vendin tonë ose edhe në institucionet tona.

Qëllimi i këtij trajnimi është ngritja e aftësive të stafit të gjykatave dhe prokurorive në organizimin e pritjeve të delegacioneve duke u bazuar në rregullat që përcakton Protokollin i Shtetit.

Objektivat

- Kuptojnë saktë çka është Etiketa dhe Protokollin;
- Njohin shembuj të veshjes zyrtare (kodit të veshjes), gratë në jetën publike dhe zyrtare;
- Krahasojnë protokollet në vendet e ndryshme dhe praktikatat e mira si dhe
- Zgjerojnë njohurit rreth praktikave diplomatike në formë të pavarur.

Përmbajtja

- ✓ Protokollin dhe Etika;
- ✓ Protokollin me rastin e pritjes së delegacioneve;
- ✓ Korrespondenca diplomatike;
- ✓ Natyra e ndryshimit të diplomacisë;
- ✓ Metoda diplomatike;
- ✓ Zhvillimi i praktikave diplomatike;
- ✓ Udhëzim për komunikim dhe traditat ndërkombëtare.

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet përmes ligjëratës interaktive ku pjesëmarrësit do të kenë mundësinë përmes rasteve të veçanta të analizojnë aspektin ceremonial të procedurave të protokollit, përmes pyetjeve dhe bashkëbisedimeve.

Përfituesit

Përfituesit e trajnimit janë gjyqtarët dhe stafi administrativ.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

7. Mbrojtja e sinjalizuesve

Qëllimi i trajnimit është trajtimi i çështjeve të ndërlidhura me mbrojtjen e sinjalizuesve, përforsimi i njohurive në raport me të drejtat e sinjalizuesve si dhe krijimi i njohurive të reja në raport me zhvillimet e fundit në fushën e sinjalizimit në Kosovë, rajon dhe në Evropë. Përmes trajnimit mëtohet të trajnohen stafi administrativ i gjykatave si dhe zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin në gjithë regjionet e vendit.

Objektivat

- Njohin standardet ndërkombëtare e vendore për të drejtat e njeriut që lidhen me punën e gjyqësorit
- Zbatojnë praktikat më të mira në fushën e lirisë së shprehjes dhe fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve;

Përmbajtja

- ✓ Standardet ndërkombëtare e vendore për të drejtat e njeriut që lidhen me punën e gjyqësorit;
- ✓ Parimet, institucionet, proceset dhe praktikat në fushën e lirisë së shprehjes në përgjithësi, dhe në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve në veçanti.

Metodologjia

Metoda specifike të trajnimeve për profesionistë ligjorë do të aplikohen për këtë trajnim. Do të përdoren ushtrime për shkrimin e akullit, prezantime në PPT, raste studimore, ushtrime në grup, sondazhe të opinionit publik, debate të nxitura nga trajnuesit e specializuar në fushën e lirisë së shprehjes, provime vlerësimi. Trajnimi do të bazohet në tërësi në manualin e trajnimit të zhvilluar nga projekti JUFREX.

Përfituesit

Zyrtarët administrativ të gjykatave dhe prokurorive dhe zyrtarët për sinjalizimin në gjykata dhe prokurori.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

8. Mirëmbajtja e faqeve të gjykatave në Facebook dhe informimi i publikut përmes tyre

Të gjitha gjykatat në Kosovë kanë faqet e tyre zyrtare në rrjetin social Facebook. Hapja e profileve të gjykatave në këtë rrjet është bërë me qëllim të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe informimit të publikut të gjerë. *Trajnimi Mirëmbajtja e faqeve të gjykatave në facebook dhe informimi i publikut përmes tyre*, është ideuar për të sjell risi në këto faqe duke lehtësuar informimin e publikut për gjyqësorin dhe njëkohësisht duke shtuar atraktivitetin e këtyre profileve. Përveç postimeve të deritanishme, që për gjykatat themelore kanë përfshirë kryesisht njoftime me rastin e vendosjes për paraburgime, për seanca gjyqësore që cilësohen si mediatike dhe storie me stafin e gjykatave, të tjera alternativa nuk janë përdorur. Në këtë trajnim, do të prezantohen ide kreative për prezantimin e procedurave gjyqësore, në mënyrë që qytetarët, kur kanë një rast në gjyqësor, t'i dinë të drejtat e tyre dhe të dinë procedurat për të realizuar të drejtën e tyre. Po ashtu, ZIP kanë nevojë që për mirëmbajtjen e faqeve të gjykatave në FB, të përditësohen me inovacionet e fundit të këtij rrjeti, duke pasur mundësinë që të marrin leksione nga ekspertët të teknologjisë.

Objektivat

- Përdorin faqet e gjykatave në FB për të krijuar postime kreative;
- Përpunojnë materialet me gjuhë juridike duke i bërë të kuptueshme për publikun e gjerë dhe më pas t'i postojnë përmes ideve të ndryshme në FB;
- Njihen me inovacionet e fb-së;
- Praktikojnë leksionet e mësuara nga ekspertët e IT-së.

Përmbajtja

- ✓ Perspektiva e re e qasjes në FB të gjykatës;
- ✓ Njohja me ide të reja të prezantimit të punës së gjykatës dhe funksionimit të saj, para publikut;
- ✓ Elaborimi i shembujve të përpunimit të përmbajtjeve nga gjuha juridike në gjuhë më të thjeshtë për publikun;
- ✓ Elaborimi i moduleve që ofron FB.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të përdoren metoda të kombinuara trajnuese, prezantime në PowerPoint, shpjegime teorike, diskutime interaktive, dhe ushtrime.

Përfituesit

Përfitues të këtij trajnimi do të jenë zyrtarët për informim dhe monitorim të mediave, në gjykata dhe prokurori.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

9. Trajnimi hyrës për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës gjyqësore

Trajnimet hyrëse kanë për qëllim që t'i ofrojnë mundësi çdo punonjësi që të marrë pjesë në të gjitha trajnimet relevante për kryerjen e detyrave administrative në gjykata dhe prokuroritë (të gjitha modulet e përgjithshme të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm dhe modulet e specializuara relevante për vendin përkatës të punës në kuadër të administratës së gjykatave/prokurorive).

Objektivat

Objektivi kryesor i këtij trajnimit hyrës është të sigurojë trajnimin për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës, duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme për ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të tyre profesionale si anëtarë të administratës gjyqësore dhe prokuroriale. Qëllimi i trajnimit është që të japë informacion të përgjithshme lidhur me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor, parimet dhe detyrat kryesore në kryerjen e detyrave administrative në kuadër të sistemit si dhe nxitjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga pjesëtarët e administratës.

Përmbajtja

Moduli 1:

- Hyrje në sistemin gjyqësor të Kosovës, parimet dhe rregulloret Kushtetuese, legjislacioni dhe institucionet relevante;
- Hyrje në administratën gjyqësore, legjislacioni përkatës, funksionet dhe përgjegjësitë
- Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale
- Qasja në informacion, konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit të klasifikuar, si dhe mbrojtja e të dhënave
- Koncepti i "Shërbimeve të Orientuara në Cilësi " dhe në shërbim të qytetarëve
- Hyrje në planifikim, menaxhim, menaxhimin e kohës dhe stresit

Moduli 2:

- Hyrje në punën e gjykatave dhe prokurorive; struktura, organogramet; kategoritë e stafit administrativ dhe të drejtat e detyrimit e tyre
- Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm dhe puna në ekip
- Rregullat dhe rregulloret kryesore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve (lëndëve).
- Specifikat e punës në çështjet civile, çështjet penale dhe çështjet administrative; llojet e rasteve, aktet gjyqësore dhe seancat gjyqësore.
- Procedurat gjyqësore dhe detyrat përkatëse të personelit administrativ, dërgimi i thirrjeve, afatet, prezantimi i llojeve të regjistrave dhe dokumenteve të mirëmbajtura nga stafi administrativ; rregullat dhe mostrat.

Metodologjia

- Prezantime, diskutime interaktive, ushtrime praktike, duke përfshirë edhe simulime.

Përfituesit

Pjesëtarët e sapo-emëruar të administratës së gjykatave dhe prokurorive dhe stafi me më pak se 6 muaj përvojë në pozitën përkatëse.

Kohëzgjatja

Modul 1, 3 ditë

Moduli 2, 3 ditë

Trajnimet për Trajnues

Zbatimi i Trajnimeve për Trajnues (TiT)

Trajnimet e Trajnuesve do të vazhdojnë të jenë rezultat i bashkëpunimit me projektet dhe donatorët e AD-së. Programi i trajnimit të trajnuesve i AD-së përbëhet nga një plan studimi i kombinuar me aspektet teorike dhe praktike duke j'u mundësuar trajnuesve të angazhuar në AD të pajisen me përvoja dhe teknikat e fundit në fusha të ndryshme duke filluar nga metodologjitë e trajnimit, gjuha e komunikimit, teknikat e të mësuarit për të rritur si dhe aspekte profesionale nga fusha penale, civile, interdisiplinare.

Në këtë komponentë Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunime të shumta me Institucione dhe organizata të ndryshme si: Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe gjitha projektet e saj, Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadën Britaneze, OJQ të ndryshme që operojnë në vendin tonë.

Gjatë vitit 2024, AD synon që të vazhdojë bashkëpunimin me donatorët e saj duke e zgjeruar programin e saj trajnues me disa fusha specifike në të cilat ka nevojë për rritjen e numrit të trajnuesve apo përditësimin e metodologjive dhe kurrikulave trajnuese.

Një prej fushave ku synohet që të vazhdohen trajnimet e trajnuesve është fusha e Krimit Kibernetik, trajnime kryesisht të mbështetura nga Këshilli i Evropës projekti i iPROCEEDS, pastaj Trajnim i Trajnuesve në fushën e Diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, Trajnim në fushën e lirisë së shprehjes dhe mediave dhe trajnime në fushën e antitrafikimit.

Numri i sesioneve dhe kohëzgjatja e TIT tjera do të përcaktohet varësisht nga përmbajtja që do të kenë trajnimet përkatëse. Këtyre aktiviteteve i paraprijnë identifikimi i trajnuesve adekuat i cili fillimisht bëhet përmes shpalljeve publike në web faqen e AD-së duke ju mundësuar të gjithë të interesuarve të drejta të barabarta në aplikimet e tyre, e pastaj duke përzgjedhur pjesëmarrësit varësisht përvojës së tyre, profilit të profesionit.

Platforma e Kurseve në HELP

Platforma HELP e Këshillit të Evropës është një platformë e mësimit në distancë e zhvilluar nga Sekretariati i Këshillit të Evropës me qëllim të lehtësimit dhe ofrimit të trajnimeve sa më profesionale për profesionistët ligjorë. Kurset online HELP janë interaktive dhe vizuale. Ato mbulojnë tema të ndryshme që lidhen me të drejtat e njeriut, duke reflektuar fusha të ndryshme të punës së Këshillit të Evropës.

Objektivi kryesor i Programit të Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionistët Ligjor (HELP) është të rrisë kapacitetin e gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve, në të 46 vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë, për të zbatuar standardet evropiane të të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme. Kjo bëhet përmes kurseve online HELP që mbulojnë një sërë temash të të drejtave të njeriut.

Nr.	Kurset e Zhvilluara në gjuhën shqipe në HELP
1.	Qasja në drejtësi për gratë
2.	Kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të paraqitura në GJEDNJ
3.	Masat alternative ndaj ndalimit
4.	Alternativë për ndalimin e imigracionit
5.	Antidiskriminimi
6.	Azili dhe të Drejtat e Njeriut
7.	Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut
8.	Drejtësi miqësore për fëmijët
9.	Mbrojtja e të dhënave dhe të drejtat e privatësisë
10.	Etika për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët
11.	Liria e shprehjes
12.	Krimet e urrejtjes
13.	Gjuha e urrejtjes
14.	Hyrje në KEDNJ dhe GJEDNJ
15.	Arsyetimi Gjyqësor dhe të Drejtat e Njeriut
16.	Masat mbrojtëse procedurale në procedurën penale dhe të drejtat e viktimave
17.	Ndalimi i keqtrajtimit
18.	Të drejtat pronësore
19.	Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve
20.	Parandalimi i radikalizimit
21.	Fëmijët Refugjatë dhe Emigrantë
22.	Dhuna ndaj Grave